



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 121

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E mërkurë, 17 korrik 2024

PËRMBAJTJA

Faqe

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 458, datë 10.7.2024	Për një ndryshim në vendimin nr. 1140, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, 2021–2025, dhe Planin e Veprimit 2023–2025”, të ndryshuar.....	14375
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 4, datë 24.6.2024	Për rregullat e përcaktimit të konsumit të energjisë termike.....	14412
Udhëzim i ministrit të Brendshëm nr. 113, datë 9.7.2024	Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet për kryetar të Bashkisë Himarë, qarku Vlorë.....	14422
Udhëzim i ministrit të Brendshëm nr. 114, datë 9.7.2024	Për procedurën e lëshimit, e refuzimit të lëshimit, e ripërtëritjes apo e anulimit të lejes së qëndrimit dhe lejes unike për të huajin.....	14424
Udhëzim i ministrit të Brendshëm nr. 116, datë 11.7.2024	Për procedurat dhe formularin e regjistrimit e të huajit në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.....	14430
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 3049/1, datë 11.7.2024	Për hyrjen në fuqi të marrëveshjeve ndërkombëtare.....	14431
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 41, datë 29.5.2024	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-882 (117), datë 8.3.2023, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	14431

Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 44, datë 4.6.2024	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 8583, datë 22.7.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 2985, datë 30.9.2016, të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2023-2461, datë 8.6.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 342, datë 26.5.2005, “Për miratimin e listës së inventarit dhe transferimin e pronave të klubit të futbollit ‘Tirana’ në pronësi të Bashkisë Tiranë”, në pjesën ku disponohet për pasurinë truall me sipërfaqe 348 m ² , të regjistruar në regjistrin hipotekar nr. 6580, datë 23.9.1996, në pronësi të Stefan Poga, Evanthi Poga me nga 3/9-n pjesë dhe Elsa Poga, Sofiana Poga, Rozi Poga me nga 1/9-n pjesë, që kufizohet Lindje parcela nr. 443, Perëndimi parcela nr. 439 e pjesërisht rruga “M. Gjollështa”, Veriu rrugë në projekt, Jugu parcela nr. 440.....	14447
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 332, datë 9.7.2024	Për miratimin e rregullores “Për bashkimin e procedimeve disiplinore, në rastet kur një gjyqtar dhe një prokuror, janë të përfshirë në të njëjtën shkelje disiplinore”	14457
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 20, datë 9.7.2024	Për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshimin e nivelit tarifor të Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Gjirokastër sh.a.....	14459
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 21, datë 9.7.2024	Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për Shoqërinë Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Pogradec sh.a.....	14461
Vendim i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 21, datë 4.7.2024	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH.....	14466
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 821/10, datë 11.7.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 662, datë 13.10.2022, “Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor ‘Rishikimi i projektit për segmentin rrugor të vazhdimin të ‘Unazës së Madhe’ Tiranë nga ‘Sheshi Shqiponja’–‘Bulevardi i Ri’ dhe ‘Rikualifikimi i ‘Unazës Lindore’ për lotet 4, 5, 6’”, i ndryshuar.....	14479



VENDIM
Nr. 458, datë 10.7.2024

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1140, DATË 24.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KRIMEVE TË RËNDA, 2021–2025, DHE PLANIN E VEPRIMIT 2023–2025”, TË NDRYSHUAR

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT PËR LUFTËN KUNDËR TRAFIKIMIT TË PERSONAVE 2024–2025

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shtojca 1, me titull “Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2021–2023”, që i bashkëlidhet vendimit nr. 1140, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me shtojcën 1, me titull “Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2024–2025”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Shkurtime

AMA	Autoriteti i Mediave Audiovizive
AKKSHI	Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit
AP	Autoriteti përgjegjës
ASHDMF	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve
ASCAP	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar
AKAP	Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DSHSB	Drejtoria e Shërbimeve Sociale në Bashki
DVKM	Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin
DRSHSSH	Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
ICITAP	Programi Ndërkombëtar i Asistencës për Trajnim në Hetimet Penale
ICMPD	Qendra Ndërkombëtare për Zhvillimin e Politikave të Migrimin
KB/UN	Kombet e Bashkuara

TABELA E PËRMBAJTJES

Shkurtime

PJESA I. KONTEKSTI STRATEGJIK

Hyrja dhe qëllimi

Konteksti i reformës dhe kuadri ligjor dhe institucional

Konteksti i përgjithshëm

Kuadri ligjor

Kuadri institucional

Arritje dhe mësimet 2021–2023

Rekomandimet nga raportet ndërkombëtare

Vizioni, parimet e përgjithshme, qëllimet politike

Vizioni

Parimet

QËLLIMET POLITIKE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË

PJESA V: MONITORIMI DHE RAPORTIMI



KRAT	Komitetet rajonale antitrafikim
KSH	Komiteti Shtetëror
KKSAT	Koalicioni Kombëtar i Strehëzave Antitrafik
MB	Ministria e Brendshme
MKR	Mekanizmi Kombëtar i Referimit
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MD	Ministria e Drejtësisë
MF	Ministria e Financave
MEKI	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
MKR	Mekanizmi i referimit të rasteve të dhunës në familje në nivel lokal
MMDHF	Mekanizmi i Mbrojtjes ndaj Dhunës së Fëmijëve
NJMF	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve
NJL	Njësi lëvizëse
OJF	Organizata jofitimprurëse
ON	Organizata ndërkombëtare
PKK	Pika e Kalimit Kufitar
PMF	Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijëve
PSV	Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
AKPA	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësi
ISHPSHSH	Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore
SPZ	Specialisti i policisë së zonës
TQNJ	Trafikimi i qenieve njerëzore
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Krimin dhe Drogat
VT	Viktimë trafikimi
VMT	Viktimë e mundshme trafikimi

PJESA I. KONTEKSTI STRATEGJIK

1.1 Hyrja dhe qëllimi

Plani Kombëtar i Veprimit (PKV) për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2024–2025 është dokumenti më i rëndësishëm politik kombëtar, i cili koordinon aktorët shtetërorë, organizatat ndërkombëtare dhe shoqërinë civile në përpjekjet e përbashkëta për të luftuar trafikimin e personave. PKV është një shprehje e qartë e vullnetit të qeverisë shqiptare për të marrë të gjitha masat e nevojshme të karakterit institucional, ligjor dhe buxhetor për t'iu përgjigjur në mënyrë të koordinuar trafikimit të personave. Bazat e ndërhyrjeve dhe veprimeve të përcaktuara në PKV-në mbeten parandalimi, hetimi dhe ndjekja, mbrojtja dhe riintegrimi social dhe ekonomik i viktimës/viktimës së mundshme të trafikimit.

Trafikimi i personave vijon të mbetet një fenomen shqetësues jo vetëm për Shqipërinë por

edhe për vendet e rajonit, si dhe vendet e BE-së, ndaj për luftimin dhe goditjen e tij është e domosdoshme që të ketë një përgjigje ndërsektoriale, të koordinuar dhe gjithëpërfshirëse nga të gjithë aktorët, shtetërorë dhe jositetëror kombëtarë dhe rajonal, të cilët duhet të ndërveprojnë në mënyrë të koordinuar dhe efektive.

Ky dokument është vazhdim i përpjekjeve dhe objektivave antitrafikim të parashikuara në Strategjinë kundër Krimin të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025 dhe Planin Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2021–2023, por të përshtatura me ndryshimet dinamike të formave dhe tendencave të trafikimit, vizionit të qeverisë, reformave të ndërmarra në fushën e antitrafikut, si dhe detyrimeve në kuadër të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, proceseve rajonale dhe ndërkombëtare.



Me qëllimin e hartimit të një plani gjithëpërfshirës, aktual, të realizueshëm dhe konform detyrimeve që Republika e Shqipërisë ka edhe në planin ndërkombëtar, janë analizuar dhe marrë në konsideratë gjetjet dhe rekomandimet e raporteve të organizatave ndërkombëtare për sa i përket situatës së trafikimit të personave në Shqipëri dhe, konkretisht: Progresraporti i BE-së, Këshilli i Evropës (GRETA), Zyra e Kombeve të Bashkuara për Krimin dhe Drogat dhe Raporti Global i Departamentit Amerikan të Shtetit, për Trafikimin e Personave.

Bazë e rëndësishme për hartimin e PKV-së mbetet analiza e raportit të monitorimit për zbatimin e PKV-së 2021–2023. Plani Kombëtar i Veprimit (PKV) për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2021–2023 ishte një plan gjithëpërfshirës me 55 masa konkrete në zbatim të 5 objektivave specifike, për realizimin e të cilave janë përfshirë 46 institucione dhe struktura për të punuar bashkërisht për më shumë transparencë, llogaridhënie, eficiencë dhe efektivitet në përpjekjet kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda në vend. Bazuar në raportin e monitorimit në nivelin e përgjithshëm i realizimit të Planit 2021–2023, për periudhën 2021–2023 është në vlerën 89%, me 43 masa të realizuara plotësisht, 6 masa të realizuara pjesërisht, si dhe 6 masa të parealizuar.

Niveli i lartë i zbatimit të masave është rezultat i përpjekjeve të vazhdueshme në mirëkoordinimin e veprimeve të institucioneve shtetërore me organizatat ndërkombëtare dhe shoqërinë civile.

Në këta 3 vjet, me rendësi për t'u theksuar është rritja e numrit të identifikimeve të VT-ve dhe VMT-ve, kryesisht nga njësitë lëvizëse që menaxhohen nga strehëzat, si dhe fuqizimi i grupeve vulnerabël të shoqërisë, VT-ve dhe VMT-ve nëpërmjet programeve që nxisin aftësimin profesional, punësimin dhe vetëpunësimin duke synuar integrimin e qëndrueshëm të VT-ve dhe VMT-ve, si dhe parandalimin e trafikimit.

Rritja e profesionalizmit të strukturave shtetërore ka qenë po ashtu një veprimtari e cila gjatë zbatimit të planit ka qenë e shtrirë si në nivel lokal ashtu edhe qendror, duke targetuar kryesisht punonjësit e administratës që ofrojnë shërbime dhe kanë detyra funksionale zbatimin e PSV-ve.

Përparime të rëndësishme konstatohen në zhvillimin e bashkëpunimit ndërinstitucional me rishikimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit për

Funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit, si dhe miratimin e udhëzimit të përbashkët të ministrave për ngritjen dhe funksionimin e Autoritetit Përgjegjës.

Ky plan synon që të adresojë sa më qartë të gjithë aksionin e strukturave shtetërore dhe jo shtetërore në luftën kundër trafikimit të personave duke zhvilluar me tej praktikën e mira të krijuara, intensifikimin e përpjekjeve për të realizuar ndërhyrjet që nuk kanë pasur sukses në zbatimin e PKV 2021–2023, si dhe t'u përgjigjet rekomandimeve të raporteve ndërkombëtare.

1.2 Konteksti i reformës dhe kuadri ligjor dhe institucional

1.2.1 Konteksti i përgjithshëm

Një ndër prioritetet kryesore të Qeverisë Shqiptare dhe të Ministrisë së Brendshme është forcimi i rendit dhe sigurisë publike, duke parashikuar këtu luftën kundër krimit të organizuar e trafikeve të paligjshme. Shqipëria ka një kuadër të plotë ligjor dhe nënligjor, si dhe një bazë të konsiderueshme dokumentesh strategjike, që adresojnë çështjet e krimit të organizuar.

Synimi strategjik i këtij dokumenti është realizimi i një sistemi të integruar të adresimit të të gjitha hallkave dhe elementeve që lidhen me trafikimin e personave dhe pasojat e tij, i cili bazohet në ndërveprimin efektiv institucional, brenda e jashtë vendit dhe bashkërendimin e veprimtarive.

Sikurse parashikohet dhe në Strategjinë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025 përpjekjet për parandalimin dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit duhet të vijojnë dhe intensifikohen nga të gjithë aktorët e përfshirë në luftën kundër trafikimit të personave, duke pasur në fokus fëmijët viktimë trafiku. Vlerësohet i domosdoshëm miratimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2024–2025, duke qenë se trafikimi i personave:

është një fenomen kompleks, që shkon përtej luftës kundër krimit të organizuar dhe lidhet drejtpërdrejt me garantimin e të drejtave të njeriut;

- është një fenomen që kërkon një qasje të fokusuar, gjithëpërfshirëse, më të gjerë se forcimi i aspekteve të hetimit dhe ndjekjes penale;

- kërkon garanci parandaluese dhe partneritet, mbrojtje dhe asistencë për viktimat e trafikimit, garanci që i jep një përqasje specifike, të veçantë dhe multidimensionale;

Plani Kombëtar i Veprimit bazohet në një analizë



të përgjithshme mbi situatën aktuale të trafikimit në Shqipëri që identifikon faktorët determinues që qëndrojnë në themel të trafikimit, si dhe grupet më të prekura të shoqërisë, si: gratë/vajzat, fëmijët dhe komunitetet etnike rome dhe egjiptiane. Krahës renditjes së disa prej arritjeve më të rëndësishme gjatë periudhës 2021–2023, në Planin e Veprimit identifikohen si fusha që synohet të përmirësohen gjatë zbatimit të këtij plani;

- garantimi i përputhjes së legjislacionit kombëtar penal dhe procedural penal mbi trafikimin e personave me standardet evropiane dhe ndërkombëtare;

- forcimi i mekanizmave për mbrojtjen e viktimave në të gjithë zinxhirin e drejtësisë penale (qasja, aksesimi në drejtësi);

- përmirësimi i reagimit nga policia, prokuroria dhe sistemi gjyqësor në drejtëm të zbatimit rigoroz të ligjeve në fuqi, në drejtëm të ushtrimit të ndjekjes penale, zhvillimit të procesit gjyqësor dhe garantimin e të drejtave të viktimave të trafikimit;

- sigurimi i identifikimit fillestar dhe referimeve për mbrojtje të fëmijëve dhe të rriturve si viktima/viktima të mundshme trafikimi për qëllime shfrytëzimi dhe referimi i menjëhershëm i tyre pranë shërbimeve të duhura të asistencës, bazuar në nevojat individuale në përputhje me Procedurat Standarde të Veprimit (PSV-të);

- garantimi në vazhdimësi i funksionimit efikas të Mekanizmit Kombëtar të Referimit dhe shtrirja e tij në nivel qarku, bashkie (nëpërmjet grupeve vendore të koordinimit për marrjen e masave parandaluese dhe identifikimin e personave të trafikuar) në përputhje me standardet dhe PSV-të;

- garantimi dhe qëndrueshmëria e ofrimit të shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe të përshtatshme për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit (fëmijë dhe të rritur në qendra ose jashtë, përfshirë asistencën sociale, mjekësore, psikologjike dhe ligjore, si dhe garantimi i respektimit të standardeve kombëtare të përcaktuara dhe PSV-ve;

- nxitja e kthimit dhe riintegrit, si dhe përfshirjes sociale të të miturve dhe të rriturve si persona të trafikuar (VMT dhe VT) dhe ulja e rrezikut për personat e trafikuar për t'u riviktimizuar, rritafikuar ose që të kthehen në trafikues;

- përmirësimi i parandalimit të trafikimit nëpërmjet forcimit të sistemeve mbrojtëse, krijimit të mundësive social-ekonomike dhe mundësive të tjera të jetesës, si dhe rritjes së ndërgjegjësimit;

- rritja e ndërgjegjësimit publik mbi të gjitha format e trafikimit të personave (trafikimi i brendshëm, shfrytëzimi për punë të detyruar të fëmijëve dhe të rriturve, lypja nga fëmijët etj.), si dhe pasojat e tij;

- forcimi i bashkëpunimit ndërkufitar dhe ndërkombëtar;

- bashkërendimi i të gjitha masave antitrafik dhe bashkëpunimi i frytshëm mes të gjithë aktorëve të përfshirë në luftën kundër trafikimit në Shqipëri dhe, veçanërisht, me Mekanizmin e Dhunës në familje dhe Sistemit të Integruar të Mbrojtjes së Fëmijëve në nivel qendror dhe lokal;

- përmirësimi i menaxhimit të të dhënave dhe informacionit mbi trafikimin e personave, si dhe krijimi i një mekanizmi për monitorimin, vlerësimin dhe rishikimin e vazhdueshëm të përpjekjeve antitrafik;

- sigurimi i qëndrueshmërisë financiare dhe institucionale të veprimtarisë antitrafik.

1.2.2 Kuadri ligjor

Kuadri ligjor që rregullon, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, luftën kundër trafikimit të personave, përfshin:

Legjislacionin ndërkombëtar të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë:

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut;

Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Individëve për sa i përket Përpunimit Automatik të të Dhënave Personale;

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës dhe Protokolli shtesë i Konventës për të Drejtat e Fëmijës për Shitjen e Fëmijës, Prostitucionin e Fëmijës dhe Pornografinë e Fëmijës;

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut;

Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Transnacional/ “Protokolli shtesë mbi parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e trafikimit të personave, në mënyrë të veçantë të grave dhe fëmijëve”;

Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Transnacional/ “Protokolli kundër Kontrabandimit të Emigrantëve në Rrugë Tokësore, Ajrore dhe Detare”;

Konventa e OKB-së për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave CEDAW;

Konventa e Këshillit të Evropës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”;



Konventa evropiane “Për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme”;

Konventa e Vjenës mbi Marrëdhëniet Konsullore;

Konventa e Konferencës së Hagës “Për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit”;

Konventa e Konferencës së Hagës “Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin, në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve”;

Konventa e Konferencës së Hagës “Për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve”;

Konventa e Konferencës së Hagës “Për ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore”;

Konventa e Konferencës së Hagës “Për njohjen dhe zbatimin e vendimeve në lidhje me detyrimet ushqimore”;

Konventa e Këshillit të Evropës “Për mbrojtjen e fëmijëve kundër shfrytëzimit dhe abuzimeve seksuale”;

Konventa e Këshillit të Evropës “Për statusin juridik të fëmijëve të lindur jashtë martesës”;

Konventa e Këshillit të Evropës “Për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve”;

Konventa e Konferencës së Hagës “Për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes” (miratuar në parim, nga Këshilli i Ministrave, në mbledhjen e datës 26.5.2011);

Konventa e Këshillit të Evropës kundër Trafikimit të Organeve Njerëzore;

Konventat e ILO-s nr. 29 “Për punën e detyrueshme”, 138 “Mosha minimale për pranimin në punë” dhe 182 “Për ndalimin dhe veprimet e menjëhershme për eliminimin e formave më të këqija të punës së fëmijëve”.

Legjislacionin shqiptar:

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar;

Ligji nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 110/a “Trafikimi i të rriturve”, neni 128/b, “Trafikimi i të miturve”, neni 298 “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”, neni 124/b, “Keqtrajtimi i të miturit”, neni 117 “Pornografia”;

Ligji nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj

dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar;

Ligji nr. 108/2014, “Për policinë e shtetit”, të ndryshuar;

Ligji nr. 79/2021, “Për të huajt”;

Ligji nr. 10/2021, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të ndryshuar;

Ligji nr. 10173, datë 22.10.2009, “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar;

Ligji nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit përmes masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”;

Ligji nr. 98/2017, “Për tarifat gjyqësore në RSH”;

Ligji nr. 37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”;

Ligji nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”;

Ligji nr. 10 383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 44/2012, “Për shëndetin mendor”, të ndryshuar;

Ligji nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar;

Vendimi nr. 1140, datë 24.12.2020, i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025 dhe Planin e Veprimit 2021–2022”;

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 499, datë 29.8.2018, “Për miratimin e Procedurave Standarde të Veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 195, datë 11.4.2007, “Për miratimin e Standardeve të



shërbimeve të përkujdesit shoqëror, në qendrat rezidenciale, për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi”;

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 108, datë 15.2.2017, “Për miratimin e rregullores ‘Për mbrojtjen e fëmijëve në punë’”, i ndryshuar;

Vendimi nr. 933, datë 2.7.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për përfaqësimin e Ministrisë së Brendshme me oficerë kontakti në Britaninë e Madhe, Belgjikë, Itali, Greqi, Turqi, Kosovë dhe Europol”, i ndryshuar;

Udhëzimi i përbashkët nr. 132, datë 8.9.2023, “Për ngritjen e autoritetit përgjegjës për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit”;

Urdhri nr. 805, datë 1.8.2017, i ministrit të Brendshëm, “Për forcimin e kontrollit të shtetasve shqiptarë që kalojnë kufirin shtetëror”;

Memorandumi i mirëkuptimit, i Ministrisë së Brendshme, i Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe i Prezencës së Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunimin në Evropë në Shqipëri (OSCE) “Për promovimin dhe zbatimin e Kodit të Sjelljes për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual në Turizëm” (nënshkruar në vitin 2007);

Marrëveshja e bashkëpunimit për funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit të personave (MKR), datë 26 qershor, 2023.

Nëpërmjet Planit të Veprimit përcaktohen detyrime konkrete për institucionet dhe agjencitë shtetërore dhe joshtetërore, si dhe përgjegjësitë dhe kontributi i tyre në luftën kundër trafikimit të personave duke garantuar një mbrojtje gjithëpërfshirëse për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit. PKV-ja ruan frymën e një bashkëveprimi të ndërsjellë të krijuar tashmë ndërmjet të gjithë aktorëve shtetërorë dhe joshtetërorë dhe synon forcimin e këtij bashkëpunimi dhe institucionalizimin e tij nëpërmjet aplikimit të një politike të hapur, proaktive dhe gjithëpërfshirëse. Një pjesë e mirë e aktiviteteve të nisura gjatë zbatimit të PKV 2021–2023, parashikohen të konsolidohen dhe fuqizohen më tej në Planin e Veprimit 2024–2025. Shembujt dhe praktikat e mira janë shprehur në aktivitete konkrete dhe të matshme.

1.2.3 Kuadri institucional

Ministria e Brendshme, bazuar në VKM-së nr.

604, datë 20.10.2021, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme”, të ndryshuar, është institucioni kryesor përgjegjës i cili bashkërendon punën për parandalimin e trafikimit, mbrojtjen e të drejtave të viktimave të trafikimit dhe riintegrimin e tyre.

Zbatimi i këtij plani veprimi bazohet në bashkëpunimin e shumë aktorëve shtetërorë ku rol më të spikatur ka Ministria e Brendshme dhe institucionet e saj të varësisë dhe përfshin një listë të gjerë aktorësh të tjerë shtetërorë. Ky Plan Veprimi është planifikuar të realizohet në bashkëpunim dhe me aktorë joshtetërorë, që përfshin organizatat ndërkombëtare dhe organizata jofitimprurëse të cilat ushtrojnë veprimtarinë në fushën e antitrafikimit dhe adresimit të faktorëve nxitës të tij.

Institucionet shtetërore në nivel qendror dhe vendor, që janë përgjegjëse dhe/ose bashkëpunojnë me Ministrinë e Brendshme për zbatimin e planit dhe për të shkëmbyer informacion, janë:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
Ministria e Drejtësisë;
Ministria e Financave;
Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;
Ministria e Arsimit dhe Sportit;
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve;
Shërbimi Social Shtetëror;
Byroja Kombëtare e Hetimit;
Prokuroria e Posaçme;
Prokuroria e Përgjithshme;
Shkolla e Magjistraturës;
Dhoma Kombëtare e Avokatëve;
Autoriteti i Mediave Audiovizive;
Komitetet Rajonale Antitrafikim;
Njësitë e vetëqeverisjes vendore;
Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive;
Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar;
Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar;
Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

1.2.4 Koordinimi ndërinstitucional

Spektori i Antitrafikut në Drejtorinë e Politikave



për Antitrafikun dhe Migracionin në Ministrinë e Brendshme, është struktura kryesore për koordinimin e aktiviteteve antitrafik në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Kjo zyrë ka si detyrë kryesore koordinimin e përpjekjeve antitrafik në shkallë vendi e më gjerë në drejtëm të 4 shtyllave kryesore: parandalimit, mbrojtjes dhe asistencës ndaj viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit, ndjekjes penale të trafikantëve dhe personave të përfshirë në të, si edhe partneritetit qoftë ndërmjet institucioneve shtetërore, po ashtu, atyre shtetërore të pavarura, si edhe organizatave vendase dhe organizmave ndërkombëtare, partnere aktive në përpjekjet antitrafik.

Marrëveshja për funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit përbën marrëveshjen bazë ndërinstitucionale dhe instrumentin më të rëndësishëm të dakordësuar ndërmjet 15 institucioneve dhe organizatash për identifikimin, referimin dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit. MKR është rivitalizuar nëpërmjet ngritjes së Task-Forcës së MKR-së, e cila vë në lëvizje të gjithë mekanizmin, duke garantuar monitorimin e zbatimit të saj dhe bashkërendimin e veprimit ndërinstitucional të anëtarëve në MKR. Ky dokument është rishikuar në muajin qershor 2023 duke reflektuar ndryshimet strukturore të institucioneve të përfshira, me struktura të reja me qëllim koordinimin e përpjekjeve, të të gjitha strukturave të angazhuara me mbrojtjen e viktimave të trafikimit, parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të personave, si dhe me qëllim rritjen e rolit të inspektorëve të punës në identifikimin fillestar të viktimave të mundshme të trafikimit dhe adresimin e qasjes me “në qendër” viktimën nëpërmjet arsimimit dhe formimit profesional, ka përfshirë si anëtarë në MKR, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nëpërmjet Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive dhe Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, institucion në varësi të Ministrisë së Brendshme.

Autoriteti përgjegjës¹ për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e VT/VMT, ngritur me udhëzimin e përbashkët nr. 132, datë 8.9.2023. Në AP trajtohen raste konkrete të

viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit, si dhe përpunohen të gjitha të dhënat mbi këto raste deri në zgjidhjen e tyre, ku viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit, i është dhënë ndihma e menjëhershme dhe afatgjatë. Ky udhëzim ka përfshirë në autoritet struktura të rëndësishme, si: Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, Sektorin kundër krimit Kibernetik në Policinë e Shtetit etj. Autoriteti ka hartuar dhe miratuar rregulloren e funksionimit të tij, sipas parashikimeve të udhëzimit nr. 132, datë 8.9.2023.

Komitetet rajonale antitrafik (KRAT)² janë struktura kryesore qendrore në nivel qarku për identifikimin fillestar të viktimave të mundshme të trafikimit, evidentimin e problemeve parësore në nivel rajonal/lokal dhe vlerësimin e gjendjes dhe përcaktimin e nevojave specifike të qarkut, të cilat drejtohen nga Prefekti i secilit qark.

Bordi Këshillimor për Viktimat/Viktimat e Mundshme të Trafikimit me 3 anëtarë i ngritur në prill 2019 funksionon si një strukturë këshilluese nga viktimat për viktimat dhe merr pjesë në hartimin e politikave dhe programeve për viktimat e trafikimit. Ka rol këshillimor për çështjet e luftës kundër trafikimit të personave dhe për mbrojtjen të drejtave të viktimave, të cilat rrjedhin nga legjislacioni dhe konventat ndërkombëtare. Luan rol aktiv në rritjen e ndërgjegjësimit të publikut mbi shfrytëzimin e personave për qëllime seksuale, punë të detyruar, lypje apo forma të tjera të shfrytëzimit.

Mbrojtja dhe asistenca ndaj viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit (VT/VMT) ofrohet në strehëzat e ngritura për viktimat e trafikimit si dhe në komunitet. Funksionojnë katër qendra: Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit (shtetërore), organizata “Tjetër Vizion”, Qendra Psikosociale “Vatra”, dhe Organizata “Të ndryshëm dhe të barabartë” (joshtetërore) që ofrojnë shërbime direkte dhe riintegruese për VT/VMT, si: asistencë psikologjike, shëndetësore, ligjore, formim profesional, ndërmjetësim për bashkim me familjet, punësim dhe edukim, për viktimat e mundshme dhe viktimat e trafikimit, të huaja ose vendase, fëmijë ose të rritur, meshkuj ose femra. Prej disa vitesh,

¹ Udhëzimi nr. 132, datë 8.9.2023, “Për ngritjen e autoritetit përgjegjës për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”.

² Urdhrin e Kryeministrit nr. 6, datë 26.1.2017, “Për ngritjen e Komitetit Rajonal të Luftës kundër Trafikimit të Personave, në çdo qark”.



mundësohen nga buxheti i shtetit, konkretisht, Programi Buxhetor “Përkujdesi social”- MSHMS, pagesat e 29 punonjësve socialë që ofrojnë shërbime në qendra rezidenciale jopublike dhe fondi i ushqimit për viktimat e trafikimit.

Gjithashtu edhe kujdesi shëndetësor ofrohet nga shërbimet shëndetësore publike, ku viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit, përfshihen në kategorinë e personave ekonomikisht joaktivë, kontributet shëndetësore të cilëve mbulohen nga buxheti i shtetit.

Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar ka rëndësi të madhe strategjike dhe politike në luftën kundër trafikimit të personave pasi është fenomen global dhe kërkon goditje dhe masa të koordinuara mes shteteve për të intensifikuar përpjekjet në luftën kundër trafikimit të personave. Janë marrë një sërë masash për intensifikimin e mëtejshëm të këtyre bashkëpunimeve duke vazhduar zbatimin e Marrëveshjeve dhe Protokolleve me Kosovën Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, Greqinë dhe Mbretërinë e Bashkuar për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit.

1.2.5 Arritje dhe mësimet 2021–2023

Nëpërmjet **proceseve të ndryshme reformuese, zhvillimit të kuadrit legjislativ, investimit në rritjen e kapaciteteve të personelit** dhe masave të tjera të ndërmarra me qëllim realizimin e objektivave të Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2021–2023, janë realizuar një sërë arritjesh si nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit për Funkcionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit, dhe miratimi i udhëzimit të përbashkët nr. 132, datë 8.9.2023, “Për ngritjen e Autoritetit Përgjegjës për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe asistencën e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”. Miratimi i udhëzimit të përbashkët është pasuar nga rregullorja për funksionimin e AP dhe formatet e raportimit.

Gjithashtu, në proces është rishikimi i Memorandumit të Mirëkuptimit mes MB, ISHPSSH dhe PSH, duke përfshirë në këtë marrëveshje edhe Drejtorinë e Përgjithshme të

Tatimeve. Grupi i punës për rishikimin e këtij dokumenti është ngritur dhe janë zhvilluar takime me anëtarët e GP. Pritet dakordësia finale mbi draftin për të vijuar me nënshkrimin e tij.

Ministria e Drejtësisë vijon procesin për hartimin e Kodit të ri Penal. Në janar të vitit 2023 është krijuar grupi i ri punës me qëllim garantimin e finalizimit të procesit brenda afateve të përcaktuara. Kodi Penal është një akt tepër kompleks, i cili kërkon bashkëpunimin dhe konsultimin me një sërë institucioneve, me qëllim trajtimin e të gjitha problematikave të evidentuara në analizën e kryer si dhe përafrimin me aktet dhe standardet ndërkombëtare. Miratimi i një ligji të veçantë kundër trafikimit të personave dhe për mbrojtjen e VT/VMT dhe përafrimi për aq sa është e mundur me direktivën përkatëse³ mbetet ende një masë e pazbatuar. Në vlerësimin e institucioneve shtetërore dhe organizatave evidentohet nevoja që një sërë çështjesh specifike që lidhen me luftën kundër trafikimit të personave dhe trajtimin e VT/VMT mbetet relevante.

Identifikimi, referimi, asistenca dhe riintegrimi i viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit kanë pasur fokus të shtuar duke synuar partneritete të qëndrueshme për të arritur synimet dhe objektivat strategjikë. Konkretisht, janë hartuar dhe shpërndarë 9000 broshura orientuese për stafin arsimor, shëndetësor, shërbimin social, konsullor, policinë e kufirit, trafikëve dhe strukturat e tjera të policisë, njësitë lëvizëse, strukturat jo anëtare të MKR-së, në lidhje me zbatimin e PSV-ve. Punonjës të strukturave ligjzbatuese, profesionistë të vijës së parë, janë trajnuar lidhur me identifikimin e viktimave të mundshme të trafikimit.

Të gjitha viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit janë informuar dhe këshilluar për të drejtat e tyre dhe iu është ofruar gjithë ndihma e nevojshme shëndetësore, psikosociale, ligjore, formimi profesional, regjistrimi në gjendjen civile, regjistrimi në shkollë, kthimi vullnetar i asistuar, këshillim dhe ndërmjetësimi për punësim. Iu është siguruar ndihmë juridike e specializuar dhe falas që në fazë të hershme të procesit duke garantuar lehtësimin i aksesit në drejtësi.

Ka vijuar financimi nga buxheti i shtetit, nga

³ Direktiva 2011/36 “Mbi parandalimin dhe luftën e trafikut të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tyre”.



Programi Buxhetor “Përkujdesi social” – MSHMS, për qendrat pritëse dhe riintegruese joshitetore për 29 punonjës socialë dhe ushqimi për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit, të akomoduar në strehëza. Konkretisht, për vitin 2021, 2022 dhe 2023 nga buxheti i shtetit në total/çdo vit është financuar **Organizata “Të ndryshëm dhe të barabartë”**, me vlerën 6,920,400 lekë (fond ushqimesh) dhe 20,280,974 lekë (fond pagash për 9 punonjës); **Organizata “Tjetër vizion”**, me vlerën 7,449,000 lekë (fond ushqimesh) dhe 18,606,205 (fond pagash për 9 punonjës); **Qendra Psikosociale “Vatra”**, me vlerën 6,920,400 lekë (fond ushqimesh) dhe 28,445,274 lekë (fond pagash për 12 punonjës), si dhe **QKPV**, në vlerë 17,118,014 lekë (fond ushqimesh) dhe 50,739,000 lekë (fond pagash për 17 punonjës).

Gjithashtu, ngritja e njësive të reja lëvizëse ka mundësuar rritjen e numrit të identifikimeve të rasteve të trafikimit, kryesisht me qëllim lypjen punën e detyruar, vepra të ulëta kriminale etj.

Forcimi i kapaciteteve të linjës kombëtare falas 116-006 dhe aplikacionit “Raporto dhe shpëto” për të mundësuar këshillimin dhe raportimin e rasteve të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore, ka mbetur e pazbatuar plotësisht. Në muajin dhjetor 2023, Ministria e Brendshme vuri në funksion linjën 116006, e cila funksionon pranë Sektorit Antitrafik. MB-ja në bashkëpunim me UNICEF-in ka filluar projektimin e aplikacionit, duke synuar që të sigurohet si shërbim dhe të prodhojë rezultate të synuar në PKV 2024–2025. Rivitalizmi i linjës do të pasohet dhe me një fushatë të dedikuar informimi dhe promovimi nëpërmjet prodhimit dhe shpërndarjes së posterave informues mbi linjën kombëtare dhe aplikacionin në 12 qarqe, përfshirë 61 bashki, pikat e kalimit kufitar dhe qendrat informuese. Po ashtu pjesë e këtij aksioni do të jetë dhe trajnimi i punonjësve të sallës operative mbi komunikimin etik, referimin e problematikave të adresuara dhe mbrojtjen e të dhënave personale sipas legjislacionit në fuqi.

Vëmendje të shtuar do të ketë po ashtu edhe organizmi i takimeve dhe trajnimeve me gazetarët, mbi rolin e medias në parandalimin e trafikimit të personave, rëndësinë e trafikimit si shkelje serioze e të drejtave të njeriut dhe të drejtave në punë (shfrytëzimi në punë, shfrytëzimi ekonomik i fëmijëve, lypja, shfrytëzimi seksual, martesat nën moshë), si dhe respektimin e garantimin e të drejtës

së ruajtjes së jetës private të VT/VMT dhe veçanërisht të fëmijëve, si kategoria më vulnerabël.

Vlerësohet shumë e rëndësishme që të gjithë personat e angazhuar në luftën kundër trafikimit të personave të trajtojnë çdo rast në përputhje me parashikimet ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale duke garantuar të drejtën e ruajtjes së jetës private

Në drejtim të parandalimit dhe ndërgjegjësimit të komunitetit lidhur me fenomenin e trafikimit, janë organizuar takime ndërgjegjësuuese në shkollë, me komunitetet vulnerabël, me partnerë lokale si administratorë shoqërorë, punonjës të mbrojtjes së fëmijës, punonjës të strukturave në bashki si dhe çdo vit janë zhvilluar aktivitete gjatë Muajit Antitrafik. Është financuar ngritja e *start-up*-eve për grupe vulnerabël, kryesisht gra kryefamiljare, familje me probleme të theksuara sociale dhe ekonomike, fëmijë jetimë etj., si dhe është ofruar këshillim, mentorim, aftësim profesional dhe ndërmjetësim për punësim.

Në drejtim të koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional, rajonal dhe ndërkombëtar, janë organizuar takime me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë, si takimi me donatorët, janë zhvilluar takime bashkërenduese rajonale dhe ndërkombëtare, të tilla si takimi me ekspertë të GRETA-s, UN, MARRI, UNODC, ICMPD, OSBE, janë realizuar takime me partnerët lokalë për prezantimin e PKV si dhe janë mbajtur takime periodike të anëtarëve të Mekanizmit Kombëtar të Referimit dhe të autoritetit përgjegjës.

1.2.6 Rekomandimet nga raportet ndërkombëtare

Komisioni Evropian në kuadër të procesit *screening* mbi kapitullin 24, vlerëson se Mekanizmi Kombëtar i Referimit për viktimat (e mundshme) të trafikimit është funksional dhe ofrohet asistencë, megjithatë, identifikimi i viktimave të mundshme mbetet i pamjaftueshëm brenda territorit shqiptar, edhe mes migrantëve vulnerabël që hyjnë në vend ndaj, ka rekomanduar përmirësimin e identifikimit të hershëm dhe mbrojtjen e viktimave. Referuar kuadrit ligjor vlerëson se është përmirësuar duke përfshirë ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale por që ende nuk është zbatuar. Rekomandon financimin e strehëzave të drejtuara nga organizatat jofitimprurëse, si dhe financimin e mjaftueshëm për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit kundër trafikimit të personave.



Gjithashtu, rekomandon rritjen e përpjekjeve kundër trafikimit, duke u fokusuar veçanërisht në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve dhe krijimin e një *track-record* mbi numrin e dënimeve përfundimtare për trafikim të qenieve njerëzore. Qasja e përqendruar te viktima duhet të jetë më e mirë dhe më e integruar sa i përket hetimeve dhe ndjekjeve penale.

Komiteti i Palëve në Konventën e Këshillit të Evropës për Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, nëpërmjet raportit të tretë të vitit 2020 ka njohur progresin e arritur nga autoritetet shqiptare në zbatimin e Konventës, kryesisht, për: ndryshimet legislative që forcojnë të drejtat dhe pozitën e viktimave të veprave penale dhe parashikojnë të drejta të veçanta për fëmijët viktima, viktima të abuzimit seksual dhe viktima të trafikimit të qenieve njerëzore; miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2018–2020, zbatimi i të cilit mbështetet nga një buxhet i dedikuar; ekzistencën e një njësie të specializuar që merret me hetimin e veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore në kuadër të Departamentit të Policisë Kriminale, si dhe ngritjen e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; rishikimin e Procedurave Standarde të Veprimit lidhur me zbatimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit (MKR); përpjekjet për përmirësimin e qasjes proaktive për identifikimin e viktimave nëpërmjet krijimit të njëjësive lëvizëse që vizitojnë vendet ku ka rreziqe trafikimi si dhe angazhimin aktiv në bashkëpunimin ndërkombëtar në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Përveç progresit në çështjet më sipër, është rekomanduar që të merren masa për të adresuar çështjet lidhur me lehtësimin dhe garantimin e aksesit në drejtësi për viktimat e trafikimit duke siguruar që të marrin asistencë juridike të specializuar dhe ndihmë juridike falas në të gjitha fazat nga avokatë të specializuar për të trajtuar çështjet e trafikimit; lehtësimin dhe garantimin e aksesit të viktimave në kompensimin si nga autorët e veprës penale por edhe nga shteti; sigurimin që çështjet e trafikimit të hetohen në mënyrë proaktive, të ndiqen penalisht në mënyrë efektive dhe të çojnë në sanksione efektive, proporcionale dhe bindëse; identifikimin në mënyrë proaktive të viktimave të trafikimit, në veçanti edhe viktimat e trafikimit me qëllim shfrytëzimin në punë; ndihmën e ofruar ndaj

viktimave të trafikimit duke siguruar financimin e duhur ndaj strehëzave të drejtuara nga organizatat jofitimprurëse, strehimin dhe akses në shërbime edhe të viktimave të trafikimit meshkuj dhe lehtësimin e riintegrit nëpërmjet trajnimeve profesionale dhe aksesit në tregun e punës.

Departamenti Amerikan i Shtetit, në raportin e publikuar në Korrik 2023, vlerëson përpjekjet e qeverisë shqiptare për eliminimin e trafikimit, kryesisht në kuadër të identifikimit, mbrojtjes dhe riintegrit të viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit. Megjithatë, kërkohet ndërmarrja e veprimeve konkrete me qëllim përmbytjen e standardeve minimale në disa fusha kyçe, të tilla si hetimi, ndjekja penale dhe dënimi adekuat i trafikantëve si dhe parandalimi i trafikimit të personave. Me prioritet rekomandohet që të merren masa lidhur me hetimin, ndjekjen penale dhe dënimin e trafikantëve duke marrë parasysh ashpërsinë e dënimit ndaj tyre dhe mosaplikimin e veprave penale më të lehta kur është e mundur; institucionalizimin dhe ofrimin e trajnimeve për institucionet e zbatimit të ligjit, prokurorët dhe gjyqtarët për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të trafikimit, duke përfshirë udhëzime për çështjet e pëlqimit dhe detyrimit në kontekstin e trafikimit të punës dhe seksit; zbatimin e qasjeve të përqendruara te viktima dhe masave mbrojtëse të viktimave-dëshmitarëve gjatë hetimeve, ndjekjeve penale dhe procedurave gjyqësore; trajnimin e gjyqtarëve për kthimin në çështjet penale, vendosjen e procedurave për sekuestrimin e pasurive nga trafikantët dhe krijimin e metodave efektive për shpërndarjen në kohën e duhur; integrimin e grupeve rome në proceset vendimmarrëse në lidhje me mbrojtjen e viktimave; funksionimin e qëndrueshëm të njëjësive lëvizëse dhe pjesëmarrjen efektive të punonjësve të zbatimit të ligjit në to; përfshirjen e shërbimeve të shëndetit mendor për viktimat dhe edukimin për fëmijët viktima, në shërbimet riintegruese; rritjen e fondeve dhe krijimin e mekanizmave për shpërndarjen e burimeve të përshtatshme financiare për shtrehëzat për viktimat e trafikimit të drejtuara nga organizata jofitimprurëse; zgjerimin e juridiksionit të inspektorëve të punës për të inspektuar bizneset që nuk janë të regjistruara ligjërisht; funksionimin efektiv të linjës telefonike dhe përfshirjen e numrave në fushatat ndërgjegjësuere; rritjen e përpjekjeve për identifikimin e popullsisë vulnerabël dhe trajnimin e



punonjësve të policisë dhe zyrtarëve të tjerë të vijës së parë për identifikimin proaktiv të viktimave

1.3 Vizioni, parimet e përgjithshme, qëllimet politike

1.3.1 Vizioni

PKV-ja bazohet në vizionin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda dhe, në veçanti, synon të sigurojë që qeveria shqiptare dhe të gjithë aktorët shtetërorë dhe joshetërorë janë të angazhuar dhe përkushtuar për të parandaluar dhe luftuar trafikimin e personave dhe për të siguruar mbrojtjen e individëve dhe grupeve vulnerabël nga trafikimi, marrjen e masave efektive ligjore ndaj autorëve të krimit të trafikimit të personave, si dhe mbrojtjen e respektimit të të drejtave të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit dhe, veçanërisht, fëmijëve e grave.

Përgjatë gjithë dokumentit strategjik përçohet vizioni, se trafikimi i personave mund të parandalohet me sukses vetëm nëpërmjet fuqizimit social dhe ekonomik të grupeve dhe personave në nevojë, zbatimit efikas të ligjit dhe ndëshkimit të shkelësve, si dhe fuqizimit të shërbimeve dhe kapaciteteve në ndihmë të personave të trafikuar, qofshin këta viktimë apo viktimë të mundshme të trafikimit.

Ky vizion është në përputhje dhe me vizionin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integritet 2030 “Shqipëria me një shoqëri pa trafikim, krim të organizuar dhe kërcënime terrorizmi, dhe me imazh të një vendi paqësor dhe me standarde evropiane të sigurisë”, në lidhje me objektivat e parashikuara për krijimin e një mjedisi të sigurt për shoqërinë, uljes së trafikimit të paligjshëm dhe në veçanti, e trafikimit të qenieve njerëzore nga/përmes Shqipërisë, si dhe krijimin e një shërbimi hetimor bashkëkohor dhe forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rajonal.

Misioni i PKV-së është promovimi i një reagimi efektiv, adekuat dhe të bashkërenduar për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të personave të bazuar në bashkëpunimin ndërkombëtar, bashkëpunimin efektiv ndërinstitucional brenda vendit, pjesëmarrjen e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit dhe përfshirjen e shoqërisë civile dhe komunitetit

Gjithashtu, ngritja e mekanizmave bashkërendues, duke filluar nga niveli bazë do të mundësonte qëllimin përfundimtar të çdo nisme antitrafik, që është identifikimi i çdo viktime

trafikimi për t'i dhënë ndihmën, mbrojtjen dhe mbështetjen e nevojshme për një rindërgjyrim efektiv dhe të qëndrueshëm në shoqëri.

1.3.2 Parimet

Ky plan veprimi mbështetet në parimet e mëposhtme:

Përgjegjësia shtetërore: shteti ka përgjegjësi të marrë masa për të reaguar dhe përgjigjur ndaj situatës së trafikimit në kohë, me efektivitet, në mënyrë gjithëpërfshirëse, të koordinuar dhe në përputhje me detyrimet ndërkombëtare.

Respektimi i të drejtave të njeriut është konsideratë parësore: të drejtat e personave të trafikuar duhet të jenë në qendër të të gjitha përpjekjeve për të parandaluar e luftuar trafikimin dhe për të mbrojtur viktimat. Masat antitrafik nuk duhet të ndikojnë negativisht te të drejtat e njeriut dhe dinjiteti i personave dhe veçanërisht te viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit.

Sigurimi i mbështetjes efektive të viktimave të trafikuar/viktimave të mundshme të trafikuar: mbështetja e viktimave dhe të mbijetuarve të trafikimit bazohet në një qasje holistike, të ndjeshme nga pikëpamja gjinore, të përshtatur nga pikëpamja kulturele, që ka në qendër viktimat dhe konsideron efektet e traumës.

Qasja ndërinstitucionale: të gjithë aktorët shtetërorë dhe joshetërorë të përfshirë në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, bashkëpunojmë në mënyrë efektive për të përmbushur objektivat/detyrimet e këtij Plani Veprimi.

PJESA II. QËLLIMET E POLITIKËS DHE OBJEKTIVAT E VEÇANTË TË KUADRIT STRATEGJIK

PKV-ja bazohet dhe del në zbatim të Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025, për të adresuar këto qëllime të politikës:

1. Ulja e kërcënimit dhe ndikimit të Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, me objektiv specifik dhe masë prioritare:

1.1 Goditja e trafikeve të paligjshme;

1.1.1 Rishikimi i kuadrit ligjor kombëtar;

1.1.2 Forcimi i kapaciteteve të strukturave të drejtësisë dhe Policisë së Shtetit për hetimin proaktiv, ndjekjen penale, dënimin dhe sekuestrimin e pasurive të trafikantëve;

1.1.3 Shkëmbimi i informacionit dhe koordinimi ndërinstitucional i strukturave përgjegjëse për hetimin dhe ndjekjen penale.



2. Mbrojtja e qytetarëve, institucioneve dhe ekonomisë, me objektiva specifike:

1.1 Identifikimi dhe mbështetja e individëve në rrezik për t'iu nënshtruar shtrëngimit, dhunës dhe frikësimit nga krimi i organizuar;

1.1.1 Rishikimi i VKM-së nr. 499 “Për miratimin e procedurave standarde të veprimit”;

1.1.2 Identifikimi në kohë i viktimave të trafikimit dhe VMT dhe ofrimi i ndihmës dhe mbështetjes gjithëpërfshirëse dhe përkatëse për nevojat e tyre.

1.2 Rritja e profesionalizmit:

2.1	Objektivi specifik 2.1: Identifikimi dhe mbledhja e individëve në rrezik për t'u mbledhur shprehimisht, dhunës dhe frikësimit nga krimi i organizuar																						
	Masat																						
2.1.1	2.1.1. Rrëdhënia e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 499, datë 29.8.2018, "Për miratimin e procedurave standarde të vëprimit për mbledhjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit"		01110 Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi (16)	MB	MKR, KRAT, QJF	2024	2024	4,676,028	0	4,676,028	0	0	0	4,676,028	0	4,676,028	3,326,028	0	3,326,028	0	0	0	1,350,000
2.1.1.1	2.1.1.1. Realizimi i studimit mbi nivelin e detyrimit të procedurave standarde të vëprimit, miratuar me VKM nr. 499, datë 29.8.2018, nga struktura përgjegjëse për identifikimin e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit		01110 Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi (16)	MB	MKR, KRAT, QJF	2024	2024	1,637,737	0	1,637,737	0	0	0	1,637,737	0	1,637,737	287,737	0	287,737	0	0	0	1,350,000
2.1.1.2	2.1.1.2. Organizimi i kryesive konsultave të studimit me të gjithë aktorët shtetërorë dhe jo-shtetërorë që udhëzojnë veprimtaritë në fushën e identifikimit		01110 Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi (16)	MB	MKR, KRAT, QJF	2024	2024	459,000	0	459,000	0	0	0	459,000	0	459,000	459,000	0	459,000	0	0	0	-
2.1.1.3	2.1.1.3. Identifikimi i problematikave dhe nevojave për ndryshimin/institucionalizimin e procedurave standarde të vëprimit		01110 Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi (16)	MB	MKR, KRAT, QJF	2024	2024	1,503,198	0	1,503,198	0	0	0	1,503,198	0	1,503,198	1,503,198	0	1,503,198	0	0	0	-
2.1.1.4	2.1.1.4 VKM nr. 499, të rishikohet bazuar në rezultatet e studimit si dhe bazuar në praktikën me të mirë ndërkombëtare		01110 Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi (16)	MB	MKR, KRAT, QJF	2024	2024	1,076,093	0	1,076,093	0	0	0	1,076,093	0	1,076,093	1,076,093	0	1,076,093	0	0	0	-
2.1.2	2.1.2 Identifikimi në kohë i viktimave të trafikimit dhe VMT dhe detyra të ndërmarrjes dhe mbledhjes dhe nga shërbimet e punësimi, në përputhje me nevojat e tyre		10550 Tregu i punës, 1130 Menaxhimi dhe zhvillimi i administratës publike ASPPA, 01110 Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi (13), 01110 Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi (16), 10430 Përkrahje sociale 03140 Policia e Shtetit	MEKI AKPA	AKPA, AKSHI, MEKI, MB, DKM, ISHPSSH	2024	2025	32,150,136	0	32,150,136	16,829,905	0	16,829,905	48,980,041	0	48,980,041	37,204,297	0	37,204,297	11,775,744	0	11,775,744	-
2.1.2.1	2.1.2.1 Hartimi dhe botimi i broshurave informuese dhe manualeve të punës kthyer me punën e përgjigjeve të ISHPSSH dhe AKPA ndaj VT dhe VMT		10550 Tregu i punës	MEKI	MB, AKPA; ISHPSSH	2024	2024	12,928,185	0	12,928,185	0	0	0	12,928,185	0	12,928,185	12,928,185	0	12,928,185	0	0	0	-
2.1.2.2	2.1.2.2 Tregimi për çështje të modifikimit ndaj detyrës së shërbimeve ndaj VTM		1330 Menaxhimi dhe zhvillimi i administratës publike ASPPA	ASPA	KDM; MEKI, AKPA; ISHPSSH	2024	2024	1,196,023	0	1,196,023	0	0	0	1,196,023	0	1,196,023	1,196,023	0	1,196,023	0	0	0	-
2.1.2.3	2.1.2.3 Tregimi i profesioneve që kanë kontakt të drejtpërdrejtë me VTM, për çështje të diskriminimit		01110 Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi (16)	KMD	MB; MKR	2024	2025	1,196,023	0	1,196,023	0	0	0	1,196,023	0	1,196,023	1,196,023	0	1,196,023	0	0	0	-
2.1.2.4	2.1.2.4 Punësimi dhe mbledhja në arsim e formim profesional i VTM/MT nëpërmjet përfshirjes në programet e punësimi apo mundësi për burimet për të rinjtë		10550 Tregu i punës	AKPA	MEKI	2024	2025	5,887,872	0	5,887,872	5,887,872	0	5,887,872	11,775,744	0	11,775,744	0	0	11,775,744	0	0	UNICEF	11,775,744
2.1.2.5	2.1.2.5 Sigurimi i financimeve për njësitë lejuarë për identifikimin e çështjeve dhe kohë të VT dhe VMT		01110 Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi (16)	MB	MSHMS/ON	2024	2025	404,085	0	404,085	404,085	0	404,085	808,170	0	808,170	808,170	0	808,170	0	0	0	-
2.1.2.6	2.1.2.6 Identifikimi i VTM/MT të miratuar në kufi përfaqësimi kalimor dhe përfshirje të kufit nga të rinjtë, vetëm ose të shprehur me të mirë nëpërmjet kontrollit të detyrueshëm të dokumentacionit për të rinjtë		03140 Policia e Shtetit	DKM	DPPSH; PMF	2024	2025	1,294,818	0	1,294,818	1,294,818	0	1,294,818	2,589,636	0	2,589,636	2,589,636	0	2,589,636	0	0	0	-
2.1.2.7	2.1.2.7 Organizimi i vizitueshëm i shërbimeve të informimit për VTM/MT në lidhje me të drejtën për shërbime juridike dhe psikologjike dhe lehtësimi i aksesit në drejtësi, duke i siguruar ndihmë juridike të specializuar dhe falas që në fazë të hershme të procesit		01110 Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi (16)	MB; KKSAT	MDPP AP	2024	2025	995,636	0	995,636	995,636	0	995,636	1,991,272	0	1,991,272	1,991,272	0	1,991,272	0	0	0	-

Page | 14403

2.1.2.8	Nëdërmja e hapave përkatës për garantimin e mbrojtjes së pasqje dhe efektive si dhe shërbimeve e vlefshme të rekrutit për VIT/VMT, dëshmimi dhe evitimi i familjes së tyre, brenda apo jashtë vendit, nga këmbësorët i mundshëm gjatë të gjitha fazave të procedurës penale, duke përfshirë mijen e bashkëpunuesit të personave të trafikuar me institucionet e detyrimit të ligjit dhe duke aplikuar një çapje të orientuar të mbrojtjes e VIT/VMT.	03140 Policia e Shtetit	DPPSH	PP KKSAT	2024	2025	2,505,330	0	2,505,330	2,505,330	0	2,505,330	5,010,660	0	5,010,660	5,010,660	0	5,010,660	0	0	0	-	
2.1.2.9	2.1.2.9 Informimi për shërbimeve të VIT/VMT veçanërisht për fëmijët duke përdorur një grup mjetor, në lidhje me të drejtat që kanë, shërbimet në dispozicion dhe mënyrat e aksesimit të tyre, ndërkohë që ndodhin në mjetorin që përkasin situatën e tyre për shërbime ndalimet, mbulimin nga media, ndërkohë e shërbimeve, ndërkohë e procedurave të.	10430 Përkushtimi Social	MSHMS	NJMF SHSSH KKSAT OJF, ON, PP	2024	2025	1,438,687	0	1,438,687	1,438,687	0	1,438,687	2,877,374	0	2,877,374	2,877,374	0	2,877,374	0	0	0	-	
2.1.2.10	2.1.2.10 Sigurimi i ofrimit të shërbimeve të rekrutimit për VIT/VMT, nëpërmjet financimit të vlefshmeve, në kuadër të Fondit Social të shtetit dhe shërbimeve komunitare, si dhe nëpërmjet monitorimit të vlefshmeve të tyre në respektimin e standardeve të kërkimit.	10430 Përkushtimi social	MSHMS	MKR SHSSH KKSAT ON	2024	2025	469,227	0	469,227	469,227	0	469,227	938,454	0	938,454	938,454	0	938,454	0	0	0	-	
2.1.2.11	2.1.2.11 Zhblotimi PSV-ve, i përkohëve shtetit dhe formave të unifikues për kërkim vlefshëm të sigurtit të VIT/VMT, si dhe orientimi i NJMF-ve për plotësimin e shtetit të formave dhe procedurave të përkohëve PSV-ve.	01110 Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi (16)	MB	AP MEPJ NJMF SHSSH KKSAT OJF ON	2024	2025	863,212	0	863,212	863,212	0	863,212	1,726,424	0	1,726,424	1,726,424	0	1,726,424	0	0	0	-	
2.1.2.12	2.1.2.12 Promovimi i ndërmarrjeve sociale në iniciativë që angazhohen VIT/VMT personat me prejedhje të pavarësive socio-ekonomike.	10430 Përkushtimi Social	MSHMS	KKSAT OJF NJVQV Buzesi pinal	2024	2025	669,139	0	669,139	669,139	0	669,139	1,338,278	0	1,338,278	1,338,278	0	1,338,278	0	0	0	-	
2.1.2.13	2.1.2.13 Monitorimi i shërbimeve VIT/VMT të menaxhuara nga NJMF.	10430 Përkushtimi social	ASHMDF	SHSSH NJVQV OJF	2024	2025	2,301,899	0	2,301,899	2,301,899	0	2,301,899	4,603,798	0	4,603,798	4,603,798	0	4,603,798	0	0	0	-	
Kosto Objektivi specifik 2.1							36,826,164	0	36,826,164	16,829,905	0	16,829,905	53,696,069	0	53,696,069	40,530,325	0	40,530,325	11,775,744	0	0	11,775,744	1,300,000
2.2	Objektivi i specifik 2.2 Rrëgjat e Profesionaliteti																						
	Resur																						
2.2.1	2.2.1 Rrëgjat e kapaciteteve profesionale dhe institucionale për identifikimin e viktimave të mundshme të trafikimit	03320 Shërbime i avokatisë, 1300 Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administratës Publike -ASPA, 01110 Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi (16), 10430 Përkushtimi Social	Avokat i MB, ASPA, DHKA, ASHMDP,	Parlamenti, MKR, Organizata, MEKJAKPA, MAS, ON, KKSAT, GHPSPSH, MSHMS, DPPSH	2024	2026	7,205,390	0	7,205,390	6,336,000	0	6,336,000	13,541,390	0	13,541,390	1,781,390	0	1,781,390	4,752,000	0	0	4,752,000	7,008,000
2.2.1.1	2.2.1.1 Rrëgjat i strukturës së Avokatit të Popullit me qëllim përkohësive e rekrutimit për trafikim si raportues i çështjeve	03320 Shërbime i avokatisë	Avokat i Popullit	Parlamenti	2024	2024	269,390	0	269,390	0	0	0	269,390	0	269,390	269,390	0	269,390	0	0	0	0	-
2.2.1.2	2.2.1.2 Trajtimi i punësimeve/aktiviteteve për identifikimin e tërësive dhe trajtimin e VIT/VMT	01110 Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi (16)	MB	MKR, Organizata	2024	2025	864,000	0	864,000	864,000	0	864,000	1,728,000	0	1,728,000	0	0	0	0	0	0	0	1,728,000
2.2.1.3	2.2.1.3 Trajtimi i profesionaleve të ngarkuar për identifikimin, referencat dhe mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit në procedurë standarde të veprimtari të rikthimit	01110 Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi (16)	MB	AMP, MKR, Organizata	2024	2025	648,000	0	648,000	648,000	0	648,000	1,296,000	0	1,296,000	0	0	0	0	0	0	0	-
2.2.1.4	2.2.1.4 Rrëgjat e kapaciteteve të punësimeve të MEKJ në nivel qendror për VOT (punësim, ofrimin dhe VET) për politikë të hapjes e trafikimit të derivateve njerëzore dhe përkohësive e tyre me politikë e punësimit, VET, dhe të tjerë.	1300 Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administratës publike -ASPA	ASPA,	MEKJON	2025	2025	324,000	0	324,000	324,000	0	324,000	648,000	0	648,000	648,000	0	648,000	0	0	0	0	-

[illegible]

Page | 14405

[illegible]

[illegible]

[illegible]



Qëllimi i politikës 1: ULJA E KËRCËNIMIT DHE NDIKIMIT TË KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KRIMEVE TË RËNDA															
Objektivat specifikë	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Kosto indikative totale			Burimi i mbulimit deri më 2025						Hendeku financiar 2024–2025 (në lekë)	Kosto totale në EUR (kursi këmbimit: 1 EUR = 102 ALL)
	Institucioni përgjegjës	Institucioni kontribues	Afati i fillimit	Afati i mbarimit				PBA 2024–2025 (në lekë)			Financim i huaj/burime të tjera (në lekë)				
					Korrente	Kapitale	Total kosto	Korrente	Kapitale	Total BSH	Korrente	Kapitale	Total FH		
Objektivi specifik 1.1: Goditja e trafiqeve të paligjshme	MB, MFE, MD, Akademia e Policisë Shkolla e Magjistraturës, DPPSH, PSH, AMP	MFE, MSHMS, MAS, MD, ISHPSHSH, PP DPPSH, DPT, KM, Organizata, MB/DPPSH PP KKSAT ON/OJF/PP/ SPAK/MKR	2024	2025	36,876,919	0	36,876,919	20,661,674	0	20,661,674	14,415,245	0	14,415,245	1,800,000	361,538
Kosto totale Qëllimi i politikës I (objektiva specifikë 1.1+1.2+1.3)					36,876,919	-	36,876,919	20,661,674	-	20,661,674	14,415,245	-	14,415,245	1,800,000	361,538
Qëllimi i politikës 2: MBROJTJA E QYTETARËVE, INSTITUCIONEVE DHE EKONOMISË															
Objektivat specifikë	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Kosto indikative totale			Burimi i mbulimit deri më 2025						Hendeku financiar 2024–2025 (në lekë)	Kosto totale në EUR (kursi këmbimit: 1 EUR = 102ALL)
	Institucioni përgjegjës	Institucioni kontribues	Afati i fillimit	Afati i mbarimit				PBA 2024–2025 (në lekë)			Financim i huaj/burime të tjera (në lekë)				
					Korrente	Kapitale	Total kosto	Korrente	Kapitale	Total BSH	Korrente	Kapitale	Total FH		
Objektivi specifik 2.1: Identifikimi dhe mbështetja e individëve në rrezik për t'iu nënshtruar shtrëngimit, dhunës dhe frikësimit nga krimi i organizuar	MFE, AKPA, Avokati I, MB, ASPA, DHKA, ASHMDF,	Parlamenti, MKR, Organizata, MFE/AKPA, MAS, ON, KKSAT, ISHPSHSH, MSHMS, DPPSH, AKPA, AKSHI, MB, DKM	2024	2025	53,656,069	0	53,656,069	40,530,325	0	40,530,325	11,775,744	0	11,775,744	1,350,000	526,040
Objektivi specifik 2.2: Rritja e profesionalizmit	Avokati I, MB, ASPA, DHKA, ASHMDF,	Parlamenti, MKR, Organizata, MFE/AKPA, MAS, ON, KKSAT, ISHPSHSH, MSHMS, DPPSH	2024	2025	13,541,390	0	13,541,390	1,781,390	0	1,781,390	4,752,000	0	4,752,000	7,008,000	132,759
Kosto totale Qëllimi i politikës II (objektiva specifikë 2.1+2.2)					67,197,459	-	67,197,459	42,311,715	-	42,311,715	16,527,744	-	16,527,744	8,358,000	658,799
Qëllimi i Politikës 3. RRRITJA E FORCËS PARANDALUESE NDAJ KËRCËNIMEVE TË KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KRIMEVE TË RËNDA															
	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Kosto indikative totale			Burimi i mbulimit deri më 2025							



Objektivat specifikë	Institucioni përgjegjës	Institucioni kontribues	Afati i fillimit	Afati i mbarimit				PBA 2024–2025 (në lekë)			Financim i huaj/burime të tjera (në lekë)			Hendeku financiar 2024–2025 (në lekë)	Kosto totale në EUR (kursi këmbimit: 1 EUR = 102ALL)
					Korrente	Kapitale	Total kosto	Korrente	Kapitale	Total BSH	Korrente	Kapitale	Total FH		
Objektivi specifik: 3.1: Realizimi i fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit me përfshirjen e institucioneve qendrore dhe vendore, shoqërisë civile, biznesit, medies dhe aktorëve të tjerë për parandalimin e krimit të organizuar	MB, AKPA, DPPSH, MTM, MEPJ, MFE, AMA, MAS	MFE, MKR,AP KRAT AMA, OJF ON, TV kombëtare dhe lokale, donatore, DPPSH, KKSAT, MB, MKR, Shoqata Shqiptare e Turizmit, DPAP, AP	2024	2025	143,253,312	23,000,000	166,253,312	106,725,962	0	106,725,962	11,639,350	0	11,639,350	47,888,000	1,629,934
Objektivi specifik 3.2 Ofrimi dhe koordinimi i mbështetjes së brendshme/ huaj për zona dhe komunitete vulnerabël	DPPSH, MB	MKR, ON, MEPJ,MKR, DPPSH, KKSAT, ASHMDF, NJQV	2024	2025	13,504,776	0	13,504,776	7,480,132	0	7,480,132	6,024,644	0	6,024,644	-	132,400
Kosto totale Qëllimi i politikës III (objektiva specifikë 3.1+3.2)					156,758,088	23,000,000	179,758,088	114,206,094	0	114,206,094	17,663,994	0	17,663,994	47,888,000	1,762,334
Kosto totale (QS1+QS2+QS3)					260,832,466	23,000,000	283,832,466	177,179,483	0	177,179,483	48,606,983	0	48,606,983	58,046,000	2,782,671

Kosto totale të PKV	283,832,466
MTBP 2024- 2026	177,179,483
Financim i huaj /Burime të tjera	48,606,983
Hendek financiar 2024- 2026	58,046,000


Kosto korrente	260,832,466
Kosto kapitale	23,000,000
Total kosto	283,832,466

92%
8%



	Kosto korrente	Kostoja kapitale	Në %
Qëllimi I politikës I	36,876,919	0	13.0%
Qëllimi I politikës II	67,197,459	0	23.7%
Qëllimi i politikës III	156,758,088	23,000,000	63.3%



Nevojat (në lek)				
Qëllimi i politikave	Natyra/ tipologjia e kostove	Kostoja totale 2024–2025	Kostot e planifikuara PBA 2024–2025 Buxheti dhe donator	Hendeku financiar 2024–2025
Qëllimi i politikës 1: ULJA E KËRCËNIMIT DHE NDIKIMIT TË KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KRIMEVE TË RËNDA	Korrente	36,876,919	35,076,919	1,800,000
	Kapitale	0	0	
Qëllimi i politikës 2: MBROJTJA E QYTETARËVE, INSTITUCIONEVE DHE EKONOMISË	Korrente	67,197,459	58,839,459	8,358,000
	Kapitale	0	0	
Qëllimi i politikës 3. RRITJA E FORCËS PARANDALUESE NDAJ KËRCËNIMEVE TË KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KRIMEVE TË RËNDA	Korrente	156,758,088	131,870,088	47,888,000
	Kapitale	23,000,000	0	
TOTALI [Lekë]		283,832,466	225,786,466	58,046,000
TOTALI [Euro] 1 euro 102 Leke		2,580,295	2,052,604	569,078



NATYRA EKONOMIKE E KOSTOVE TË Planit të Veprimit



**UDHËZIM****Nr. 4, datë 24.6.2024****PËR RREGULLAT E PËRCAKTIMIT TË KONSUMIT TË ENERGJISË TERMIKE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 14, të ligjit nr. 124/2015, “Për eficiencën e energjisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:**I. Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Qëllimi kryesor i rregullave të përcaktimit të konsumit të energjisë termike (në vijim “Metodologjia”) është të zbatohet faturimin e bazuar në konsum, nëpërmjet përcaktimit të rregullave të llogaritjes së faturës së energjisë termike për klientët që banojnë në ndërtesat me shumë njësi.

2. Metodologjia zbatohet nga kompanitë e licencuara për furnizim me energji termike dhe do të zbatohet për llogaritjen e faturës së ngrohjes/ftohjes për klientët që banojnë në ndërtesa individuale ose me shumë njësi të lidhura me sistemin qendror të ngrohje-ftohjes.

3. Metodologjia do të zbatohet për të gjitha ndërtesat me shumë njësi (kolektive), nëpërmjet matjes funksionale të ngrohjes/ftohjes në nivel të nënstacionit të ndërtesës dhe në nivel të njësisë.

4. Pavarësisht nga lloji i instalimeve të ngrohjes/ftohjes qendrore të ndërtesave (instalimi i ngrohjes/ftohjes qendrore ‘vertikale’ ose ‘horizontale’) dhe rregullimet përkatëse të matjes së nxehtësisë në nivelin e njësisë (HCA ose matësi individual i ngrohjes së njësisë), metodologjia do të zbatohet për të dyja rastet.

II. Parimet kryesore të metodologjisë

5. Parimet kryesore të mëposhtme do të rregullojnë këtë metodologji:

a) Fatura e energjisë termike të konsumatorit duhet të jetë e drejtë dhe transparente, duke reflektuar konsumin aktual të matur dhe të vlerësuar të ngrohjes-ftohjes së njësisë në pronësi të çdo konsumatori;

b) Faturimi bazohet në konsumin e matur në nivelin e nënstacionit termik dhe duke marrë parasysh matjet në nivel të njësisë dhe rregullimet e tjera specifike që pasqyrojnë nxehtësinë e pa matur në nivelin e njësisë, siç është transmetimi i nxehtësisë

nga rrjeti i përbashkët i tubacioneve të ndërtesave dhe nga transmetimi i nxehtësisë nga muret/tavanet ndërmjet njësisë të ndërtesës. Për këtë qëllim, bilanci i furnizimit/konsumit të energjisë termike të ndërtesës do të jetë baza për alokimin e kostove të ngrohjes/ftohjes dhe llogaritjen e mëtejshme të faturave të konsumatorëve;

c) Matja kryesore e energjisë termike bëhet në nënstacionin termik të ndërtesës, i cili është pika ndarëse (kufizuese) ndërmjet furnizuesit dhe konsumatorit; matja e energjisë termike në nivelin e nënstacionit është matja referente për kompaninë e furnizimit me ngrohje/ftohje që duhet të kompensohet për ngrohjen/ftohjen e furnizuar në një ndërtesë. Për faturimin e bazuar në konsum do të zbatohet e ashtuquajtura ‘tarifa për konsumatorët me matje’ sipas legjislacionit në fuqi; kjo tarifë përbëhet nga komponenti i tarifës së kapacitetit dhe komponenti i energjisë.

6. Fatura e energjisë termike të konsumatorëve që banojnë në ndërtesat kolektive do të përbëhet nga: a) komponentët fiks që marrin parasysh kapacitetin termik të konsumatorit dhe konsumin e përbashkët të energjisë termike të ndërtesës dhe do t’u tarifohen konsumatorëve pavarësisht nga sasia e energjisë së konsumuar; b) komponenti variabël që do të llogaritet në bazë të sasisë së matur të energjisë termike të konsumuar.

7. Metodologjia shfrytëzon qasjen që bazohet në bilancin e konsumit të energjisë termike (ngrohjes/ftohjes) për ndërtesën si tërësi, e cila merr parasysh si në vijim:

a) Ngrohja/ftohja e matur në nivelin e nënstacionit termik është matja kryesore referente e ngrohjes/ftohjes së furnizuar në ndërtesë, për të cilën kompania e furnizimit me energji termike duhet të kompensohet;

b) Diferenca ndërmjet sasisë së energjisë termike të matur në nivelin e nënstacionit të ndërtesës dhe konsumit të përbashkët të të gjitha njësisë të ndërtesës (matur në nivel njësie) do të shpërndahet proporcionalisht me sipërfaqen e ngrohjes/ftohjes së secilës njësi;

c) Sipas kësaj, fatura individuale e energjisë termike e çdo konsumatori — pronari të njësisë duhet të marrë parasysh konsumin e energjisë termike të matur në nivel njësie dhe pjesën përkatëse të konsumit të përbashkët të ndërtesës, e cila përfaqëson diferencën ndërmjet konsumit të energjisë së matur në nivel të nënstacionit dhe



konsumit të përbashkët të energjisë së të gjitha njësive të matura në nivelin e njësisë;

ç) Pjesa e konsumit të përbashkët të ndërtesës ndahet për njësitë e ndërtesës në proporcion me sipërfaqen e ngrohjes/ftohjes të secilës njësi.

III. Bilanci i konsumit të energjisë termike të një ndërtese me shumë njësi

8. Në bazë të fushëveprimit të metodologjisë së parimeve kryesore dhe qasjes për hartimin e metodologjisë, bilanci i konsumit të nxehtësisë së një ndërtese kolektive përgatitet në çdo muaj para përgatitjes së faturave, sipas shtojcës 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9. Bilanci i konsumit të ngrohjes/ftohjes së ndërtesës me shumë njësi duhet të kryhet për shkak të specifikave të dizajnit teknik dhe konfigurimit të instalimeve të ngrohjes/ftohjes qendrore, dhe aranzhimeve përkatëse të matjes së ngrohjes/ftohjes, të përmbledhura si më poshtë:

a) Konsumi i energjisë termike të të gjithë ndërtesës me shumë njësi (kolektive) matet në nivelin e nënstacionit nga matësi i ngrohjes/ftohjes;

b) Në ndërtesat me shumë njësi me instalime të ngrohjes qendrore 'vertikale', konsumi i nxehtësisë së njësive vlerësohet (llogaritet) duke përdorur alokatorët e kostos së ngrohjes të montuar në çdo

radiator që llogarisin nxehtësinë e transmetuar nga radiatorët;

c) Në ndërtesat me shumë njësi me instalime të ngrohjes qendrore 'horizontale' dhe ftohjes qendrore, konsumi i ngrohjes/ftohjes së njësive matet duke përdorur matësin e ngrohjes/ftohjes të instaluar në pikën e lidhjes që hyn në njësi, i cili mat konsumin e ngrohjes/ftohjes në njësi;

ç) Në ndërtesën me shumë njësi, krahas konsumit të ngrohjes/ftohjes së njësive është prezent edhe "konsumimi i përbashkët", në formën e: i. transmetimit të nxehtësisë nga tubat që kalojnë nëpër hapësirat e përbashkëta të ndërtesave (korridoret, shkallët etj.); ii. transmetimit të nxehtësisë nga tubat që kalojnë nëpër njësi (në rastin e përdorimit të HCA-ve të montuara në radiatorë); iii. transmetimit të nxehtësisë ndërmjet mureve dhe tavaneve të njësive ngjitur.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR DHE
MINISTËR

I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

Shtojca I

Bilanci i konsumit të nxehtësisë

1. Bilanci i konsumit të nxehtësisë do të marrë parasysh konsumin e ngrohjes/ ftohjes së matur në nivelin e nënstacionit të ndërtesës, konsumin e ngrohjes/ ftohjes të matur në nivelin e njësive dhe 'konsumin e përbashkët' që nuk matet; për një ndërtesë me shumë njësi formula bazë e bilancit të konsumit të ngrohjes është:

$$BHC_{MS-L} = \sum_{i=1}^n U_i HC_{MU-L} + CHC_{NM} \quad (1)$$

Ku:

$BHC_{MS-L} \Rightarrow$ është konsumi i ngrohjes/ ftohjes i të gjithë ndërtesës i matur në nivelin e nënstacionit të ndërtesës;
 $\sum_{i=1}^n U_i HC_{MU-L} \Rightarrow$ shuma e konsumit të ngrohjes/ ftohjes së njësive të matur në nivelin e njësive;
 $n \Rightarrow$ numri i njësive në ndërtesë; dhe
 $CHC_{NM} \Rightarrow$ 'Konsumi i përbashkët i ngrohjes/ ftohjes' që përfshin nxehtësinë e transmetuar nga tubat dhe transmetimin e nxehtësisë brenda ndërtesës, të cilat nuk maten në mënyrë të veçantë.



2. Konsumi i përgjithshëm i njësive ($\sum_{i=1}^n U_i HC_{MU-L}$) llogaritet ndryshe në rastin kur HCA përdoren për të matur konsumin e ngrohjes së njësisë dhe në rastin kur matësit individualë të ngrohjes përdoren për të matur konsumin e ngrohjes së njësisë; detaje për secilin rast janë dhënë në paragrafët e mëposhtëm (3 dhe 4).
3. Llogaritja e konsumit të përgjithshëm të njësive të ndërtesës ($\sum_{i=1}^n U_i HC_{MU-L}$) kur konsumi i ngrohjes së njësisë matet me Alokatorët e Kostos së Ngrohjes (HCA) përfshin llogaritjen me dy hapa:
 - a) Llogaritja e konsumit të ngrohjes për të gjithë radiatorët e çdo njësie, që paraqet shumën e nxehtësisë së transmetuar nga të gjithë radiatorët e njësisë:

$$UHC_{MU-L(HCA)} = \sum_{i=1}^n HTR_i \quad (2)$$

Ku:

$UHC_{MU-L(HCA)} \Rightarrow$ Konsumi i ngrohjes së njësisë që matet duke përdorur HCA;
 $\sum_{i=1}^n HTR_i \Rightarrow$ Nxehtësia e transmetuar nga të gjithë radiatorët e njësisë të matur nga HCA; dhe
 $n \Rightarrow$ Numri i radiatorëve në njësi

- b) Llogaritja e konsumit të ngrohjes për të gjitha njësitë e ndërtesës, sipas formulës:

$$\sum_{i=1}^n U_i HC_{MU-L(HCA)} = U_1 HC_{MU-L(HCA)} + U_2 HC_{MU-L(HCA)} + \dots + U_n HC_{MU-L(HCA)} \quad (3)$$



Ku:

'n' => është numri i njësive në ndërtesën kolektive.

4. Llogaritja e konsumit të përgjithshëm të njësive të ndërtesës ($\sum UHC_{MU-L}$), kur konsumi i ngrohjes së njësive matet me matës individual të ngrohjes/ ftohjes të njësive (UHM) përfaqëson shumën e konsumit të ngrohjes/ ftohjes së çdo njësie të ndërtesës, sipas formulës:

$$\sum_{i=1}^n U_i HC_{MU-L(UHM)} = U_1 HC_{MU-L(UHM)} + U_2 HC_{MU-L(UHM)} + \dots + U_n HC_{MU-L(UHM)} \quad (4)$$

Ku:

$UHC_{MU-L(UHM)}$ => Konsumi i ngrohjes së njësive i matur me matësit individual të ngrohjes (UHM);

'n' => është numri i njësive në ndërtesën kolektive.

5. 'Konsumimi i përbashkët i nxehtësisë' (CHC), i referohet nxehtësisë së transmetuar nga tubat e instalimit dhe transmetimit të nxehtësisë ndërmjet ndarjeve të ndërtesës (njësi/ hapësira të përbashkëta); CHC është i vetmi element i formulës bazë të bilancit të konsumit të nxehtësisë (1) që nuk matet dhe rrjedh nga formula (1):

$$CHC_{NM} = BHC_{MS-L} - \sum_{i=1}^n U_i HC_{MU-L} \quad (5)$$

6. 'Konsumi i përbashkët i ngrohjes/ ftohjes' i llogaritur me formulën (5) do t'u ndahet (alokohet) konsumatorëve individualë – pronarëve të njësive të ndërtesës – proporcionalisht me sipërfaqen e ngrohjes/ ftohjes të secilës njësi; detajet e alokimit janë paraqitur në seksionin vijues '4'.

4 Shpërndarja e konsumit të përbashkët të nxehtësisë së ndërtesës

- 5.1 'Konsumimi i përbashkët i ngrohjes/ ftohjes' i një ndërtese me shumë njësi (kolektive) i'u alokohet njësive të ndërtesës në përpjesëtim me sipërfaqen e ngrohjes/ ftohjes të secilës njësi, duke përdorur koeficientin e shpërndarjes së sipërfaqes të llogaritur për çdo njësi sipas formulës:

$$k_{UAA} = \frac{UA}{\sum_{i=1}^{24} U_i A} \quad (6)$$

Ku:

k_{UAA} => Koeficienti i shpërndarjes së sipërfaqes së njësive;

UA => Sipërfaqja e njësive të ndërtesës kolektive (në m²);

$\sum_{i=1}^n U_i A$ => Sipërfaqja totale e të gjitha njësive të ndërtesës, si shuma e sipërfaqeve të të gjitha njësive të një ndërtese (m²);

'n' numri i njësive në ndërtesat kolektive.



5.2 Pjesa e konsumit të përbashkët të ndërtesës që i alokohet një njësie të ndërtesës përfaqëson alokimin e 'konsumit të përbashkët të ngrohjes/ ftohjes' të ndërtesës në një njësi të caktuar dhe llogaritet duke përdorur koeficientin e shpërndarjes së sipërfaqes së njësisë, sipas formulës më poshtë:

$$US_{CHC} = k_{UAA} * CHC_{NM} \quad (7)$$

Ku:

$US_{CHC} \Rightarrow$ Pjesa e konsumit të përbashkët të nxehtësisë për një njësi (në kWh)
- pjesa e 'konsumit të përbashkët të nxehtësisë' të ndërtesës me shumë njësi që i ndahet një njësie të caktuar të ndërtesës;
 $k_{UAA} \Rightarrow$ Koeficienti i alokimit të sipërfaqes së njësisë;
 $CHC_{NM} \Rightarrow$ 'Konsumi i përbashkët i ngrohjes/ ftohjes' i ndërtesës me shumë njësi (në kWh) - që llogaritet sipas formulës (5)

5 Llogaritja e faturës së ngrohjes së konsumatorit individual

5.1 Në bazë të tarifës për "konsumatorët me matje" të miratuar dhe parimeve kryesore të kësaj Metodologjie, fatura e ngrohjes/ftohjes së konsumatorit individual – pronarit të njësisë – në ndërtesën me shumë njësi do të përbëhet nga komponentët e mëposhtëm:

- Komponenti i kapacitetit termik – që është tarifa për kapacitetin termik të një njësie në pronësi të konsumatorit individual të ngrohjes/ ftohjes; komponenti i kapacitetit termik do të konsiderohet si ngarkesë fikse e pavarur nga konsumi i ngrohjes së një njësie të tillë.
- Komponenti i alokimit të ngrohjes – që është ngarkesa (pagesa) për pjesën e 'Konsumit të përbashkët të nxehtësisë' të ndërtesës që i ndahet një njësie; komponenti i alokimit të ngrohjes/ ftohjes do të konsiderohet si tarifë fikse e pavarur nga konsumi i nxehtësisë së një njësie të tillë.
- Komponenti i konsumit të ngrohjes/ ftohjes - kjo është ngarkesa (pagesa) për sasinë e konsumuar të ngrohjes/ ftohjes matur në nivelin e njësisë (me anë të HCA ose matësit individual të ngrohjes së njësisë).

5.2 Ngarkesa për komponentin e kapacitetit termik përfaqëson ngarkesën (pagesën) fikse për konsumator individual, pavarësisht nga konsumi i matur i ngrohjes/ ftohjes për njësinë e konsumatorit; llogaritet duke shumëzuar kapacitetin termik të njësisë dhe tarifën e kapacitetit termik, sipas formulës:

$$TCC = HCU * HCT \quad (8)$$

Ku:

$TCC \Rightarrow$ Tarifa e kapacitetit termik (në Lek);
 $HCU \Rightarrow$ Kapaciteti termik i njësisë (në kW) – HCU përcaktohet nga furnizuesi i ngrohjes bazuar në metodologjinë e propozuar nga furnizuesi i energjisë termike në marrëveshje me institucionin përgjegjës për licensimin e furnizuesve të energjisë termike;
 $HCT \Rightarrow$ Tarifa e kapacitetit termike (në Lek/kW në muaj) – komponenti fiks i tarifës për konsumatorët 'me matje' e miratuar.



5.3 Ngarkesa (pagesa) për pjesën e 'konsumit të përbashkët të ngrohjes/ ftohjes' të njësisë, që përfaqëson pjesën e konsumit të përbashkët të ndërtesës kolektive të alokuar për një njësi të caktuar, konsiderohet si ngarkesë (pagesë) fikse për konsumatorin individual, pavarësisht nga konsumi i matur i ngrohjes/ ftohjes së njësisë së konsumatorit; llogaritet duke shumëzuar pjesën e 'konsumit të përbashkët të ngrohjes/ ftohjes' të njësisë me tarifën e konsumit të energjisë termike, sipas formulës:

$$CUS_{CHC} = US_{CHC} * TET \quad (9)$$

Ku:

$CUS_{CHC} \Rightarrow$ Ngarkesa (pagesa) për pjesën e 'konsumit të përbashkët të ngrohjes/ ftohjes' të njësisë në (në Lek);
 $US_{CHC} \Rightarrow$ Pjesa e 'konsumit të përbashkët të ngrohjes/ ftohjes' së njësisë (në kWh), e llogaritur sipas formulës (7);
 $TET \Rightarrow$ Tarifa e konsumit të energjisë termike (në Lek/kWh) – komponenti variabël i tarifës për konsumatorët 'në matje' e miratuar.

5.4 Ngarkesa (pagesa) për konsumin e ngrohjes (HCC) e matur në nivel të njësisë, përfaqëson ngarkesën variabël për konsumatorin individual për konsumin e ngrohjes së matur në nivelin e njësisë; llogaritet me formulën:

$$HCC = UHC_{MU-L} * TET \quad (10)$$

Ku:

$HCC \Rightarrow$ Ngarkesa (pagesa) për konsumin e ngrohjes (në Lek);
 $UHC_{MU-L} \Rightarrow$ është konsumi i ngrohjes i njësisë (në kWh) që matet në nivelin e njësisë;
 $TET \Rightarrow$ Tarifa e konsumit të energjisë termike (ngrohjes) (në Lek/kWh) – komponenti variabël i tarifës për konsumatorët 'me matje' e miratuar.

5.5 Shuma totale e faturës së ngrohjes së klientit individual është shuma e tre komponentëve të faturës siç llogaritet sipas paragrafëve 5.2 – 5.4

Shembull i llogaritjes së faturës së ngrohjes për njësi në një ndërtesë me shumë njësi

Për të lehtësuar zbatimin e Metodologjisë është dhënë shembulli i llogaritjes së faturës së ngrohjes për konsumator individual – pronar të njësisë. Para kryerjes së llogaritjes, vizualizohet një mostër e ndërtesës tipike me shumë njësi (kolektive) dhe njësia mostër, e pasuar nga parashikimi i inputeve përkatëse që përfshijnë: numrin dhe llojet e njësive me hapësirat përkatëse të ngrohjes, konsumin e ngrohjes së të gjithë ndërtesës (e matur në nivel të nënstacionit) dhe konsumin e njësive (e matur në nivel të njësisë). Më tej, shembulli detajon llogaritjen e secilit komponent të faturës sipas formulave të Metodologjisë.

1. Shembull i ndërtesës kolektive dhe njësive të mostrës

1.1 Struktura e strukturës së ndërtesës mostër



- Një ndërtesë 6 katëshe ë përbërë nga 24 njësi;
- 4 njësi shërbimi ndodhen në katin përdhësë;
- 5 katet e tjera kanë 20 apartamente, çdo kat nga 4 apartamente.

1.2 Inputet – Sipërfaqet e njësive

- Sipërfaqet e njësi shërbimi (CP):

CP1:	150 m ²
CP2:	120 m ²
CP3:	80 m ²
CP4:	60 m ²

Gjithsej: 410 m²

Sipërfaqet e apartamenteve (AP) - kati tipik

AP1:	150 m ²
AP2:	120 m ²
AP3:	80 m ²
AP4:	60 m ²

Gjithsej: 340 m² * 5 = 1700 m²

Sipërfaqja totale e të gjitha 24 njësive: 410 m² + 1700 m² = 2110 m²

1.3 Inputet – Konsumi mujor i ngrohjes (energjisë termike)

- Konsumi i ngrohjes i CP-ve:

CP1:	2500 kWh
CP2:	2050 kWh
CP3:	1350 kWh
CP4:	1050 kWh

Gjithsej: 6950 kWh

- Konsumi i ngrohjes i AP-ve – kati tipik:

AP1:	1400 kWh
AP2:	1250 kWh
AP3:	1100 kWh
AP4:	950 kWh

Gjithsej: 5*4700 kW=23500 kWh

Konsumi total i ngrohjes i të gjitha njësive: 6,950 kWh + 23,500 kWh = 30,450 kWh

Konsumi total i ngrohjes së ndërtesës: 37,200 kWh

2. Bilanci i nxehtësisë së ndërtesës me shumë njësi - Llogaritja e konsumit të përbashkët të ngrohjes së ndërtesës

2.1 Përdoret formula e bilancit të konsumit të ngrohjes së ndërtesës:

$$BHC_{MS-L} = \sum_{i=1}^{24} U_i HC_{MU-L} + CHC_{NM} \quad (1)$$

2.2 Konsumi mujor i ngrohjes i të gjithë ndërtesës kolektive (nga leximi i njehsorit të nënstacionit të ndërtesës):



$$BHC_{MS-L} = 37,200 \text{ kWh}$$

2.3 Konsumi mujor i nxehtësisë i të gjitha njësive (nga matjet në nivel të njësisë):

$$\sum_{i=1}^{24} U_i HC_{MU-L} = 30,450 \text{ kWh}$$

Shënim për 2.3:

Për arsye thjeshtësie, për shembull, llogaritja, konsumi i tërësishëm i njësive është parashikuar pavarësisht nga lloji i pajisjes matëse në nivel të njësisë - HCA ose UHM; përndryshe llogaritja ndryshon paksa sipas llojit të pajisjes matëse të përdorur në nivel të njësisë:

- Kur përdoret HCA:

Hapi i parë: Llogaritja e konsumit të ngrohjes për të gjithë radiatorët e çdo njësie llogaritet duke përmblodhur nxehtësinë e transmetuar nga të gjithë radiatorët e njësisë, sipas formulës (2) të Metodologjisë:

$$UHC_{MU-L(HCA)} = \sum_{i=1}^r HTR_i \quad (2)$$

Hapi i dytë: Konsumi i ngrohjes i të gjitha njësive të ndërtesës llogaritet si shuma e konsumit të ngrohjes së secilës njësi, sipas formulës (3):

$$\sum_{i=1}^{24} U_i HC_{MU-L(HCA)} = U_1 HC_{MU-L(HCA)} + U_2 HC_{MU-L(HCA)} + \dots + U_{24} HC_{MU-L(HCA)} \quad (3)$$

- Kur përdoret UHM individuale:

Hapi i parë: Leximet e njehsorit të konsumit të ngrohjes së njësisë ($UHC_{MU-L(UHM)}$) nga UHM-të e çdo apartamenti

Hapi i dytë: Llogaritja e konsumit të ngrohjes së tërësishëm të të gjitha njësive duke përmblodhur konsumin e matur të ngrohjes për çdo njësi, sipas formulës (4):

$$\sum_{i=1}^{24} U_i HC_{MU-L(UHM)} = U_1 HC_{MU-L(UHM)} + U_2 HC_{MU-L(UHM)} + \dots + U_{24} HC_{MU-L(UHM)} \quad (4)$$

2.4 Konsumi mujor i ngrohjes i hapësirave të përbashkëta të ndërtesës ('Konsumimi i përbashkët i ngrohjes' - (CHC_{NM}), nuk matet por rrjedh nga formula (1):

$$CHC_{NM} = BHC_{MS-L} - \sum_{i=1}^{24} U_i HC_{MU-L} \quad (5)$$



$$CHC_{NM} = 37,200 \text{ kWh} - 30,450 \text{ kWh} = 6,750 \text{ kWh}$$

3. Alokimi i konsumit të përbashkët të ngrohjes së ndërtesës në njësinë e mostrës

Konsumi i përbashkët i nxehtësisë i një ndërtese kolektive u shpërndahet njësive të ndërtesës në përpjesëtim me sipërfaqen e ngrohur të secilës njësi.

3.1 Njësia e mostrës 'U3' (Apartament - 'AP3') - inputet për seksionin '3' të shembullit:

Sipërfaqja U_3 :	$U_3A = 80 \text{ m}^2$
Sipërfaqja totale e të gjitha 24 njësive:	$\sum_{i=1}^{24} U_iA = 2110 \text{ m}^2$
Konsumi i përbashkët mujor i ngrohjes së ndërtesës (siç llogaritet nën 2.4):	$CHC_{NM} = 6750 \text{ kWh}$

3.2 Së pari, koeficienti i alokimit të sipërfaqes llogaritet për njësi të caktuar sipas formulës (6):

$$k_{UAA} = \frac{UA}{\sum_{i=1}^{24} U_iA} \quad (6)$$

$$k_{UAA} = \frac{80 \text{ m}^2}{2,110 \text{ m}^2} = 0.038$$

3.3 Pjesa e njësisë e 'konsumit të përbashkët të ngrohjes' të ndërtesës i ndahet njësisë U_3 , sipas formulës (7):

$$US_{CHC} = k_{UAA} * CHC_{NM} \quad (7)$$

$$US_{CHC} = 0.038 * 6,750 = 255.924 \text{ kWh} \cong 256 \text{ kWh}$$

4. Llogaritja e faturës mujore të ngrohjes për konsumatorin – pronarin e njësisë 'U3'

4.1 Njësia e mostrës 'U3' - inputet për seksionin '4' të shembullit

- Kapaciteti i nxehtësisë (termik) i njësisë U_3 :	$HCU_3 = 7.5 \text{ kWh}$
- Konsumi mujorë i ngrohjes (energjisë termike) i njësisë U_3 :	$U_3HC = 1,100 \text{ kWh}$
Tarifa e kapacitetit të nxehtësisë (termike).	$HCT = 78 \text{ Lek/kWh në muaj}$
Tarifa e konsumit të energjisë termike (nxehtësisë).	$TET = 3800 \frac{\text{Lek}}{\text{MWh}} = 3.8 \text{ Lek/kWh}$

/Tarifat e mësipërme të përcaktuara nga institucioni përgjegjës për miratimin e tyre, për Centralin e ngrohjes/ftohjes qendrore Termokorça për sezonin e ngrohjes 2028-2029



4.2 Ngarkesa (pagesa) për kapacitetin termik (TCC) llogaritet sipas formulës (8):

$$TCC = HCU * HCT \quad (8)$$

$$TCC = HCU * HCT = 7.5 \text{ kW} * 78 \frac{\text{Lek}}{\text{kW}} = 585 \text{ Lek në muaj}$$

Vlera 585 Lek në muaj - Komponent fiks që është nuk varet nga konsumi i ngrohjes së njësisë i matur në nivelin e njësisë

4.3 Ngarkesa (pagesa) për pjesën e njësisë në 'konsumin e përbashkët të ngrohjes' (CUSCHC) llogaritet sipas formulës (9):

$$CUS_{CHC} = U_3 S_{CHC} * TET \quad (9)$$

$$CUS_{CHC} = 256 \text{ kWh} * 3.8 \text{ Lek/kWh} = 972.8 \text{ Lek}$$

Vlera 972.8 Lek - Komponent fiks që është i pa varur nga konsumi i ngrohjes së njësisë i matur në nivelin e njësisë

4.4 Ngarkesa (pagesa) për konsumin e ngrohjes (energjisë termike) (HCC) e matur në nivelin e njësisë llogaritet sipas formulës (10):

$$HCC = UHC_{MU-L} * TET \quad (10)$$

$$HCC = 1,100 \text{ kWh} * 3.8 \text{ Lek/kWh} = 4180 \text{ Lek}$$

Vlera 4180 Lek - Komponent variabël që pasqyron konsumin e matur në nivel të njësisë.

4.5 Fatura totale mujore e ngrohjes për njësinë U_3 (pa TVSH) do të jetë:

$$Fat. totale = 585 + 972.8 + 4180 = 5737.8 \text{ Lek}$$



UDHËZIM

Nr. 113, datë 9.7.2024

**PËR PROCEDURAT E HARTIMIT TË
LISTAVE TË ZGJEDHËSVE PËR
ZGJEDHJET PËR KRYETAR TË
BASHKISË HIMARË, QARKU VLORË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 45, 46, 47, 48, 50, 51, 56, 57, 59 dhe 62 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të dekretit nr. 224, datë 5.7.2024, të Presidentit të Republikës “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për kryetar të Bashkisë Himarë, qarku Vlorë”,

UDHËZOJ:

1. Gjenerimin e listës së zgjedhësve për Bashkinë Himarë, qarku Vlorë, në përbërje të së cilës, do të jenë të gjithë shtetasit me të drejtë vote, të lindur që nga data 4.8.2006, të cilët deri në datën e zhvillimit të zgjedhjeve për kryetar të Bashkisë Himarë, qarku Vlorë, më 4.8.2024, do të kenë mbushur moshën 18 vjeç, brenda datës 10.7.2024, nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile (RKGJC).

2. Miratimin dhe shpalljen e listës së zgjedhësve, nga kryetari Bashkisë Himarë i komanduar në detyrë, në përputhje me nenin 48 të Kodit Zgjedhor, brenda 48 orëve nga përfundimi i përditësimit.

3. Gjenerimin e listës së zgjedhësve në përputhje me procedurën e parashikuar në udhëzimin nr. 225, datë 11.5.2016, të ministrit të Punëve të Brendshme, “Për procedurat e pezullimit nga lista e zgjedhësve për shtetasit që vuajnë dënimin, parashikuar nga ligji nr. 138/2015, ‘Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike’”.

4. Caktimi i zgjedhësve në listën e qendrës së votimit përkatëse, sipas kodit të vendbanimit, dhe renditja e zgjedhësve brenda qendrës së votimit sipas rendit alfabetik të mbiemrit.

5. Grupimin e listës së zgjedhësve sipas zonave të qendrave të votimit, kufijtë e të cilave janë ato të zgjedhjeve të fundit. Kryetari i Bashkisë Himarë i komanduar në detyrë, i cili ka marrë njoftimin nga nëpunësi i zyrës së gjendjes civile në Bashkinë Himarë/njësitë administrative nën juridiksionin e saj Lukovë dhe Horë-Vranisht, nëse ka qendra votimi

me më pak se 300 (treqind) zgjedhës, apo qendra votimi me më shumë se 1000 (një mijë) zgjedhës, brenda 48 orëve vendos për bashkimin dhe/ose ndarjen e qendrave të votimit, sipas kërkesave të kriterit numerik dhe cakton adresën e qendrës së votimit.

6. Limiti i poshtëm për qendrën e votimit i referohet një numri prej 15 (pesëmbëdhjetë) zgjedhësish, në rastin e institucioneve të posaçme (burgjeve, vendeve të paraburgimit, si dhe spitaleve ose institucioneve të tjera shëndetësore, që pranojnë pacientë për më shumë se 3 ditë), të cilat përbëjnë zonë të veçantë qendre votimi.

7. Kryetari i Bashkisë Himarë, qarku Vlorë, i emëruar në detyrë vendos për rindarjen e qendrave të votimit me fraksion që kalojnë limitin numerik të përcaktuar në Kodin Zgjedhor, duke u nisur nga numri i përgjithshëm i zgjedhësve të qendrës së votimit bazë. Numri i përgjithshëm i një qendre votimi, me gjithë fraksionet e saj ndahet në pjesë të barabarta, me jo më shumë se 1000 (një mijë) zgjedhës secila.

8. Kryetari i Bashkisë Himarë, i komanduar në detyrë, vendos për bashkimin e qendrave të votimit me më pak se 300 (treqind) zgjedhës, me një qendër më të afërt dhe me mundësi komunikimi rrugor. Numri i përgjithshëm i zgjedhësve në qendrat e bashkuara të votimit duhet të jetë mbi 300 (treqind) zgjedhës.

9. Kryetari i Bashkisë Himarë, qarku Vlorë i komanduar në detyrë, vendos ndarjen me fraksion të qendrës së votimit të krijuar, në rastet kur numri i përgjithshëm i zgjedhësve për qendrat që bashkohen rezulton të jetë më shumë se 1000 (një mijë), sipas pikës 7 të këtij udhëzimi. Në rastet kur dy ose më shumë qendra votimi kanë më pak se 300 (treqind) zgjedhës, qendra/qendrat me numër më të vogël i bashkohen atyre me numër më të madh zgjedhësish.

10. Kryetari i Bashkisë Himarë, qarku Vlorë, i komanduar në detyrë u dërgon menjëherë për zbatim zyrës së gjendjes civile në Bashkinë Himarë, qarku Vlorë/zyrave të gjendjes civile nën juridiksionin e saj Lukovë dhe Horë-Vranisht, vendimet për ndarjen ose bashkimin e qendrave të votimit, si dhe vendimet për ndryshimin e adresave të qendrave të votimit nëse ka. Këto vendime i dërgon, gjithashtu, në Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile në Ministrinë e Brendshme, si dhe për dijeni prefektit të qarkut Vlorë.



11. Përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile në Bashkinë Himarë/njësitë administrative nën juridiksionin e saj Lukovë dhe Horë-Vranisht, kryen veprimet përkatëse në Regjistrin Kombëtar, brenda 24 orëve nga marrja e vendimit të kryetarit të komanduar në Bashkinë Himarë, qarku Vlorë, për ndarjen e qendrave të votimit referuar kriterëve të parashikuar ligjorë.

12. Nëpunësit e zyrave të gjendjes civile në Bashkinë Himarë/njësitë administrative nën juridiksionin e saj Lukovë dhe Horë-Vranisht, përditësojnë informacionin për ndarjen e qendrave të votimit në Regjistrin Kombëtar deri në orën 24:00 të së njëjtës ditë. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ekzekuton automatikisht vendimet e kryetarit për ndarjen e qendrës së votimit sipas kriterit numerik dhe mbiemrit të zgjedhësit, në rastet kur përditësimet për ndarjen e qendrave të votimit nuk kryhen nga nëpunësit e zyrave të gjendjes civile. Qendrat e votimit me fraksion marrin automatikisht vendndodhjen e qendrës bazë.

13. Nëpunësit e zyrave të gjendjes civile në Bashkinë Himarë/njësitë administrative nën juridiksionin e saj Lukovë dhe Horë-Vranisht, kryejnë veprimet përkatëse në rubrikën e dedikuar në Regjistrin Kombëtar për përditësimin e përshkrimit të vendndodhjes së qendrës së votimit me fraksion, në rastet kur kryetari i komanduar në Bashkinë Himarë vendos që vendndodhja e qendrës së votimit me fraksion të jetë e ndryshme nga ajo e qendrës bazë.

14. Procedurat e parashikuara në pikat 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12 dhe 13 të këtij udhëzimi, kryhen për listën e zgjedhësve, datë 10.7.2024, që do të publikohet për zgjedhjet për kryetar të Bashkisë Himarë.

15. Në rastet kur kryetari i komanduar në detyrë në Bashkinë Himarë, nuk përmbush detyrimet e parashikuara sipas pikave 5, 6, 7, 8 dhe 9 të këtij udhëzimi, deri në publikimin e listës së zgjedhësve, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, kryen menjëherë procesin e ndarjes dhe/ose bashkimit e qendrave të votimit, sipas kriterëve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, të cilat reflektohen në listën e zgjedhësve, 10.7.2024 për kryetar të Bashkisë Himarë.

16. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile realizon bashkimin/ndarjen e qendrave të votimit në përmbushje të këtij procesi, bazuar në kriterin numerik dhe mbiemrin e zgjedhësit. Qendrat e

votimit me fraksion marrin automatikisht adresën e qendrës bazë.

17. Nëpunësit e zyrave të gjendjes civile në Bashkinë Himarë/njësitë administrative nën juridiksionin e saj kryejnë veprimet përkatëse në Regjistrin Kombëtar për përditësimin e vendndodhjes së qendrës së votimit, në rastet kur kryetari i komanduar në detyrë në Bashkinë Himarë ka vendosur që vendndodhja e qendrës së votimit me fraksion, të jetë e ndryshme nga ajo e qendrës bazë.

18. Nëpunësit e zyrave të gjendjes civile në Bashkinë Himarë/njësitë administrative nën juridiksionin e saj Lukovë dhe Horë-Vranisht, më datë 10.7.2024, printojnë listën e zgjedhësve nga Regjistri Kombëtar. Nëpunësit nënshkruajnë, vulosin listën e zgjedhësve për çdo qendër votimi, përfshirë këtu edhe institucionet e posaçme. Nëpunësit i dorëzojnë kryetarit të Bashkisë Himarë të komanduar në detyrë listën e zgjedhësve të nënshkruar dhe të vulosur.

19. Kryetari i komanduar në detyrë dërgon në KZAZ, të 3 (tri) formatet e parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 2, të nenit 48, të Kodit Zgjedhor, jo më vonë se 35 ditë nga data e zhvillimit të zgjedhjeve për kryetar të Bashkisë Himarë.

20. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dërgon në KZAZ të 3 (tria) formatet e listës së zgjedhësve, në rast se nga kryetari i komanduar për Bashkinë Himarë nuk përmbushen kompetencat sipas pikës 19 të këtij udhëzimi.

21. Zyrat e gjendjes civile në Bashkinë Himarë/njësitë administrative nën juridiksionin e saj Lukovë dhe Horë-Vranisht, ku do të zhvillohen zgjedhjet për kryetar të Bashkisë Himarë, zbatojnë dhe vendimet gjyqësore, sipas nenit 57 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

22. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile publikon listën e zgjedhësve në formë elektronike për zgjedhjet për kryetar të Bashkisë Himarë, në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Brendshme.

23. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile i dërgon për ruajtje Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave një kopje të printuar të listës së zgjedhësve, jo më vonë se 10 ditë pas shpalljes së listës së zgjedhësve për kryetar të Bashkisë Himarë.



24. Ngarkohen me zbatimin e këtij udhëzimi kryetari i Bashkisë Himarë, i komanduar në detyrë, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, zyrat e gjendjes civile në Bashkinë Himarë dhe në Njësitë Administrative nën juridiksionin e saj Lukovë dhe Horë-Vranisht, si dhe institucionet e tjera shtetërore të parashikuara nga Kodi Zgjedhor.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Taulant Balla

UDHËZIM
Nr. 114, datë 9.7.2024

**PËR PROCEDURËN E LËSHIMIT, E
REFUZIMIT TË LËSHIMIT, E
RIPËRTËRITJES APO E ANULIMIT TË
LEJES SË QËNDRIMIT DHE LEJES
UNIKE PËR TË HUAJIN**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 34, të pikës 4, të nenit 72, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”,

UDHËZOJ:

I. VERIFIKIMI I TË DHËNAVE, REGJISTRIMI NË SISTEM, LËSHIMI I LEJES PROVIZORE TË QËNDRIMIT DHE ARKIVIMI I DOSJES

1. Struktura e migracionit pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin, pas dorëzimit të dokumentacionit fizik nga i huaji, kryen verifikimin dhe plotësimin e mangësive të konstatuara në aplikim, dhe regjistron në sistemin FER, “Moduli e-lege qëndrimi”. Nëse gjatë regjistrimit evidenton mospërputhje të dhënash (emër, mbiemër, atësi, datëlindje, vendlindje, shtetësi, gjini etj.) ndërmjet të dhënave të deklaruara në portal, dokumentit identifikues dhe atyre ekzistuese në sistemin TIMS, apo më shumë se një rekord për të njëjtin person, merr masa për korrigjimin e këtyre të dhënave në FER-TIMS.

2. Pas regjistrimit të aplikimit në sistemin FER-TIMS, gjenerohen akti i arkivimit të dosjes së aplikimit të të huajt dhe leja provizore e qëndrimit me vulë elektronike i përcillet të huajt në format

elektronik, në adresën e emailit të dhënë nga aplikuesi.

II. DHËNIA E AUTORIZIMIT PËR LËSHIM TË LEJES SË QËNDRIMIT /LEJES UNIKE OSE REFUZIMIN E SAJ

1. Miratimi ose refuzimi i aplikimit për leje qëndrimi ose leje unike dhe dhënia e autorizimit për lëshimin apo refuzimin e tyre, bëhet nga struktura përgjegjëse pranë autoritetit qendror për kufirin dhe migracionin, mbi bazën e vlerësimeve të bëra nga të gjitha strukturat që marrin pjesë në vlerësimin e aplikimit, në formën e një akti të miratuar dhe nëpërmjet shënimit në modulin e-lege qëndrimi.

2. Struktura përgjegjëse pranë autoritetit për kufirin dhe migracionin, sipas aktit të miratuar, autorizon për çdo aplikim autoritetin vendor të kufirit dhe migracionit përkatës për të vijuar me lëshimin ose refuzimin e lejes së qëndrimit/lejes unike.

III. LËSHIMI I LEJES SË QËNDRIMIT OSE LEJES UNIKE

1. Pas marrjes së autorizimit për lëshimin e lejes së qëndrimit/lejes unike, struktura përgjegjëse pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin, bën shënimin në rubrikën përkatëse për çdo aplikim të regjistruar në modulin e-lege qëndrimi dhe i përcjell të huajt në adresën e email-it të deklaruar në aplikim, njoftimin për miratimin e lejes së qëndrimit/lejes unike, sipas modelit të përcaktuar në aneksin nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi, ku e informon, për:

a) miratimin e lejes së qëndrimit/lejes unike dhe pajisjen me nr. personal FID;

b) detyrimin për regjistrim pranë zyrës së gjendjes civile për regjistrimin e adresës së banimit;

c) kryerjen e pagesës së vlerës së kartës biometrike, nëpërmjet mandatit të arkëtimit.

2. Procedura e aplikimit për dokument biometrik leje qëndrimi/leje unike për të huajt, bëhet në zyrën e migracionit, pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin, nga vetë i huaji, ku dhe tërhiqet ky dokument pas prodhimit dhe aktivizimit të CHIP-it të trupëzuar në të.

3. Në momentin kur i huaji pajiset me dokumentin leje qëndrimi/leje unike, ai dorëzon pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin lejen provizore ose lejen e qëndrimit/lejen unike ekzistuese (në rast të kërkesës për ripërtëritjen e saj), e cila më pas ruhet në dosjen e të huajt.

4. Të huajt që janë pjesë e kategorive të përcaktuara në nenet 52, 53 dhe shkronjës “dh”, të



pikës 1, nenit 87, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, pajisen me leje qëndrimi sipas pjesës A, pika 8, shkronja “c”, të kreut III, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 858, datë 29.12.2021, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, e cila gjenerohet nga moduli e-lege qëndrimi dhe i dorëzohet të huajt fizikisht.

5. Miratimi dhe lëshimi i lejes së qëndrimit/lejes unike, nga autoriteti për kufirin dhe migracionin u njoftohet automatikisht Sistemit e-Visa (VISA) dhe Sistemit të Shërbimeve të Punësimit (SSHP).

IV. ANULIMI/REFUZIMI I LËSHIMIT APO RIPËRTËRITJES TË LEJES SË QËNDRIMIT OSE LEJES UNIKE

1. Për rastet e refuzimit të lëshimit apo ripërtëritjes së lejes së qëndrimit/lejes unike, të parashikuara në nenin 34, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, kur konstatimi bëhet në fazën e aplikimit, strukturat përgjegjëse të autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin marrin masa për njoftimin e të huajt mbi refuzimin, si dhe vazhdimin e procedurave ligjore sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 89 dhe nenit 99, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”.

2. Për rastet kur konstatimi bëhet në fazën e vlerësimit të aplikimit për leje qëndrimi/leje unike, autoriteti qendror për kufirin dhe migracionin merr vendimin përfundimtar për refuzimin e lëshimit ose ripërtëritjes së lejes së qëndrimit/lejes unike dhe njofton autoritetin vendor me shkresë zyrtare dhe nëpërmjet shënimit në modulin e-lege qëndrimi mbi këtë refuzim, për të vijuar me procedurat ligjore, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 89 dhe nenit 99, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”.

3. Në rast se autoritetet e përfshira në bashkëpunim për procedurën e lëshimit të lejes së qëndrimit/lejes unike, konstatojnë një nga rastet për të cilat bëhet anulimi i lejes së qëndrimit/lejes unike, i kërkojnë autoritetit qendror për kufirin dhe migracionin, anulimin e autorizimit, për të cilën më parë mund të kenë dhënë aprovimin.

4. Kur autoriteti qendror për kufirin dhe migracionin merr vendim për anulimin dhe bërjen të pavlefshme të lejes së qëndrimit/lejes unike të lëshuar, ky vendim i përcillet për zbatim autoritetit shtetëror përgjegjës në nivel vendor me shkresë zyrtare, duke u pasqyruar i plotë në Regjistrin Kombëtar Elektronik për të Huajt – FER.

5. Autoriteti përgjegjës në nivel vendor njofton të huajt për refuzimin/anulimin, si dhe për arsyen e këtij vendimi, sipas formatit të refuzimit/anulimit të modelit në aneksin nr. 2 të këtij udhëzimi. Refuzimi/anulimi i lejes së qëndrimit/lejes unike shënohet në Regjistrin Kombëtar Elektronik për të Huajt – FER, së bashku me arsyetimin përkatës.

6. Për të huajt që me marrëveshje qeveritare është parashikuar një format standard i refuzimit për qëndrim në territorin e Republikës së Shqipërisë, zbatohet formati i parashikuar në këtë marrëveshje.

7. Pas refuzimit të aplikimit ose anulimit të lejes së qëndrimit/lejes unike, referuar parashikimeve të neneve 34, 45, pikat 1, 2 dhe 3 të nenit 72, neni 89 dhe 94, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, kur i huaji ndodhet në territor autoriteti vendor për kufirin dhe migracionin merr masa për largimin e të huajt nga territori i Republikës së Shqipërisë, sipas përcaktimeve të nenit 99, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, përjashtuar rastet e parashikuara në nenin 107.

8. Në rastet kur i huaji nuk ndodhet në Republikën e Shqipërisë, autoriteti qendror për kufirin dhe migracionin njofton të gjitha pikat e kalimit kufitar (PKK) nëpërmjet sistemit TIMS, mbi anulimin ose refuzimin e lejes së qëndrimit/lejes unike, ndërsa autoriteti vendor për kufirin dhe migracionin bën njoftimin në adresën e tij të punës apo të qëndrimit të deklaruar, sipas kërkesave të Kodit të Procedurës Administrative. I huaji njoftohet në PKK nga shërbimet e Policisë së Kufirit dhe Migracionit, në momentin e parë të paraqitjes së tij në hyrje në Republikën e Shqipërisë për refuzimin ose anulimin e lejes së qëndrimit/lejes unike dhe në të njëjtën kohë dhe për refuzimin e hyrjes për rastet e parashikuara në ligj.

9. Refuzimi i aplikimeve për leje qëndrimi/leje unike, si dhe anulimi i lejeve të lëshuara u njoftohet automatikisht sistemeve VISA dhe SSHP.

V. LËSHIMI I LEJES UNIKE PËR KATEGORI TË VEÇANTA

Për kategoritë e shtetasve të huaj që trajtohen me leje unike për kategori të veçanta, të parashikuara në nenin 81, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, aplikimi së bashku me dokumentacionin ligjor depozitohet pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin.

1. Autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin e përcjell aplikimin, brenda 24 orëve nga depozitimi, pranë autoritetit qendror të kufirit



dhe migracionit, i cili e shqyrton në Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave pranë këtij autoriteti.

2. Komisioni vendos miratimin ose refuzimin e aplikimit për leje unike për kategori të veçanta dhe njofton autoritetin vendor mbi vendimin e marrë, brenda 3 (tri) ditë pune nga depozitimi i kërkesës pranë këtij institucioni.

3. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pranë Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, në bazë të vlerësimeve rast pas rasti, kërkon nga autoriteti vendor për kufirin dhe migracionin verifikimin e përmbushjes së kriterëve të përcaktuara në ligjin nr. 79/2021, “Për të huajt”. Në këtë rast, vendimi i Komisionit mund të vonohet në varësi të përgjigjes së autoritetit vendor apo plotësimit të dokumentacionit nga i huaji.

4. Pas miratimit të aplikimit, autoriteti vendor për kufirin dhe migracionin ku i huaji ka vendqëndrimin e përkohshëm, pajis të huajin me dokumentin “Leje unike për kategori të veçanta” në formatin e miratuar me urdhër të ministrit të Brendshëm nr. 234, datë 13.12.2022.

VI. PËRLLOGARITJA E FILLIMIT TË AFATEVE TË LEJEVE TË QËNDRIMIT

1. Me qëllim unifikimin e procedurës për mënyrën e përlogaritjes së fillimit të afatit të lejes së qëndrimit/lejes unike, si datë fillimi, pas miratimit

nga të gjitha strukturat përgjegjëse, do të jetë data e regjistrimit online të kërkesës në portalin qeveritar.

2. Për shtetasit e huaj që duhet të aplikojnë me vizë, si datë e fillimit të lejes së qëndrimit/lejes unike do të jetë data e hyrjes në territorin e RSH, pas pajisjes me vizën përkatëse.

3. Për procedurën e ripërtëritjes, afati i lejes së rinovuar do të fillojë një ditë pas skadimit të lejes së mëparshme të qëndrimit/lejes unike.

4. Lejet e përhershme të qëndrimit, të tipit C, në mbështetje të pikës 6, të nenit 86, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, do të lëshohen me afat 10-vjeçar (dhjetëvjeçar).

VII. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Për ripërtëritjen e lejes së qëndrimit/lejes unike, ndiqet e njëjta procedurë si në rastin e kërkesës për pajisje për herë të parë, përjashtuar aplikimin për vizë për kategorinë e shtetasve të huaj që kërkojnë pajisjen me vizë të tipit D, kur aplikojnë për herë të parë.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Taulant Balla



ANEKSI NR. 1

DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
DREJTORIA VENDORE PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN _____

NJOFTIM

Ju njoftojmë se Leja e Qëndrimit/Leja Unike për shtetasin _____, me dokument udhëtimi nr. _____, FID _____ është miratuar.

Për lëshimin e dokumentit biometrik leje qëndrimi/unike, ju duhet të:

Hapi 1: Konfirmoni adresën e saktë të banimit në Zyrën e Gjendjes Civile (duke paraqitur brenda 30 ditëve këtë njoftim të printuar, dokumentin e udhëtimit dhe kontratën e qeras së banesës).

Hapi 2: Kryeni pagesën për vlerën e kartës biometrike duke blerë kuponin në zyrat e Postës Shqiptare

Hapi 3: Paraqiteni në Drejtorinë Vendore për Kufirin dhe Migracionin ose Komisaratin e Policisë Kufitare dhe Migracionit _____, për të kryer procedurën e pajisjes me kartën biometrike leje qëndrimi/leje unike për të huajt.

Faleminderit për mirëkuptimin!

Specialist i Migracionit _____

Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin /Komisariati i Policisë Kufitare dhe Migracionit _____

NOTE

We inform you that your Residence Permit/Single Permit for citizen _____, Travel Document no. _____, FID _____ has been approved.

To issue a biometric document Residence Permit/Unique Permit, you need:

Step 1: *Confirm the correct residential address at the Civil Registry Office (submitting this printed notice, travel document and apartment rental contract within 30 days).*

Step 2: *Make the payment by buying the coupon at the Post Office.*

Step 3: *Be present at the Local Director for Border and Migration or Border and Migration Commissariat _____ to perform the procedure for equipment with the biometric card Residence Permit for Foreigners.*

Thank you for understanding!

IdCode/20220105/2534510

Migration Specialist _____ Local Director for Border and Migration
or Border and Migration Commissariat _____



ANEKSI NR. 2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSSHME
DREJTORIA PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
DREJTORIA RAJONALE E KUFIRIT DHE MIGRACIONIT

REFUZIMI / ANULIMI I LEJES SË QËNDRIMIT / LEJES UNIQUE
REFUSAL / WITHDRAWAL OF RESIDENT PERMIT / UNIQUE PERMIT

Më , në Drejtorinë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin
On at the Regional Directorate for Border and Migration

☐ I refuzohet leja e qëndrimit shtetasit:
The citizen's residence permit is refused:

☐ I hiqet leja e qëndrimit shtetasit:
The citizen's residence permit is revoked:

Mbiemri
Family name

Emri
First name

Datëlindja
Date of birth

Vendlindja
Place of birth

Gjinia
Sex

Shtetësia
Nationality

Banues në
Resident in

Dokumenti udhëtimit Nr.
Travel document no.

Lëshuar në
Issued in

Më
on

në mbështetje të Ligjit Nr. 79/2021 “Për të huajt”, për arsyet në vijim:
based on Law No. 79/2021 “On Foreigners” for the following reasons:

☐ (A) Ka shkelur afatet e aplikimit për leje qëndrimi pa motiv (Neni 34/1(a) Ligji Nr. 79/2021 “Për të huajt”).

Groundless violation of the time limit for residence permit application (Article 34/1(a) of Law No. 79/2021 “On Foreigners”).



☐ (B) Nuk plotëson kushtet e nevojshme për qëndrim (Neni 34/1(b) Ligji Nr. 79/2021 “Për të huajt”) referuar:

Does not meet the necessary conditions for residence (Article 34/1(b) of Law No. 79/2021 “On Foreigners”).

☐ (C) Përbën kërcënim për rendin dhe sigurinë publike dhe është subjekt i largimit nga territori i Republikës së Shqipërisë (Nenet 34/1(c), 72/1(c) Ligji Nr. 79/2021 “Për të huajt”).

The applicant is a threat to public order and security and he is subject to removal from the territory of the Republic of Albania (Articles 34/1(c), 72/1(c) of the Law No. 79/2021 “On Foreigners”).

☐ (C) Nuk ekzistojnë me arsytet për të cilat është lëshuar leja e qëndrimit/leja unike (Neni 34/1(d), 72/1 (dh) Ligji Nr. 79/2021 “Për të huajt”).

The reasons for which the residence permit/unique permit is issued no longer exist (Article 34/1(d), 72/1(dh) of Law No. 79/2021 “On Foreigners”).

☐ (D) Ka qëndruar mbi 180 ditë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë (Nenet 34/1(e), 72/1(d) Ligji Nr. 79/2021 “Për të huajt”).

The foreigner has stayed more than 180 days outside the territory of the Republic of Albania (Articles 34/1(e), 72/1(d) of Law No. 79/2021 “On Foreigners”).

☐ (DH) Në rast se i huaji ka përfituar lejen e qëndrimit për shkak të bashkimit familjar dhe është zgjidhur martesë (Neni 34/1 (ç) Ligji Nr. 79/2021 “Për të huajt”).

In case the foreigner has obtained a residence permit due to family reunification and the marriage has been dissolved (Article 34/1 (ç) Law No. 79/2021 “For foreigners”).

☐ (E) Kur leja e qëndrimit/leja unike është marrë duke përdorur dokumentacion të rremë ose në kushte mashtrimi (Nenet 34/1 (dh), 72/1 (a) Ligji Nr. 79/2021 “Për të huajt”).

When the resident permit/unique permit was obtained using false documentation or under fraudulent conditions (Articles 34/1 (dh), 72/1 (a) Law No. 79/2021 “For foreigners”).

☐ (Ë) Pas lëshimit të lejes unike, provohet se dokumentacioni që shoqëron kërkesën nuk është i saktë (Neni 72/1 (b) Ligji Nr. 79/2021 “Për të huajt”).

After the issuance of the unique permit, it is proved that the documentation accompanying the request is not correct (Article 72/1 (b) Law No. 79/2021 “For foreigners”).

☐ (F) Leja unike është anuluar (Neni 72/1 (ç) Ligji Nr. 79/2021 “Për të huajt”).

The unique permit has been canceled (Article 72/1 (ç) Law No. 79/2021 “For foreigners”).

☐ (G) I huaji ndërpret kontratën e punës për arsye të ndryshme dhe largohet nga vendi i punës për të cilin ka marrë lejen (Neni 72/1 (e) Ligji Nr. 79/2021 “Për të huajt”).

The foreigner terminates the employment contract for various reasons and leaves the workplace for which he received the permit (Article 72/1 (e) Law No. 79/2021 “On Foreigners”).

Komente/Comments

Personi i interesuar mund të ankohet ndaj vendimit për refuzimin e lejes së qëndrimit/lejes unike, sipas parashikimeve të Ligji nr. 79/2021 “Për të huajt” dhe parashikimeve të legjislationit Shqiptar.

The person concerned may appeal against the decision refusing the resident permit/unique permit as provided for in the law No. 79/2021 “On Foreigners”) and in the provisions of the Albanian legislation.

Personi i interesuar

Person concerned

Autoriteti

Authority



UDHËZIM

Nr. 116, datë 11.7.2024

**PËR PROCEDURAT DHE
FORMULARIN E REGJISTRIMIT E TË
HUAJIT NË REGJISTRIN KOMBËTAR
TË GJENDJES CIVILE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 36, të ligjit nr. 79/2021 “Për të huajt”,

UDHËZOJ:

1. I huaji, i cili ka marrë njoftimin për miratimin e Lejes së Qëndrimit ose Unike, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, ka detyrimin të paraqitet pranë Zyrës së Gjendjes Civile ku ka vendosur vendbanimin e tij të përkohshëm, duke paraqitur dokumentacionin, si vijon:

a) njoftimin sipas modelit në aneksin 1, të këtij udhëzimi;

b) dokumentin e udhëtimit me të cilin ka hyrë dhe qëndron në Shqipëri;

c) fotokopje e noterizuar e kontratës së qirasë, apo të një dokumenti që tregon që ka në pronësi një banesë.

2. Me paraqitjen në zyrën e Gjendjes Civile, të dhënat e të huajt aktivizohen në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC), duke mundësuar fillimin e procesit të aplikimit për dokument biometrik, leje qëndrimi/leje unike për të huajt.

3. Në rast të ndryshimit të vendbanimit të të huajt, deklarimi për ndryshimin e vendbanimit duhet të bëhet nëpërmjet portalit *e-Albania*, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga ardhja në vendbanimin e ri.

4. Kur të huajt i përfundon afati i lejes së qëndrimit apo lejes unike, të dhënat e tij automatikisht çaktivizohen në RKGJC, brenda një muaji nga përfundimi i lejes së qëndrimit/lejes unike.

5. Në rastin kur i huaji largohet nga territori i Republika e Shqipërisë, apo i anulohet leja e qëndrimit për arsye të ndryshme, strukturat përgjegjëse të migracionit pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin, njoftojnë strukturat përgjegjëse të migracionit pranë autoritetit qendror për kufirin dhe migracionin, të cilat marrin masa për

anulimin e lejes së qëndrimit në sistemin FER. Ky njoftim i shkon automatikisht Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Ndryshimi i statusit të shtetasit të huaj në RKGJC ndodh automatikisht, duke u ndryshuar nga “aktiv” në “i bllokuar”.

6. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet pasi të pasqyrohen zhvillimet përkatëse teknike në portalin *e-Albania*.

MINISTËR I BRENDSHËM
Taulant Balla

ANEKSI NR. 1

**DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE
MIGRACIONIN
DREJTORIA VENDORE PËR KUFIRIN
DHE MIGRACIONIN _____****NJOFTIM**

Ju njoftojmë se leja e qëndrimit/leja unike për shtetasin _____, me dokument udhëtimi nr. _____, FID _____ është miratuar.

Për lëshimin e dokumentit biometrik leje qëndrimi/unike, ju duhet të:

Hapi 1: Konfirmoni adresën e saktë të banimit në Zyrën e Gjendjes Civile (duke paraqitur brenda 30 ditëve këtë njoftim të printuar, dokumentin e udhëtimit dhe kontratën e qirasë së banesës).

Hapi 2: Kryeni pagesën për vlerën e kartës biometrike, duke blerë kuponin në zyrat e Postës Shqiptare

Hapi 3: Paraqiteni në Drejtorinë Vendore për Kufirin dhe Migracionin ose Komisaratin e Policisë Kufitare dhe Migracionit _____, për të kryer procedurën e pajisjes me kartën biometrike leje qëndrimi/leje unike për të huajt.

Faleminderit për mirëkuptimin!

Specialist i Migracionit _____

Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin/Komisariati i Policisë Kufitare dhe Migracionit _____

**NOTE**

We inform you that your Residence Permit/ Single Permit for citizen _____, Travel Document no. _____, FID _____ has been approved.

To issue a biometric document Residence Permit/ Unique Permit, you need:

Step 1: *Confirm the correct residential address at the Civil Registry Office (submitting this printed notice, travel document and apartment rental contract within 30 days).*

Step 2: *Make the payment by buying the coupon at the Post Office*

Step 3: *Be present at the Local Director for Border and Migration or Border and Migration Commissariat _____ to perform the procedure for equipment with the biometric card Residence Permit for Foreigners.*

Thank you for understanding!

Id Code/20220105/2534510

Migration Specialist _____

Local Director for Border and Migration or Border and Migration Commissariat _____

NJOFTIM

Nr. 3049/1, datë 11.7.2024

**PËR HYRJEN NË FUQI TË
MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE**

1. Konventa për marrëveshjet për zgjedhjen e gjykatës, bërë në Hagë më 30 qershor 2005, hyn në fuqi për Republikën e Shqipërisë më 1 tetor 2024.

2. Protokolli për ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore, bërë në Hagë, më 23 nëntor 2007, hyn në fuqi për Republikën e Shqipërisë më 1 tetor 2024.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Armand Skapi

VENDIM

Nr. 41, datë 29.5.2024

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare,
Marsida Xhaferllari	anëtare,
Fiona Papajorgji	anëtare,
Sonila Bejtja	anëtare,
Sandër Beci	anëtar,
Ilir Toska	anëtar,
Marjana Semini	anëtare,
Genti Ibrahimimi	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 29.5.2024 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 25 (Sh) 2023, që u përket:

KËRKUESE: Shoqëria “Ferlut” sh.a., përfaqësuar nga avokat Ervin Metalla, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Shoqëria “Albanian Petroleum Investment” sh.a., përfaqësuar nga avokat Aranit Roshi. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, drejtoria vendore Tiranë, në mungesë. Ministria e Financave, përfaqësuar nga Risena Xhaja. Shoqëria “Fiduciaria Marche” S.R.L., në mungesë. Shoqëria “Gpl-Costruzioni Generali” S.R.L., në mungesë. “Raiffeisen Bank” sh.a., përfaqësuar nga Alexander Zsolnai. Avokatura e Shtetit, në mungesë. Luigi Fabri, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-882 (117), datë 8.3.2023, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtuësëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 41, 42, 122, pikat 1 dhe 2, 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “I” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; nenet 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimimi, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkeses, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës,



prapësimet e subjekteve të interesuara, shoqërisë “Albanian Petroleum Investment” sh.a., Ministrisë së Financave, bankës “Raiffeisen Bank” sh.a., të cilat kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e parashtrimeve me shkrim të subjekteve të interesuara, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), Avokaturës së Shtetit, shoqërisë “Fiduciaria Marche” s.r.l., shoqërisë “GPL-Costruzioni Generali” s.r.l. dhe Luigi Fabri, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja, shoqëria “Ferlut” sh.a, nëpërmjet privatizimit të pjesës (kuotave) shtetërore në kapitalin themeltar të shoqërisë së përbashkët “Diana” sh.p.k., është bërë pronare e objektit ish-Shkolla e Ushqimit Social në Laprakë, Tiranë, regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme si pasuria nr. 7/246-ND, zona kadastrale nr. 8310. Në gentplanin e këtij objekti të shoqërisë “Diana” sh.p.k., trualli i tij pasqyrohet me sipërfaqe 4788.5 m². Për një pjesë të këtij trualli, konkretisht për sipërfaqen 3176 m², kërkuesja është në konflikt me shoqërinë “Albanian Petroleum Investment” (AL.P.IN) sh.a., në pronësi të së cilës kjo pasuri është regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme, ku identifikohet si pasuria nr. 7/258, zona kadastrale nr. 8310.

2. Shoqëria “AL.P.IN” sh.a. është ortake e vetme e shoqërisë “Tirana Trade Center” (TTC) sh.p.k., pas blerjes së kuotave të kësaj shoqërie nëpërmjet kontratës së shitjes nr. 3048 rep., nr. 480 kol., datë 6.9.2005 (*kontrata e shitjes së kuotave*), nga ortaku i vetëm i saj, shoqëria italiane “GGIF Investiment” s.r.l. Kjo e fundit, ka qenë ortak themelues bashkë me shtetin shqiptar i shoqërisë “TTC” sh.p.k., ku shteti shqiptar zotëronte 45% të kuotave, që përfaqësonin kontribute në natyrë, kuota të cilat janë privatizuar në favor të ortakut tjetër, shoqërisë italiane “GGIF Investiment” s.r.l., me kontratën nr. 2146 rep., nr. 446 kol., datë 9.8.2005 (*kontrata e privatizimit të kuotave*).

3. Kërkuesja ka kërkuar nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit (sot Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike - DASHPP) shitjen e truallit në përdorim të objektit shtetëror të

privatizuar nga ajo, për të cilën ka marrë përgjigje me shkresën nr. 3837/1 prot., datë 6.1.2006, ku informohet se procedura për shitjen e truallit nuk mund të vijonte. Ndërsa Bashkia Tiranë, me shkresën nr. 1418/1 prot., datë 14.5.2004, ka informuar kërkuesen se nuk mund të bënte vlerësimin e truallit, pasi vërtetimi hipotekar i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP), Tiranë përmbante shënimin “I vlefshëm për gjykatë” dhe deri në zgjidhjen e këtij problemi vlerësimi i truallit nuk mund të kryhej.

4. Në datën 12.11.2010 shoqëria “AL.P.IN” sh.a. ka paraqitur në gjykatë padi me objekt lirim dhe dorëzim sendi (trualli me sipërfaqe 3176 m²), duke thirrur si palë të paditur shoqërinë “Ferlut” sh.a.

5. Gjatë gjykimit kërkuesja ka paraqitur kundërpadi me objekt: i. konstatimin e pavlefshmërisë absolute të *kontratës së shitjes së kuotave dhe të kontratës së privatizimit të kuotave*; ii. kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme, duke urdhëruar ZRPP-në, Tiranë të çregjistrojë pasurinë me sipërfaqe 3176 m² nga pronësia e shoqërisë “AL.P.IN” sh.a. dhe ta regjistrojë atë në pronësi të shtetit; iii. detyrimin e DASHPP-së për të filluar procedurën e privatizimit të truallit me sipërfaqe 3176 m², të cilin e ka në posedim dhe gëzon të drejtën e parablerjes, sipas VKM-së nr. 738, datë 8.9.2010, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të shitjes së trojeve në përdorim, sipërfaqe të domosdoshme dhe shtesë funksionale të ndërmarrjeve, shoqërive apo të objekteve shtetërore, të veçuara, të privatizuara dhe të ndërtesave të ndërtuara në bazë të lejeve të ndërtimit”. Kërkuesja ka thirrur në cilësinë e palëve të paditura shoqërinë “AL.P.IN” sh.a., Drejtorinë e Administrimit dhe ZRPP-në, Tiranë, shoqëritë “Fiduciaria Marche” s.r.l., “Costruzioni Generali” s.r.l., si dhe shtetasin italian Luigi Fabri, të cilëve u kanë kaluar të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë “GGIF Investimenti” s.r.l., për sa kohë kjo e fundit nuk ekzistonte më juridikisht si subjekt në momentin e ngritjes së padisë.

6. Në padinë e saj kërkuesja ka pretenduar se gëzon të drejtën për privatizimin e truallit me sipërfaqe 3176 m², të cilin e ka në përdorim, ndërsa ka qenë pjesë e gentplanit të objektit shtetëror të shoqërisë “Diana” sh.p.k. të privatizuar nga ajo, por se kjo e drejtë i pengohet nga tjetërsimi i kundërligjshëm i truallit përmes kontratave absolutisht të pavlefshme të lidhura mes të



paditurve. Kërkuesja ka pretenduar se trualli objekt padie nuk ka qenë asnjëherë pjesë e kapitalit themeltar të shoqërisë “TTC” sh.p.k., si kontribut në natyrë i ortakut shteti shqiptar. Për më tepër, kontributi në natyrë i këtij të fundit ka qenë vetëm në objekte të llojit ndërtesa. Nëpërmjet *kontratës së privatizimit të kuotave*, në kapitalin e shoqërisë “TTC” sh.p.k. është përfshirë padrejtësisht edhe trualli, ndaj për këtë shkak ajo është absolutisht e pavlefshme. Sipas kërkueses, kontrata, në fakt, është për shitjen e pasurisë, kurse për sa i përket shitjes së truallit shoqërisë italiane “GGIF Investment” s.r.l. është në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit. Konkretisht, bëhet fjalë për ligjin nr. 7512, datë 10.8.1991, “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit” (*ligji nr. 7512/1991*) dhe ligjin nr. 7980, datë 27.7.1995, “Për shitblerjen e trojeve”, të ndryshuar (*ligji nr. 7980/1995*), të cilat kufizojnë të drejtën e blerjes së trojeve nga të huajt. Po ashtu, ajo kontratë është e pavlefshme edhe për shkak të shitjes së truallit nën vlerë, përveçse kjo shitje është bërë në një kohë kur shoqëria blerëse kishte kaluar në likuidim. Për shkak të pavlefshmërisë së *kontratës së privatizimit të kuotave* është absolutisht e pavlefshme edhe *kontrata e shitjeve të kuotave*, e cila edhe ajo në fakt është për shitjen e truallit, pasi pikërisht nëpërmjet saj shoqëria “AL.P.IN” sh.a. është bërë pronare e tij.

7. Krahas kundërpadisë kërkuesja ka paraqitur kallëzim penal kundër punonjësve të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit dhe ZRPP-së, Tiranë për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Për këtë kallëzim, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e datës 12.7.2011, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, me arsyetimin se nuk mund të ushtrohej ndjekja penale, pasi vepra penale e shpërdorimit të detyrës ishte shuar, ndërsa një pjesë e fakteve të parashtruara në kallëzim nuk parashikohej nga ligji si vepër penale. Për sa u përket pretendimeve të kallëzuesit për pavlefshmërinë e *kontratave të privatizimit të kuotave dhe të shitjes së tyre*, kallëzuesi është orientuar t’i drejtohej gjykatës me padi civile.

8. Gjatë vijimit të procesit gjyqësor, në seancën e datës 15.6.2012 të zhvilluar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pala paditëse, shoqëria “AL.P.IN” sh.a., ka hequr dorë nga padia dhe gjykata ka vendosur pushimin e çështjes për këtë pjesë, duke

vijuar me shqyrtimin e kundërpadisë dhe konsideruar atë si padi. Në datën 24.10.2012 shoqëria “AL.P.IN” sh.a. ka ngritur përsëri përpara gjykatës, në formën e kundërpadisë, pretendimin për pushimin e cenimit të pronësisë për truallin me sipërfaqe 3176 m², por gjykata në vijim ka vendosur pushimin e kundërpadisë, për shkak të mosparaqitjes në gjykim të përfaqësuesit të kësaj pale pa ndonjë shkak të arsyeshëm, megjithëse kishte dijeni. Në këto kushte gjykimi i çështjes ka vazhduar vetëm mbi padinë e kërkueses.

9. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 8823, datë 29.7.2013, ka vendosur rrëzimin e padisë së kërkueses, me arsyetimin se asaj i mungon legjitimiteti në ngritjen e padisë në lidhje me kërkimin për detyrimin e DASHPP-së për të filluar procedurën e privatizimit të truallit me sipërfaqe 3176 m², pasi ajo nuk ka gëzuar asnjëherë të drejtën e parablerjes së këtij trualli, për sa kohë ky truall nga viti 1993 ka qenë në pronësi të shoqërisë “TTC” sh.p.k., pra shumë kohë përpara se kërkuesja të privatizonte objektin dhe të paraqiste kërkesën për privatizimin e truallit të tij. Po ashtu, gjykata ka gjetur të pabazuar edhe kërkimin e padisë për pavlefshmërinë e *kontratës së privatizimit të kuotave* dhe *kontratës së shitjes së tyre*, duke vlerësuar se nuk ndodhet në asnjë nga kushtet e parashikuara nga neni 92 i Kodit Civil (KC). Sipas gjykatës, pretendimi i palës paditëse (kërkueses) për pavlefshmërinë e *kontratës së privatizimit të kuotave* referuar ligjit nr. 7512/1991, i cili kufizonte të drejtën e blerjes së trojeve nga të huajt, është i pambështetur në prova e në ligj, pasi në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me një kontratë shitblerjeje trualli, por me një kontratë për shitjen e kuotave të zotëruara nga shteti në një shoqëri tregtare shqiptare. Për privatizimin e kuotave të shtetit shqiptar në shoqëri është ndjekur procedura ligjore, e cila nuk është kundërshtuar gjyqësisht nga paditësja (kërkuesja). Për më tepër, sipas gjykatës, referuar dokumentit hipotekar vërtetim pronësie të datës 14.12.2009, kalimi i pronësisë së truallit nga shoqëria “TTC” sh.p.k. në favor të shoqërisë “AL.P.IN” sh.a. nuk është bërë me anë të *kontratës së shitjes së kuotave*, por me kontratën e shitjes së datës 15.3.2008, e cila nuk është pjesë e këtij gjykimi dhe as nuk është administruar si provë. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim kërkuesja dhe personi i tretë, Avokatura e Shtetit.



10. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 3089, datë 11.9.2014, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke pranuar pjesërisht padinë e kërkuësës dhe konstatuar pjesërisht të pavlefshme *kontratën e privatizimit të kuotave dhe kontratën e shitjes së kuotave*, si dhe urdhëruar kthimin dhe regjistrimin e truallit 3176 m² në pronësi të shtetit. Për pjesën tjetër të padisë, gjykata e apelit ka vendosur rrëzimin e saj. Sipas asaj gjykate, gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar drejt provat, duke arritur në përfundime të gabuara për faktet dhe zbatimin e ligjit. Gjykata e apelit ka pranuar se shoqëria “Ferlut” sh.a. ka legjitimitet të plotë për ngritjen e padisë, pasi rezulton qartësisht e drejta e parablerjes të truallit të përcaktuar në gentplanin e privatizimit prej saj të objektit shtetëror, truall të cilin ajo e ka poseduar në vijimësi. Po ashtu, gjykata e apelit ka arritur në përfundimin se truallit objekt padie nuk ka qenë në pronësi të shoqërisë “TTC” sh.p.k. në momentin e krijimit të saj në vitin 1993, si kontribut në natyrë i ortakut shteti shqiptar. Sipas saj, referuar provave dhe vlerës së pasqyruar në aktet e shoqërisë për kontributin në natyrë të shtetit shqiptar, provohej fakti se ky kontribut në kapitalin e shoqërisë ka konsistuar në 6 objekte dhe mjete xhiroje, ndërsa kontributi për sa i përket truallit ka qenë vetëm në përdorimin e tij, pasi nëse do të pranohej e kundërta, kontributi në natyrë i shtetit shqiptar do të ishte shumë më i lartë pikërisht nisur nga vlera e truallit.

11. Në vijim, gjykata e apelit ka arritur në përfundimin se kalimi në pronësi të të paditurve i truallit objekt padie është në kundërshtim me ligjin, ndaj për këtë pjesë *kontrata e privatizimit të kuotave dhe kontrata e shitjes së kuotave* janë absolutisht të pavlefshme. Sipas gjykatës së apelit, pavarësisht emërimit të tyre, këto kontrata janë për shitjen e truallit, pasi çmimi i tyre në fakt përfaqëson pikërisht vlerën e truallit. Nisur nga kjo, gjykata e apelit ka vlerësuar të drejtë pretendimin e kërkuësës për pavlefshmërinë absolute të *kontratës së privatizimit të kuotave*, për shkakun se është bërë në shkelje të një dispozite urdhëruese të ligjit, pikërisht të ligjit nr. 7512/1991 dhe ligjit nr. 7980/1995, të cilat kufizonin të drejtën e blerjes së trojeve nga të huajt, pasi në rastin konkret truallit i është shitur shoqërisë italiane “GGIF Investment” s.r.l. Gjykata e apelit ka konstatuar gjithashtu se gjykata e shkallës së parë nuk ka trajtuar në vendimin e saj pavlefshmërinë e *kontratës së privatizimit të kuotave* që rezulton nga

vlerësimi i truallit nën vlerë dhe as pavlefshmërinë e saj për shkak se ajo është bërë në një kohë kur shoqëria blerëse “GGIF Investment” s.r.l. kishte kaluar në likuidim. Sipas saj, procedura e ndjekur për privatizimin e kuotave, në fakt për shitjen e truallit, është në kundërshtim me ligjin, ndërsa çmimi i privatizimit është përcaktuar në vlerën 77.200.000 lekë, vlerë kjo shumë më e vogël se vlera reale e truallit prej 373.163.956 lekësh. Po sipas gjykatës, provohej se shoqëria blerëse italiane ka kaluar në likuidim prej vitit 2003, ndaj, referuar neneve 34 dhe 35 të KC-së, veprimet juridike të kryera me një subjekt të tillë janë të pavlefshme edhe për këtë shkak. Gjykata e apelit, po ashtu, në ndryshim nga sa ka pranuar gjykata e shkallës së parë, ka arritur në përfundimin se nuk ekziston asnjë kontratë shitjeje e datës 15.3.2008 që të ketë kaluar pronësinë e truallit 3176 m² nga shoqëria “TTC” sh.p.k. tek shoqëria “AL.P.IN” sh.a., ndërsa provohet se kjo pronësi ka kaluar pikërisht nëpërmjet *kontratës së shitjes së kuotave*, referuar përmbajtjes së kësaj të fundit, e cila pavarësisht emërimit në fakt është kontratë për shitjen e truallit.

12. Për sa i përket kërimit të padisë për detyrimin e organit publik që të fillonte procedurën e privatizimit të truallit objekt padie, gjykata e apelit e ka rrëzuar me arsyetimin se fillimi i një procedure të tillë administrative i përket organit publik, i cili, pas konstatimit absolutisht të pavlefshme të kontratave objekt padie dhe kthimin e truallit në pronësi të shtetit, mund të fillonte këtë procedurë dhe truallin detyrimisht duhet t’ia privatizojë kërkuësës.

13. Mbi rekursin e të paditurve shoqëria “AL.P.IN” sh.a. dhe shoqëria “Fiduciaria Marche” s.r.l. dhe të personave të tretë në gjykim, Avokaturës së Shtetit dhe bankës “Raiffeisen Bank” sh.a., Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2023-882 (117), datë 8.3.2023, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Sipas Kolegjit Civil, vendimi i gjykatës së apelit është i pabazuar në prova dhe në ligj, për pasojë duhet të priset, ndërkohë që vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i bazuar në ligj e prova, ndaj ai duhet të lihet në fuqi.

14. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se shoqëria “Ferlut” sh.a. gëzon legjitimitet procedural (formal), duke qenë se në bazë të VKM-së nr. 562, datë 9.10.1995, “Për shitjen e truallit të



ndërmarrjeve që privatizohen”, pronari që ka blerë një objekt, ka të drejtë të blejë edhe truallin funksional të tij. Pikërisht këtu qëndron edhe interesi i saj, që duke pretenduar se plotëson kriteret ligjore sipas këtij akti nënligjor, të blejë truallin objekt padie. Nisur nga kjo, ndërsa nuk mund të vendosë kthimin e akteve ose pushimin e gjykimit, Gjykata e Lartë është shprehur se do të ndalej në analizën e legjitimitetit substancial (*legitimitatio ad causam*) të kërkuësës, në përfundim të së cilës ka arritur në konkluzionin se ajo shoqëri nuk e gëzon atë.

15. Sipas Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, me *kontratën e privatizimit të kuotave* është bërë privatizimi i kuotave shtetërore në favor të shoqërisë “GGIF Investment” s.r.l., në përmbajtje të së cilës, më saktësisht në nenin 2 të saj, parashikohet se objekti i saj është shitja e kuotave të zotëruara nga shteti në shoqërinë “TTC” sh.p.k., me vlerën 100.961.657 lekë, që përfaqëson 45% të kuotave të kapitalit shtetëror në këtë shoqëri, ku pjesë e këtij kapitali është edhe trualli me sipërfaqe 38.600 m². Po sipas atij kolegji, me kontratën e shitjes së kuotave, shoqërisë “AL.P.IN” sh.a. i janë shitur 100 % të kuotave të shoqërisë “TTC” sh.p.k., duke u bërë ajo ortaku i vetëm i kësaj të fundit. Mbi këtë bazë, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka gjetur të drejtë arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë se *kontrata e privatizimit të kuotave* ka pasur për objekt shitjen e kuotave të zotëruara nga shteti shqiptar në shoqërinë “TTC” sh.p.k. dhe jo shitjen e truallit ose të pasurive të paluajtshme, të cilat kanë qenë në pronësi të kësaj shoqërie nga momenti i krijimit dhe që kanë mbetur në pronësi të saj edhe pas *kontratës së privatizimit të kuotave* dhe *kontratës së shitjes së tyre*. Ai kolegji është shprehur se vlerësimi i truallit dhe i ndërtesave është bërë me qëllimin e vetëm për të përcaktuar çmimin e kuotave të shoqërisë, ku këto të fundit kanë qenë objekt shitjeje, për tjetërsimin e të cilave nuk ka pasur asnjë pengesë apo kufizim ligjor, ndaj nuk qëndrojnë pretendimet e paditësit (kërkuësës) për pavlefshmërinë absolute të kësaj kontrate.

16. Për më tepër, sipas Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, paditësi (kërkuësja), në zgjidhjen e pasojave që passhoqërojnë pavlefshmërinë absolute të kontratave objekt padie, nuk ka kërkuar detyrimin e Ministrisë së Ekonomisë për ta tjetërsuar truallin në favor të tij, me qëllim për të justifikuar këtu ligjërisht mbrojtjen e interesit të tij (të cenuar), por ka kërkuar

vetëm kthimin në gjendjen fillestare, pra në pronësi të shtetit.

17. Në datën 25.9.2023 kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij. Me vendimin e datës 4.12.2023, Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës ka vendosur pranimin e kërkesës së një anëtarit të saj për heqjen dorë nga shqyrtimi i kësaj çështjeje. Me vendimin e datës 27.12.2023, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila, me vendimin e datës 9.1.2024, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

18. Kërkuësja, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se në procesin gjyqësor të kundërshtuar është cenuar:

18.1. *E drejta për proces të rregullt në drejtim të:*

18.1.1. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë të njëjtat fakte të çështjes i ka vlerësuar tërësisht ndryshe nga gjykatat më të ulëta. Kolegji Civil, në paragrafin 55 të vendimit ka ndryshuar ekzistencën e fakteve dhe rrethanave që janë vërtetuar gjatë gjykimit në atë gjykatë dhe ka arritur në konkluzione për faktet në kundërshtim me përfundimet e atyre gjykatave. Ai ka vlerësuar fakte që nuk janë pranuar më parë si të vërteta nga gjykata e apelit dhe ka pranuar si të saktë dhe të vërtetë vlerësimin e fakteve të kryer nga gjykata e shkallës së parë. Në të tilla raste, Gjykata e Lartë nuk mund të zgjedhë se cilin vlerësim të fakteve të marrë të vërtetë, por është e detyruar të konsiderojë të vërtetë dhe të saktë vlerësimin e fakteve të bërë nga gjykata e apelit, si gjykata e fundit që ka vlerësuar faktet dhe provat dhe vendimi i së cilës është objekt rekursi. Zgjidhja e mosmarrëveshjes midis palëve ndërgjyqëse në këtë çështje shtronte si problematikë vetëm kualifikimin juridik të fakteve dhe provave dhe nuk paraqiste asnjë problematikë të zbatimit të ligjit, ndaj ndërhyrja e Gjykatës së Lartë është tërësisht jashtë funksionit të saj si gjykatë ligji. Kolegji Civil ka shpërfillur dhe anashkaluar tërësisht pretendimet dhe argumentet ligjore të kërkuësës duke mos u dhënë përgjigje atyre. Nxjerrja e konkluzionit për provat ndryshe nga vlerësimi i gjykatës së apelit nuk pajtohet me



natyrën e gjykimit në Gjykatën e Lartë. Gjykata e Lartë nuk mund të vlerësojë *a priori* nëse është vërtetuar ose jo një fakt i caktuar, qoftë edhe kur konkludimi është bërë nga gjykata e shkallës së parë.

18.1.2. *Së drejtës së aksesit substancial*, pasi as kërkueses, as mbrojtësit ligjor të saj nuk i janë njoftuar rekursat e palëve të paditura edhe pse adresat e tyre u janë komunikuar gjykatave të faktit dhe nuk janë ndryshuar asnjëherë. Për përmbajtjen e rekurseve kërkuesja është vënë në dijeni pas studimit të dosjes dhe pas shpalljes së datës së gjykimit dhe në datën 27.2.2023 ajo i është drejtuar Gjykatës së Lartë me memo, nëpërmjet së cilës ka kërkuar mospranimin e rekurseve të paraqitura.

18.1.3. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi Kolegji Civil në vendimin e kundërshtuar nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkueses se trulli me sipërfaqe 3176 m² nuk ka qenë pjesë e kapitalit të shoqërisë “TTC” sh.p.k. dhe se shoqëria “AL.P.I.N” sh.a. e ka fituar pronësinë nga kontrata e shitjes nr. rep. 3048, nr. kol. 480, datë 6.9.2005. Në kundërshtim me sa arsyeton gjykata e shkallës së parë është pikërisht kjo kontratë e shitjes së kuotave që ka transferuar pronësinë e trullit nga shoqëria “TTC” sh.p.k., tek shoqëria “AL.P.I.N” sh.a. Ndërsa kontrata e shitjes e datës 15.3.2008, që sipas gjykatës së shkallës së parë është titulli juridik me anë të të cilit është transferuar pronësia e trullit, nuk ekziston dhe nuk është nënshkruar asnjëherë. Po në këtë drejtim, Kolegji Civil nuk ka arsyetuar për pavlefshmërinë e kontratave të privatizimit, për shkak se trulli nuk ishte pjesë e kapitalit shtetëror në shitje, duke i mohuar kërkueses të drejtën e aksesit substancial në gjykatë. Ky kolegji nuk ka arsyetuar në lidhje me pretendimin e kërkueses se shoqëria “AL.P.I.N” sh.a. e ka blerë trullin nën vlerën që përcaktohej nga aktet nënligjore, çfarë sjell pavlefshmërinë e kontratës së privatizimit. Ai nuk ka arsyetuar dhe nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit të kërkueses se në bazë të ligjit nr. 7512/1991 është kufizuar e drejta e blerjes së trullit nga të huajt, sepse kontratat e kundërshtuara kanë për objekt përveç shitblerjes së kuotave edhe kalimin e pronësisë së trullit. Edhe në aspektin formal vendimi i Kolegjit Civil nuk ka parashtruar te faktet e çështjes veprime procedurale të rëndësishme, siç është memoja e datës 27.2.2023 e paraqitur nga kërkuesja dhe memoja e datës 1.3.2023, e depozituar nga pronari i trullit, shoqëria “LTD&Co” sh.p.k.,

duke mbajtur një qëndrim subjektiv në paraqitjen e rrethanave të çështjes.

18.2. *E drejta e pronës private*, pasi Kolegji Civil nuk ka arsyetuar në lidhje me pretendimet e kërkueses në memon nr. 1317 prot., datë 27.2.2023 dhe pretendimet e shoqërisë “LTD&Co” sh.p.k. në memon nr. 1365 prot., datë 1.3.2023, duke i shpërfillur e anashkaluar ato dhe duke mos iu përgjigjur argumenteve ligjore për pavlefshmërinë e kontratave të privatizimit, si dhe në lidhje me faktin se trulli tashmë ishte përfituar nëpërmjet procedurës së legalizimit dhe ishte tjetërsuar te palët e treta. Kolegji Civil ka arsyetuar dhe zgjidhur mosmarrëveshjen bazuar vetëm në një arsyetim të përciptë dhe të përgjithshëm, jo mbi zbatimin e ligjit, por mbi vlerësimin e fakteve, duke cenuar të drejtën e pronës.

19. Subjekti i interesuar, shoqëria “AL.P.I.N” sh.a., në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar:

19.1. Pretendimi për cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj është i pabazuar, pasi Gjykata e Lartë nuk ka asnjë kufizim që të bëjë vlerësimin e fakteve apo rrethanave sipas vlerësimit të bërë nga gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar se kjo e fundit ka bërë një përcaktim të saktë dhe korrekt të rrethanave të faktit. Pretendimi i kërkueses për kufizimin e së drejtës së Gjykatës së Lartë vetëm në vlerësimin e fakteve dhe provave të bërë nga gjykata e apelit apo pranimi *apriori* si të mirëqena i këtyre vlerësimeve, duke përjashtuar vlerësimet dhe përfundimet e gjykatës së shkallës së parë, përbën një deformim të kontrollit gjyqësor që Gjykata e Lartë ushtron mbi vendimet e gjykatave të faktit.

19.2. Pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit *substancial* është i pabazuar, pasi nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton se komunikimi i rekursit është bërë në adresën e përcaktuar nga kërkuesja në kundërpadi. Gjykata e Lartë e ka njoftuar kërkuesen për zhvillimin e seancës në dhomën e këshillimit, si dhe e ka informuar për të drejtën e paraqitjes së pretendimeve dhe me memon nr. 1317 prot., datë 27.2.2023 ajo ka paraqitur argumente dhe akte në mbështetje të pretendimeve të saj. Madje edhe shoqëria “LTD&Co” sh.p.k., edhe pse nuk është palë në proces, ka depozituar memon nr. 1365 prot., datë 1.3.2023, ku ka parashtruar argumentet e saj. Referuar të dhënave të faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë është shpallur lista e seancave për t’u shqyrtuar në dhomën e këshillimit, ku bën pjesë edhe çështja e



kërkueses, dhe njoftimi është bërë në ambientet fizike të kësaj gjykate dhe është i administruar në dosjen gjyqësore. Kërkuesja, përmes avokatit, ka paraqitur pretendimet dhe prapësimet në lidhje me rekursin, si dhe shkaqet për të cilat është kërkuar lënia në fuqi e vendimit të gjykatës së apelit, të cilat janë marrë në shqyrtim dhe janë vlerësuar nga Gjykata e Lartë, duke mos e vënë kërkuesen në pozitë të disfavorshme.

19.3. Pretendimi për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit* është i pabazuar, pasi Kolegji Civil ka sqaruar se objekti i marrëdhënies nuk është kalimi i të drejtave pronësore të truallit, por kalimi i kuotave që pronari shtet ka në shoqërinë “TTC” sh.p.k. dhe ka argumentuar se vlerësimi i truallit si aset i shoqërisë “TTC” sh.p.k., është bërë me qëllimin e vetëm për të përcaktuar çmimin e kuotës. Mungesa e legjitimitetit substancial të paditëses, si rrjedhojë e mungesës së interesit të ligjshëm, në kuptim të nenit 32 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), është shkaku ligjor dhe argumenti mbi bazën e të cilit Kolegji Civil ka vendosur rrëzimin e padisë. Vendimi nuk rezulton të jetë alogjik, kontradiktor, i paqartë në përmbajtje dhe në vlerësimin e tij Kolegji Civil ka çmuar se pritshmëritë e paditëses nuk u përgjigjen kërtimeve të saj, të cilat janë rrjedhojë e perceptimit të gabuar të marrëdhënies juridiko-civile të krijuar me kontratën nr. 2146, rep nr. 446 kol., datë 9.8.2005, me të cilën kanë kaluar të drejtat e kuotave dhe jo të truallit. Sipërfaqja 3176 m² është në pronësi të shoqërisë “TTC” sh.p.k. që në vitin 1993 dhe është provuar se është ndjekur procedura nga ortaku shtet për kalimin e saj në pronësi të asaj shoqërie me kapital të përbashkët. Procedura e përfshirjes së truallit në pronësi të kësaj të fundit nga pronari shtet nuk është kundërshtuar dhe nuk është bërë ndonjëherë pjesë e debatit gjyqësor.

19.4. Pretendimet për pavlefshmërinë absolute të pjeshme të kontratës nuk qëndrojnë, për më tepër që kërkuesja, në zgjidhjen e pasojave, nuk ka kërkuar detyrimin e Ministrisë së Ekonomisë të tjetërsojë këtë truall në favor të saj, por kthimin në gjendjen fillestare, pra në pronësi të shtetit. Pretendimi se në ZRPP-në, Tiranë është bërë regjistrimi i kësaj sipërfaqeje në pronësi të shoqërisë “TTC” sh.p.k. në vitin 2005, për rrjedhojë deri në këtë moment prona ka qenë në pronësi të shtetit, është i pabazuar, pasi momenti i kalimit të pronësisë lidhet jo me atë të regjistrimit të pronës, por të kryerjes së veprimit juridik, në rastin konkret kontrata për themelimin e

shoqërisë me kapital të përbashkët “TTC” sh.p.k. e vitit 1993.

19.5. Edhe pretendimi për cenimin e së drejtës së pronës është i pabazuar, pasi objekt gjykimi është konstatimi i pavlefshmërisë së kontratës së shitjes të kuotave të vitit 2005 dhe asnjë rrethanë apo ngjarje e ndodhur më vonë nuk mundet të ndryshojë vlefshmërinë ose pavlefshmërinë e veprimit juridik. Kolegji Civil është shprehur për mungesën e legjitimitetit të paditëses për të kërkuar pavlefshmërinë, pa mbajtur asnjë qëndrim në lidhje me vlefshmërinë e procedurës së legalizimit, apo me veprimin juridik të kalimit të pronësisë. Vlefshmëria e procedurës së legalizimit, e cila përbën një titull origjinal të fitimit të pronësisë, vlerësohet nga gjykata administrative, pra një gjykatë me kompetencë funksionale të ndryshme nga ajo civile. Gjithsesi, krijimi i rrethanave të mëpasshme, siç është legalizimi i objektit, nuk mund të përbëjë një premisë që të kufizojë apo kushtëzojë Kolegjin Civil në ushtrimin e funksionit të tij për të vlerësuar nga kjo perspektivë e re ligjshmërinë e vendimeve gjyqësore.

20. Subjekti i interesuar, Ministria e Financave, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

20.1. Pretendimi për cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj është i pabazuar, pasi funksioni i Gjykatës së Lartë lidhet me kontrollin e vendimmarrjes së gjykatave të faktit për zbatimin e ligjit material dhe procedural. Gjykata e Lartë nuk ka detyrim të marrë të mirëqenë vlerësimin e fakteve të bërë nga gjykata e apelit, pasi ajo kontrollon bazueshmërinë në ligj dhe interpretimin e bërë nga gjykatat e faktit, funksion të cilin e ka ushtruar edhe në rastin konkret.

20.2. Pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit është i pabazuar, pasi vetë kërkuesja ka parashtruar se ka pasur të drejtën e studimit të dosjes gjyqësore në Gjykatën e Lartë, për t’u njohur me materialet e saj, rrjedhimisht edhe me kërkesat e paraqitura nga palët në proces. Kërkuesja është njohur efektivisht me rekursin dhe përmbajtjen e tyre dhe nuk ka hasur në mungesë gatishmërie nga Gjykata e Lartë për t’i vënë në dispozicion materialet e dosjes gjyqësore. Bazuar në këto materiale kërkuesja ka paraqitur edhe memon drejtuar Kolegjit Civil, ku ka parashtruar pretendimet dhe argumentet e saj.

20.3. Edhe pretendimi për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* është i pabazuar, pasi



Kolegji Civil ka mbajtur parasysh të gjitha rrethanat, faktet dhe provat e administruara në gjykim, duke u dhënë përgjigje shteruese çështjeve të parashtruara përpara saj. Në përputhje me rolin e parashikuar nga ligji, Gjykata e Lartë ka tagrin të vlerësojë nëse vendimmarrja e gjykatave të faktit është rrjedhojë e një interpretimi të saktë apo të gabuar të ligjit, gjë të cilën e ka bërë edhe në rastin konkret.

21. Subjekti i interesuar, “Raiffeisen Bank”, sh.a., në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

21.1. Pretendimi për cenimin e *së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor* është i pabazuar, pasi kërkesja e ka ushtruar këtë të drejtë nëpërmjet paraqitjes së parashtrimeve në Gjykatën e Lartë. KPC-ja nuk parashikon dërgimin e memos ose parashtrimeve nga palët nëse gjykata nuk ka çmuar që çështja të gjykohet në seancë gjyqësore. Ankimi kushtetues përmban pretendime për statusin ligjor të pasurisë së paluajtshme objekt gjykimi, por ato nuk janë ngritur gjatë gjykimit të çështjes në gjykatat më të ulëta dhe nuk janë debatuar para gjykatës. Për më tepër, këto pretendime përbëjnë një padi të re që nuk ka lidhje me padinë e gjykuar në procesin e kundërshtuar. Në kërkesë paraqiten edhe pretendime për cenimin e të drejtave kushtetuese të shoqërisë “LTD&Co” sh.p.k., që nuk ka qenë palë në procesin gjyqësor, ndaj nuk gëzon të drejtat procedurale të palëve dhe nuk mund të ndërhyjë në procesin gjyqësor në Gjykatën e Lartë, për sa kohë nuk është legjitimuar nga gjykatat e faktit. Gjykata e Lartë nuk shqyrton themelin e padisë, por vetëm ligjin e zbatueshëm dhe vendimi i saj, si nga pikëpamja formale, ashtu edhe substanciale përmbush standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor.

22. Subjektet e interesuara, Avokatura e Shtetit, ASHK-ja, shoqëria “Fiduciaria Marche” s.r.l., shoqëria GPL-Costruzioni Generali” s.r.l. dhe shtetasi Luigi Fabri, nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse janë njoftuar rregullisht.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuar

23. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të

Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

24. Gjykata vëren se kërkesja legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

25. Për sa i përket legjitimitimit të kërkuarës në lidhje me pretendimin se vendimi i Gjykatës së Lartë ka cenuar standardin e arsytimit, pasi nuk ka parashtruar në pjesën e fakteve të çështjes veprime procedurale të rëndësishme siç është memoja e datës 1.3.2023 e depozituar nga një subjekt tjetër, konkretisht pronari i truallit objekt mosmarrëveshjeje, shoqëria “LTD&Co” sh.p.k., Gjykata vëren se, në kuptim të nenit 134, pika 2, të Kushtetutës, individ, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejta, si dhe të provojë se në ç’mënyrë ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese. Duke qenë se ky pretendim nuk lidhet me cenimin e drejtpërdrejtë të së drejtës kushtetuese të kërkuarës për proces të rregullt, por synon mbrojtjen e të drejtave të personave të tretë, kërkesja nuk legjitimohet për paraqitjen e tij, për sa kohë nuk provon të drejtën e saj të cenuar dhe interesin vetjak për mbrojtjen e asaj të drejte.

26. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkesja i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual, duke ngritur pretendime për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.



27. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar se ankimi kushtetues individual duhet të paraqitet në Gjykatë brenda 4 muajve nga konstatimi i cenimit. Në rastet e kundërshtimit të vendimeve gjyqësore, Gjykata, si rregull, e llogarit afatin ligjor 4-mujor nga data e shpalljes së vendimit gjyqësor të arsyetuar në prani të palës. Kur bëhet fjalë për vendime të Gjykatës së Lartë, si datë e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar është bërë i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij në rastin kur palët kanë lënë të dhënat elektronike të *kontaktit* (shih vendimin nr. 42, datë 19.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese).

28. Gjykata vëren se kërkesja i është drejtuar asaj me ankim kushtetues në datën 25.9.2023 për kundërshtimin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili mban datën 8.3.2023. Sipas kërkeses, ajo nuk është njoftuar për vendimin e Gjykatës së Lartë dhe është njohur me të në datën 30.5.2023, kur vendimi është publikuar i arsyetuar në faqen zyrtare të asaj gjykate. Për qëllime të këtij shqyrtimi, kërkesja ka paraqitur edhe shkresën nr. 3750/1 prot., datë 10.7.2023, të Gjykatës së Lartë, sipas së cilës vendimi është bërë i disponueshëm për palët në datën 30.5.2023. Në këtë kushte, Gjykata vlerëson se data e fillimit të afatit 4-mujor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual do të konsiderohet data 30.5.2023 kur kërkesja ka marrë dijeni efektivisht për vendimin e kundërshtuar dhe i është dhënë mundësia të njihet me shkaqet e tij. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkesja legjitimohet edhe *ratione temporis*.

29. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, kërkesja ka pretenduar se vendimi i Kolegjit Civil i ka cenuar të drejtën për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, të drejtën e aksesit substancial, si dhe të drejtën e pronës private. Lidhur me këtë të fundit, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se argumentet lidhen me procesin gjyqësor të kundërshtuar, çmon ta shqyrtojë atë në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë.

30. Për sa më lart, Gjykata do të analizojë në themel nëse procesi i zhvilluar nga Gjykata e Lartë,

e cila ka dhënë vendimin që kundërshtohet nga kërkesja, ka përmbushur standardet e procesit të rregullt të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës në këndvështrim të aksesit substancial, arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe gjykatës së caktuar me ligj.

B. Për themelin e pretendimeve

B. 1. Për cenimin e së drejtës së aksesit substancial

31. Kërkesja ka pretenduar se asaj nuk i janë njoftuar rekurset e palëve të paditura edhe pse adresa e saj dhe e mbrojtësit u janë komunikuar gjykatave të faktit dhe nuk janë ndryshuar asnjëherë. Sipas kërkeses, ajo është vënë në dijeni për përmbajtjen e rekurseve pas shpalljes së datës së zhvillimit të gjykimit dhe pas studimit të dosjes gjyqësore. Ajo ka pretenduar se Kolegji Civil ka shpërfillur dhe anashkaluar tërësisht pretendimet e paraqitura në memon e datës 27.2.2023, ku parashtroheshin prapësimet në lidhje me rekurset e palës tjetër në gjykim, duke mos iu përgjigjur argumenteve ligjore të kërkeses.

32. Sipas subjektit të interesuar, shoqërisë “AL.P.IN” sh.a., rekursi i është komunikuar rregullisht kërkeses në adresën e përcaktuar në kundërpadi dhe ajo është njoftuar për zhvillimin e seancës në dhomën e këshillimit, si dhe është informuar për të drejtën e paraqitjes së pretendimeve me shkrim. Sipas tij dhe sipas të dhënave të faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë është shpallur lista e seancave për t’u shqyrtuar në dhomën e këshillimit ku bënte pjesë edhe çështja e kërkeses, si dhe është bërë njoftimi në ambientet fizike, i administruar në dosjen gjyqësore. Sipas këtij subjekti, me memon e datës 27.2.2023 kërkesja ka paraqitur argumentet dhe aktet në mbështetje të pretendimeve të saj, ndërkohë që Gjykata e Lartë ka marrë në shqyrtim dhe ka vlerësuar pretendimet e palëve në proces, duke mos e vënë atë në pozitë të disfavorshme.

33. Subjekti i interesuar, Ministria e Financave, ka prapësuar se kërkesja ka pasur të drejtën e studimit të dosjes gjyqësore në Gjykatën e Lartë, për t’u njohur me materialet që përmban ajo, rrjedhimisht edhe me kërkesat e palëve në proces dhe mbi këto materiale ka paraqitur memon drejtuar Kolegjit Civil, ku ka parashtruar pretendimet dhe argumentet e veta.

34. Subjekti i interesuar, banka “Raiffeisen Bank” sh.a., ka prapësuar se kërkesja e ka ushtruar të drejtën e aksesit nëpërmjet paraqitjes së parashtrimeve në Gjykatën e Lartë dhe se KPC-ja



nuk parashikon paraqitjen e memos apo të parashtrimeve nëse çështja nuk gjykohet në seancë.

35. Neni 42, pika 1, i Kushtetutës parashikon se prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (*shih vendimet nr. 22, datë 29.4.2021; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se e drejta për t'u njoftuar dhe për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për procesin gjyqësor, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Në këtë kuptim, kjo e drejtë, ndër të tjera, i krijon një pale ndërgjyqëse të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr. 40, datë 14.9.2023; nr. 8, datë 23.2.2021; nr. 49, datë 22.7.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa i takon procesit në Gjykatën e Lartë, kjo e fundit, pavarësisht nëse i shqyrton çështjet në seancë të hapur publike ose mbi bazë të dokumenteve, ka detyrimin të verifikojë nëse palët në proces kanë marrë dijeni efektivisht për rekursin dhe procesin, me qëllim garantimin e së drejtës së mbrojtjes dhe parimit të barazisë së armëve në gjykim (*shih vendimin nr. 14, datë 21.3.2023, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata është shprehur, gjithashtu, se është detyrë e administratës gjyqësore të marrë masat për të kryer njoftimin e palëve ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 47, datë 6.7.2015; nr. 32, datë 22.7.2011; nr. 13, datë 4.3.2008, të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Në rastin në shqyrtim rezulton se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje mbi bazën e rekurseve të

paraqitura nga shoqëria "AL.P.IN" sh.a. dhe shoqëria "Fiduciaria Marche" s.r.l. (palë të paditura në procesin gjyqësor), si dhe Avokatura e Shtetit dhe banka "Raiffeisen Bank" sh.a. (persona të tretë në procesin gjyqësor). Referuar akteve të dosjes gjyqësore të administruar për nevojat e gjykimit kushtetues, rezulton se në dëftesën e komunikimit të rekursit të datës 15.10.2014, e cila i është drejtuar avokatit të kërkuësës, E.D., i cili e ka përfaqësuar atë gjatë gjykimit në shkallën e parë dhe në apel, është shënuar data e marrjes dijeni 28.10.2014 dhe shënimi "nuk e njoh", ndërsa në dëftesën e komunikimit të rekursit drejtuar kërkuësës rezulton shënimi i shërbimit postar "larguar". Në këto kushte, sekretaria gjyqësore e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 14.11.2014, bazuar në nenin 133 të KPC-së, ka kryer njoftimin me shpallje të rekurseve për kërkuësen, duke dërguar një kopje të tyre pranë selisë së saj dhe një kopje është afishuar në mjediset e gjykatës.

38. Gjithashtu, rezulton se në datën 1.2.2023 është vendosur shqyrtimi i çështjes në dhomën e këshillimit për në datën 1.3.2023 dhe është urdhëruar sekretaria e gjykatës të bëjë njoftimin e palëve sipas nenit 482, pika 2, të KPC-së. Në datën 15.2.2023, sipas të dhënave të faqes zyrtare të asaj Gjykate, është publikuar lista e çështjeve për shqyrtim në dhomën e këshillimit në datën 1.3.2023, ku përfshihej edhe çështja e kërkuësës, e cila është shpallur, sipas akteve të dosjes gjyqësore, edhe në ambientet fizike të asaj gjykate. Po referuar akteve të dosjes gjyqësore, rezulton se kërkuësja në datën 27.2.2023 ka paraqitur në Gjykatën e Lartë memo të nënshkruar nga avokati i saj, ku ka parashtruar prapësimet në lidhje me rekursin e palëve të paditura në proces. Në datën 1.3.2023 Kolegji Civil, pa dhënë arsye, ka vendosur shtyrjen e seancës pas disa ditësh dhe në datën 8.3.2023 çështja është shqyrtuar vetëm mbi bazën e rekurseve të paraqitura në dhomën e këshillimit. Në përfundim të shqyrtimit Kolegji Civil ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

39. Gjykata vëren se nenet 130 dhe 131 të KPC-së, sipas përmbajtjes së tyre në kohën e depozitimit të rekursit (datë 18.10.2014), parashikonin mënyrat dhe format e njoftimit të akteve palëve në proces, në bazë të të cilave njoftimi me shpallje publike bëhej vetëm kur dështonte njoftimi me shkresë ose kur ky



njoftim ishte i pamundur, si dhe kur marrësi nuk kishte caktuar një përfaqësues.

40. Gjykata, bazuar në faktet e rezultuara gjatë këtij gjykimi, konstaton se kërkuesja nuk është njoftuar për rekursin e paraqitura nga palët e tjera ndërgjyqëse në procesin gjyqësor as personalisht, as nëpërmjet përfaqësuesit të zgjedhur, çka e ka vënë atë në pamundësi që të paraqiste kundërrekurs për kundërshtimin e pretendimeve të palëve rekursuese. Gjykata konstaton, gjithashtu, se kërkuesja në gjykimin në gjykatën e shkallës së parë dhe në apel është përfaqësuar nga i njëjti avokat, E.D. Pavarësisht këtij fakti, sekretaria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në kushtet kur ka rezultuar se dëftesa e komunikimit të rekursit për kërkuesen është kthyer me shënimin “languar”, kurse për avokatin është kthyer me shënimin “nuk e njoh”, nuk ka ndjekur rregullat procedurale për të siguruar njoftimin e rekurseve, por është mjaftuar vetëm me mënyrën përjashtimore të njoftimit, atë me shpallje publike.

41. Lidhur me shkeljet procedurale, Gjykata ka theksuar se jo çdo shkelje e bën procesin të parregullt, në aspektin e cenimit të të drejtave kushtetuese, dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit (*shih vendimet nr. 71, datë 13.11.2017; nr. 30, datë 19.5.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjatë shqyrtimit të pretendimeve për të drejtën për proces të rregullt nuk mjafton vetëm konstatimi i shkeljes procedurale, por duhet të analizohet karakteri i saj, pasojat që kanë ardhur për kërkuesin dhe për interesat që ai përfaqëson (*shih vendimet nr. 5, datë 9.2.2023; nr. 38, datë 2.12.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër Gjykata thekson se e drejta për t'u njoftuar u paraprin të drejtave të tjera që garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor, përfshirë atë për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare.

42. Në kuptim të sa më sipër, pra të pasojave që i kanë ardhur kërkueses nga mosnjoftimi i rekurseve, Gjykata vlerëson se njoftimi i akteve me të cilat vihet në lëvizje një proces gjyqësor ka rëndësi në drejtëm të pjesëmarrjes së individit në gjykim dhe të realizimit të të drejtave të tij kushtetuese. Në vlerësimin e Gjykatës, njoftimi në kohën e duhur i akteve gjyqësore përbën një garanci të domosdoshme si për të vënë në dijeni individin për

procesin gjyqësor ku ai është palë, ashtu edhe për të garantuar pjesëmarrjen e tij në proces dhe ushtrimin e së drejtës së mbrojtjes dhe përdorimin e mjeteve procedurale në funksion të mbrojtjes së tij, siç është kundërrekursi apo prapësimet ndaj pretendimeve të palës tjetër në proces.

43. Gjykata vëren se kërkuesja nuk është njoftuar për rekursin e palëve të paditura, duke u vënë kështu në pamundësi objektive jo vetëm për të marrë dijeni për vënien në lëvizje të procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë, por edhe për të ushtruar të drejtat e saj që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës, pra për të paraqitur, përmes kundërrekursit ose parashtrimeve në proces, pretendime në mbrojtje të interesave të saj ligjorë e kushtetues. Edhe pse Gjykata e Lartë ka detyrimin të verifikojë, në këndvështrim të garantimit të së drejtës së mbrojtjes dhe parimit të barazisë së armëve, nëse administrata gjyqësore ka marrë masat për të kryer njoftimin e rekursit palëve ndërgjyqëse, ajo nuk është ndalur në kryerjen e këtij vlerësimi.

44. Gjykata e Lartë, edhe pse kërkuesja i ka sjellë në vëmendje me memon e datës 27.2.2023 se rekursin e palëve të paditura nuk i janë komunikuar, siç rezulton nga dëftesat e komunikimit të administruara në dosjen gjyqësore, ka vazhduar shqyrtimin e tyre pa evidentuar në vendim këto fakte. Po ashtu, ajo nuk ka evidentuar në vendim as pretendimet e parashtruara në këtë memo që lidhen me kundërshtimin e parashtrimeve të palëve rekursuese dhe as nuk i ka marrë në shqyrtim ato, duke mos u dhënë përgjigje përfundimtare dhe të arsyetuar atyre.

45. Gjykata vlerëson të theksojë se pavarësisht se në procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë kjo e fundit, përmes administratës gjyqësore, ka kryer njoftimin e datës së zhvillimit të seancës gjyqësore në përputhje me parashikimet procedurale të zbatueshme në atë gjykim, kjo nuk është e mjaftueshme për të korrigjuar dhe riparuar të metat e evidentuara në drejtëm të njoftimit të rekursit, të cilat kanë sjellë si pasojë humbjen nga ana e kërkueses të së drejtës për të paraqitur kundërrekurs dhe argumente ligjore në kundërshtim të pretendimeve të palëve kundërshtare, si dhe për të parashtruar qëndrimin dhe pretendimet e saj në lidhje me zgjidhjen e çështjes. Në kuptim të së drejtës së aksesit në aspektin substancial, mënyra se si kanë vepruar gjykatat në rastin konkret e kanë vënë kërkuesen në pamundësi të ushtrojë të drejtën



e saj të mbrojtjes ndaj shkaqeve të rekursit dhe në këtë mënyrë procesi nuk ka garantuar respektimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit. Për më tepër, që mungesa e njoftimit të rekursit nuk është riparuar nga Gjykata e Lartë, pasi ajo nuk ka marrë në konsideratë dhe nuk ka shqyrtuar parashtrimet dhe argumentet e sjella nga kërkuuesja nëpërmjet memos së datës 27.2.2023, e cila mbetej i vetmi mjet i mundshëm procedural për t'u përdorur prej saj. Gjithashtu, Gjykata evidenton se Kolegji Civil ka prishur vendimin e gjykatës së apelit që kishte vendosur në favor të kërkueses, duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë vetëm mbi bazën e shkaqeve të rekurseve të palëve të paditura.

46. Për sa më sipër, nga njëra anë, mosrespektimi i kërkesave procedurale për njoftimin e rekursit nga sekretaria gjyqësore e gjykatës së shkallës së parë dhe, nga ana tjetër, mosverifikimi dhe riparimi i këtyre shkeljeve nga Gjykata e Lartë, duke mos marrë në shqyrtim pretendimet e kërkueses të paraqitura në aktin "Memo" të datës 27.2.2023, përbën barrë të tepruar për kërkuesen në drejtim të së drejtës së aksesit efektiv në gjykatë. Këto mangësi në njoftimin e rekursit dhe pasojat që kanë sjellje ato konsiderohen, në vlerësimin e Gjykatës, si shkelje thelbësore që e bëjnë procesin të parregullt në kuptimin kushtetues, për sa kohë kanë pasur ndikim në të drejtën e aksesit të kërkueses, pra në të drejtën për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare në lidhje me pretendimet e saj, për rrjedhojë edhe në të drejtën për t'u dëgjuar në atë gjykatë në respektim të parimit të barazisë së armëve. Për sa më lart, Gjykata çmon se shkeljet e konstatuara kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, duke e bërë atë proces të parregullt në kuptimin kushtetues, ndaj pretendimi i kërkueses është i bazuar.

B.2. Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit

47. Kërkuuesja ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje argumenteve ligjore për pavlefshmërinë e kontratave të privatizimit në përputhje me standardet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese. Gjykata e Lartë, në ndryshim nga faktet e çështjes, ka arsyetuar se kërkuuesja nuk ka kërkuar tjetërsimin e trullit, por kthimin në gjendjen fillestare, pra në pronësi të shtetit. Edhe në aspektin formal vendimi i Kolegjit Civil nuk ka pasqyruar memon e datës 27.2.2023, si

dhe nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të parashtruara në të. Kolegji Civil ka arsyetuar dhe zgjidhur mosmarrëveshjen bazuar vetëm në një arsyetim të përciptë dhe të përgjithshëm, jo mbi zbatimin e ligjit, por mbi vlerësimin e fakteve, duke cenuar të drejtën e pronës.

48. Sipas subjektit të interesuar, shoqërisë "AL.P.IN" sh.a., vendimi i Kolegjit Civil ka sqaruar se objekti i marrëdhënies nuk është kalimi i të drejtave pronësore të trullit, por kalimi i kuotave që pronari shtet ka në shoqërinë "TTC" sh.p.k. dhe ka argumentuar se vlerësimi i trullit si aset i shoqërisë "TTC" sh.p.k. është bërë me qëllimin e vetëm për të përcaktuar çmimin e kuotës. Vendimi nuk rezulton të jetë alogjik, kontradiktor, i paqartë në përmbajtje dhe në vlerësimin e tij Kolegji Civil ka vlerësuar se pritshmëritë e paditëses nuk u përgjigjen kërtimeve të saj, të cilat janë rrjedhojë e perceptimit të gabuar të marrëdhënies juridiko-civile të krijuar me kontratën nr. 2146, rep. nr. 446 kol., datë 9.8.2005 me të cilën kanë kaluar të drejtat e kuotave dhe jo të trullit.

49. Subjekti i interesuar, Ministria e Financave, ka prapësuar se Gjykata e Lartë ka mbajtur parasysh të gjitha rrethanat, faktet dhe provat e administruara në gjykim, duke i dhënë përgjigje shteruese çështjeve të parashtruara përpara saj. Subjekti i interesuar, banka "Raiffeisen Bank" sh.a., nuk ka prapësuar në drejtim të pretendimit për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, por është shprehur se Gjykata e Lartë nuk shqyrton themelin e padisë, por vetëm zbatimin e ligjit dhe se vendimi i saj, si nga pikëpamja formale, ashtu edhe substanciale, përmbush standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

50. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 12, datë 28.2.2024; nr. 21, datë 26.9.2022; nr. 67, datë 10.11.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë, i qartë dhe jo kontradiktor në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes



tyre. Zbatimi i këtij standardi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 12, datë 28.2.2024; nr. 21, datë 26.9.2022; nr. 67, datë 10.11.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

51. Po ashtu, Gjykata ka pohuar se vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe që kjo të jetë e mundur duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive (*shih vendimin nr. 28, datë 22.5.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

52. Gjykata vëren se kërkesja ka ngritur padi në gjykatë me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të dy kontratave për shitjen e kuotave të shoqërisë tregtare (ku si pjesë e tyre është trajtuar edhe një truall), si dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme, me pretendimet se objekt i shitblerjeve ka qenë edhe trualli objekt padie, i cili nuk ishte në pronësi të shoqërisë “TTC” sh.p.k., ligji nuk lejonte shitblerjen e trojeve të huajve, shitja është bërë dukshëm nën vlerë dhe shitblerjet janë bërë nga një person juridik në likuidim. Po kështu, ajo ka kërkuar edhe fillimin e procedurës së privatizimit të truallit në fjalë.

53. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin e padisë me arsyetimin se kërkeses i mungonte legjitimiteti aktiv. Sipas asaj gjykate, trualli ka qenë pronë e shoqërisë “TTC” sh.p.k., si pjesë e kontributit të ortakut shtet, ndaj tjetërsimi i kuotave të shoqërisë nuk binte në kundërshtim me ligjin, duke theksuar se kontratat e shitjes kanë pasur në objektin e tyre kuotat dhe jo shitjen e pasurive, pra të truallit. Për këtë arsye, kërkesja nuk gëzonte të drejtën për të privatizuar truallin dhe, për rrjedhojë, as për të kundërshtuar kontratat e shitjes së kuotave.

54. Gjykata e apelit ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë ka gabuar në vlerësimin e provave dhe përcaktimin e fakteve, për rrjedhojë edhe në zbatimin e ligjit material, ndaj ka vendosur ndryshimin e vendimit. Sipas saj, trualli nuk ka qenë pronë e shoqërisë “TTC” sh.p.k., si pjesë e kontributit të ortakut shtet, ndaj tjetërsimi i kuotave të shoqërisë binte në kundërshtim me ligjin, duke theksuar se kontratat e shitjes së kuotave në fakt janë kontrata të shitjes së truallit. Me këtë arsyetim,

gjykata e apelit ka vlerësuar se trualli i është shitur një shoqërie të kundërshtim me ligjin. Po ashtu, shitja e truallit është bërë në shkelje të ligjit edhe për sa i përket vlerës së tij, përveçse i është shitur një shoqërie në likuidim. Lidhur me kërkimin për privatizimin e truallit, gjykata e apelit është shprehur në thelb se procedura duhet të fillojë nga organi publik pas konstatimit nga gjykata si absolutisht të pavlefshme të kontratave objekt padie dhe kthimit të truallit në pronësi të shtetit, duke theksuar se trualli duhej t'i privatizohej detyrimisht kërkuarës.

55. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke u ndalur vetëm në analizën e legjitimitetit të kërkuarës në dy aspekte, atë formal dhe substancial. Ai është shprehur se kërkesja ka legjitimitet formal për shkak se ka privatizuar një objekt shtetëror sipas legjislacionit në fuqi, i cili i jep të drejtën edhe për të privatizuar truallin e objektit. Megjithatë, sipas Kolegjit Civil, kërkesja nuk ka legjitimitet substancial, sepse trualli ka qenë pronë e shoqërisë “TTC” sh.p.k. që në krijimin e saj, përpara se kërkesja të privatizonte objektin dhe të kërkonte edhe privatizimin e truallit. Po ashtu, sipas Kolegjit Civil, dy kontratat e shitjes të kundërshtuara nga kërkesja kanë pasur në objektin e tyre kuotat e shoqërisë dhe jo truallin, ndaj pretendimet e kërkuarës për pavlefshmërinë absolute të tyre nuk janë të bazuara. Për më tepër, sipas Kolegjit Civil, kërkesja, përveç pavlefshmërisë absolute të kontratave të shitjes dhe kthimit të palëve në gjendjen e mëparshme, nuk ka kërkuar privatizimin e truallit në favor të saj, që do të mund të justifikonte interesin e saj në gjykim.

56. Në analizë të vendimeve gjyqësore, Gjykata vëren se të dyja gjykatat e faktit në vendimet e tyre kanë përcaktuar faktin se kërkesja i bazonte kërkimet e kërkesëpadisë në të drejtën e saj për të privatizuar truallin objekt konflikti. Gjykatat e faktit arritën në përfundime të kundërta lidhur me pyetjen nëse kërkesja kishte ose jo të drejtë të privatizonte truallin objekt konflikti. Konkretisht, gjykata e shkallës së parë u shpreh se kërkesja nuk e kishte këtë të drejtë, pasi trualli kishte kaluar në pronësi të një subjekti privat përpara se kërkesja të privatizonte objektin shtetëror, ndaj ajo nuk mund të kërkonte privatizimin e truallit. Ndërsa gjykata e apelit u shpreh se trualli ka qenë në pronësi të shtetit dhe jo të subjektit privat, dhe se kontratat e shitjes



së trullit ishin absolutisht të pavlefshme për disa shkaqe.

57. Pavarësisht se gjykatat e faktit mbajtën qëndrim diametralisht të kundërt për faktet dhe, për rrjedhojë, e zbatuan ligjin tërësisht ndryshe, Kolegji Civil u mjaftua në vendimin e tij me konfirmimin e qëndrimit të gjykatës së shkallës së parë, pa dhënë asnjë arsye se ku qëndronte gabimi ligjor i gjykatës së apelit në përcaktimin e fakteve dhe zbatimin e ligjit. Jo vetëm kaq, por Kolegji Civil ka parashtruar në vendimin e tij se kërkesja nuk ka kërkuar detyrimin e Ministrisë së Ekonomisë për tjetërsimin e trullit në favor të saj, me qëllim për të justifikuar ligjërisht mbrojtjen e interesit të saj, por kthimin në gjendjen fillestare, pra në pronësi të shtetit (*shih paragrafin 55 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Me anë të këtij arsyetimi, Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se kërkeses i mungonte interesi substancial dhe ka vendosur rrëzimin e padisë.

58. Për sa më sipër, Gjykata çmon se në rastin konkret Gjykata e Lartë, e ndodhur përpara dy zgjidhjeve diametralisht të kundërta, nuk ka përmbushur detyrën e saj në procedurën rishikuese të vendimeve të gjykatave të faktit. Në arsyetimin e vendimit të saj ajo nuk ka treguar me qartësi përse ka zgjedhur të konfirmojë përcaktimin e fakteve të gjykatës së shkallës së parë në raport me atë të gjykatës së apelit, duke mos evidentuar asnjë gabim ligjor në çmuarjen e provave nga kjo e fundit.

59. Po ashtu, vendimi i Gjykatës së Lartë përmban pasaktësi të dukshme në arsyetim, pasaktësi që duket se janë reflektuar më pas edhe në zbatimin e ligjit, të lidhura me mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Jo vetëm nga aktet në dosje, por edhe nga vendimmarrja e gjykatave të faktit rezulton qartësisht se kërkesja kishte kërkuar gjyqësisht të drejtën e privatizimit të trullit, fakt të cilin Gjykata e Lartë e ka mohuar shprehimisht në arsyetimin e saj. Për më tepër, edhe nëse një rrethanë e tillë do të ishte e vërtetë, referuar praktikës unifikuese të vetë Gjykatës së Lartë, ajo nuk mund të çonte në rrëzimin e padisë, por do të duhej që për këtë shkak gjykimi të ishte pushuar (*shih vendimin unifikues nr. 5, datë 30.10.2012, të Gjykatës së Lartë*). Prandaj, Gjykata çmon se vendimi i Gjykatës së Lartë në këtë drejtim paraqitet kontradiktor dhe arsyetimi i tij nuk është në koherencë me dispozitivin, i cili ka vendosur rrëzimin e padisë, duke cenuar unitetin e pjesëve të vendimit.

60. Për sa u takon argumenteve të kërkeses për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit të Gjykatës së Lartë, për shkak të mosevidentimit të memos së paraqitur nga kërkesja, Gjykata çmon se ato janë të bazuara, me të njëjtin arsyetim të dhënë gjatë vlerësimit të së drejtës për aksesin substancial (*shih paragrafin 46 të vendimit*). Në këtë pikë, Gjykata evidenton gjithashtu se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk i ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura nga kërkesja që në aktin fillestar të padisë, të cilat ishin parashtruar prej saj edhe në memon drejtuar Gjykatës së Lartë, që lidheshin me dy shkaqet e tjera të pavlefshmërisë absolute, konkretisht me shitjen nën vlerë të trullit dhe kryerjen e veprimeve juridike me një shoqëri tregtare në likuidim.

61. Në përmbledhje të arsyeve të mësipërme, Gjykata çmon se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk ka përmbushur standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit, si element thelbësor i vendimit të drejtë, pasi ka dështuar t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar rregullisht prej saj. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit është i bazuar.

62. Për sa i përket pretendimit tjetër të kërkeses për cenimin e së drejtës së gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, Gjykata vlerëson të mos ndalet në analizimin e tij, për sa kohë çështja do të merret përsëri në shqyrtim nga Gjykata e Lartë.

63. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkeses për cenimin e së drejtës së aksesit substancial dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor janë të bazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të vendimit, ndaj kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71, 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-882 (117), datë 8.3.2023, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.



3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 29.5.2024.

Shpallur më 9.7.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Genti Ibrahim, Marjana Semini

MENDIM PARALEL

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuases, shoqërisë “Ferlut” sh.a., me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-882 (117), datë 8.3.2023, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtuësishëm me Kushtetutën, edhe pse bashkohem me shumicën për pranimin e kërkesës, kam qëndrim të ndryshëm për shkaqet mbi të cilat është arritur në këtë përfundim, ndaj çmoj të shprehem me mendim paralel, sipas argumenteve në vijim.

2. Në mënyrë të përmbledhur, nga rrethanat e çështjes rezulton se kërkuësja është e paditur në një proces gjyqësor me objekt lirimin dhe dorëzimin e sendit (trualli), në të cilin ajo ka paraqitur kundërpadi me objekt pavlefshmërinë e kontratës së shitjes të kuotave shtetërore shoqërisë private (paditëse), regjistrimin e truallit në pronësi të shtetit dhe mundësinë e ushtrimit të parablerjes së tij. Pas pushimit të padisë, gjykata e shkallës së parë ka vijuar me gjykimin e kundërpadisë, duke e konsideruar atë si padi dhe në përfundim ka vendosur rrëzimin e saj, pasi kërkuases i mungonte legjitimiteti aktiv. Në ndryshim nga ky qëndrim, gjykata e apelit ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë, me argumentin se kërkuësja legjitimohej në kërkimet e saj dhe ka urdhëruar konstatimin e pavlefshmërisë së kontratës së shitjes të kuotave, regjistrimin e truallit në pronësi të shtetit dhe rrëzimin e padisë për pjesët e tjera.

3. Po kështu, nga rrethanat e çështjes rezulton se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje mbi bazën e rekurseve të subjekteve të interesuara. Nga përmbajtja e dosjes gjyqësore konstatohet se ato i janë komunikuar kërkuases (për të cilën nga shërbimi postar është shënuar “larguar”) dhe

përfaqësuesit të saj (për të cilin në dëftesën e komunikimit rezulton shënimi “nuk e njoh”). Për këto shkaqe, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka kryer njoftimin me shpallje të rekurseve për kërkuesen, duke dërguar një kopje të tij pranë selisë së saj dhe një kopje është afishuar në mjediset e gjykatës. Gjykata e Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

4. Në këto kushte, kërkuësja ka paraqitur ankim kushtetues individual, duke pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit substancial, standardit të arsytimit të vendimit dhe gjykatës së caktuar me ligj, si dhe të drejtën e pronës private, të cilat shumica i ka trajtuar në drejtim të së drejtës së aksesit substancial dhe të standardit të arsytimit të vendimit.

5. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës së aksesit substancial, shumica ka vlerësuar se duke mos u njoftuar për rekursin e paraqitura nga palët e tjera ndërgjyqëse as personalisht, as nëpërmjet përfaqësuesit të zgjedhur, kërkuësja është vënë në pamundësi që të paraqiste kundërrkurs për kundërshtimin e pretendimeve të palëve rekursuese dhe, rrjedhimisht, në pamundësi të ushtrojë të drejtën e saj të mbrojtjes ndaj shkaqeve të rekursit. Këto shkelje nuk janë verifikuar apo riparuar as nga Gjykata e Lartë (*shih paragrafët 35, 40 dhe 41 të vendimit*). Ndërsa për sa i përket pretendimit për cenimin e standardit të arsytimit shumica ka evidentuar se ndonëse në kushtet e dy vendimeve diametralisht të kundërta, Gjykata e Lartë nuk ka përmbushur detyrën e saj në procedurën rishikuese, pasi nuk ka treguar me qartësi se përse ka zgjedhur të konfirmojë përcaktimin e fakteve të gjykatës së shkallës së parë në raport me atë të gjykatës së apelit. Po kështu, vendimi i Gjykatës së Lartë paraqitet kontradiktor dhe përmban pasaktësi të dukshme në arsytim, pasaktësi të cilat duket se janë reflektuar më pas edhe në zbatimin e ligjit, lidhur me mënyrën e zgjidhjes së çështjes (*shih paragrafët 53-54*).

6. Nuk pajtohem me këtë mënyrë të trajtimit të pretendimeve të kërkuases, pasi çmoj se ankimi kushtetues individual duhej të ishte shqyrtuar në drejtim të pretendimit për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit të lidhur me të drejtën e aksesit substancial. Ndaj, në këtë drejtim, pajtohem me jurisprudencën e cituar nga shumica sipas së cilës e drejta për t'u njoftuar dhe për të marrë pjesë në



gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për procesin gjyqësor, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës (*shih vendimet nr. 40, datë 14.9.2023; nr. 8, datë 23.2.2021; nr. 49, datë 22.7.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 22, datë 29.4.2021; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Megjithatë, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, Gjykata ka pohuar se në zbatim të parimit të *subsidiaritetit*, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion për më tepër i Gjykatës së Lartë (*shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 6, datë 16.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas Gjykatës, është detyrë e Gjykatës së Lartë që, si gjykatë ligji, të arsyetojë, qoftë edhe minimalisht, në rastet kur pretendimet e ngritura në rekurs kanë të bëjnë me interpretimin e ligjit, veçanërisht kur interpretimi i ligjit lidhet me të drejta kushtetuese substanciale të individit (*shih vendimet nr. 29, datë 1.11.2022; nr. 19, datë 7.7.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Ndërkohë vetë Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimin nr. 30, datë 29.5.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Në rastin në shqyrtim, sikurse u theksua më lart, rezulton se pas komunikimit të rregullt të rekurseve kërkuar dhe përfaqësuesit të saj, duke qenë se ka qenë i pamundur njoftimi personal i tyre, gjykata e shkallës së parë ka kryer njoftimin me shpallje, sipas ligjit, duke përmbushur në këtë mënyrë detyrimet ligjore për njoftimin e palëve. Lidhur me mjetet e njoftimit, Gjykata në një rast, kur rekursi i është njoftuar pa sukses vetëm kërkuar, është shprehur se mosrespektimi i kërkesave procedurale për njoftimin e rekursit nga ana e gjykatës së shkallës së parë, përbën barrë të tepruar

për kërkuar në drejtim të së drejtës së tij për t'u njoftuar dhe për t'u mbrojtur efektivisht, për sa kohë kjo gjykatë nuk ka ndërmarrë hapa të mëtijshëm për njoftimin e aktit përfaqësuesit të tij, por është mjaftuar vetëm me mënyrën përjashtimore të njoftimit, atë me shpallje publike (*shih vendimin nr. 57, datë 9.11.2023, të Gjykatës Kushtetuese*). Ndërkohë ndryshe paraqitet situata në rastin konkret, kur njoftimi është kryer si për kërkuar, ashtu edhe për përfaqësuesin e saj. Pavarësisht këtij fakti, shumica ka arsyetuar se gjykata e shkallës së parë ka përdorur mjetin e fundit të komunikimit duke u mjaftuar vetëm me shpalljen publike, por nuk ka treguar se cilat do të ishin veprimet e tjera që mund të ndërmerre ajo gjykatë sipas ligjit të kohës.

9. Prandaj jam e mendimit se për rastin e kërkuar, gjykata e shkallës së parë ka kryer njoftimin e rekurseve rregullisht sipas parashikimeve ligjore. Gjithsesi, duke qenë se marrja dijeni efektive e akteve (rekurseve në rastin në shqyrtim) përbën garanci të domosdoshme për individin, për procesin gjyqësor ku ai është palë dhe nisur nga fakti se për kërkuar nuk është arritur njoftimi *personal* i tyre, vlerësoj se merr rëndësi marrja në konsideratë e prapësimeve të paraqitura prej saj me memon e datës 27.2.2023 përpara seancës së zhvilluar në këtë gjykatë. Ndërkohë, Gjykata e Lartë, sikurse pohon edhe shumica, nuk rezulton të ketë pasqyruar në vendimin e kundërshtuar këto prapësime të kërkuar.

10. Në këtë kuptim, Gjykata e Lartë, duke mos pasqyruar në vendimin e saj prapësimet e kërkuar ka krijuar dyshime në lidhje me marrjen në shqyrtim dhe vlerësimin e pretendimeve të saj. Shkaqet e paraqitura nga palët përbëjnë një element të rëndësishëm të përmbajtjes së vendimit gjyqësor, që tregon se Gjykata e Lartë i ka marrë parasysh pretendimet e tyre në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve. Për shkak se ky element nuk ka thjesht karakter formal në përmbajtjen e vendimit gjyqësor, jam e mendimit se Gjykata e Lartë nuk mund t'i anashkalonte ato. Prandaj, vlerësoj se ishte detyrë e Gjykatës së Lartë të merrte në shqyrtim prapësimet e kërkuar dhe t'u jepte përgjigje atyre, sepse vetëm nëpërmjet vlerësimit të shkaqeve të paraqitura në rekurs dhe prapësimeve të palëve ndërgjyqëse mund të justifikohet përfundimi i arritur në dispozitiv nga Gjykata e Lartë.



11. Thënë sa më lart, vlerësoj se shumica nuk duhej të kishte vijuar më tej me analizën e argumenteve të tjera në lidhje me pretendimet e paraqitura nga kërkuësja përderisa çështja do të kthehet për shqyrtim në Gjykatën e Lartë. Kjo e fundit, për pasojë, do të duhet të analizojë pretendimet e subjekteve të interesuara së bashku me ato të kërkuësës, në zbatim të parimit të kontradiktoritetit. Konkretisht, shumica e ka analizuar çështjen edhe nga pikëpamja ligjore, duke evidentuar se pasaktësitë e dukshme në arsyetimin e Gjykatës së Lartë janë reflektuar më pas edhe në zbatimin e ligjit, të lidhura me mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Sipas shumicës, rezulton qartësisht se kërkuësja kishte kërkuar gjyqësisht të drejtën e privatizimit të truallit, fakt të cilin Gjykata e Lartë e ka mohuar shprehimisht në arsyetimin e saj. Në këtë mënyrë, marrja në shqyrtim nga shumica e argumenteve të tjera të paraqitura nga kërkuësja, në thelb, i ka diktuar Gjykatës së Lartë mënyrën e zgjidhjes së çështjes, veçanërisht në kushtet kur shumica është shprehur, se: *“referuar praktikës unifikuese të vetë Gjykatës së Lartë, ajo nuk mund të çonte në rrëzimin e padisë, por do duhej që për këtë shkak, gjykimi të ishte pushuar”* (shih paragrafin 50 të vendimit).

12. Bazuar në këto konsiderata, duket se shumica jo vetëm ka marrë rolin e një gjykate të shkallës së katërt të juridiksionit të zakonshëm, por i ka mohuar kërkuësës të drejtën e shqyrtimit të çështjes në një shkallë gjykimi, e cila ka kompetencën dhe juridiksionin për ta realizuar atë. Një gjë e tillë nuk është atribut i kësaj Gjykate. Përkundër asaj çfarë ka qenë thelbi i shqyrtimit të çështjes të këtij ankimi kushtetues individual, duket se shumica ka shkuar përtej funksionit të kësaj Gjykate, duke marrë përsipër të vlerësojë dhe të arrijë në përfundime të cilat mund të ishin të ndryshme nëse Gjykata e Lartë do të merrte në shqyrtim edhe prapësimet e kërkuësës, në aspektin e garancive që ofron aksesit substancial në atë gjykatë.

13. Për më tepër, kjo qasje e shumicës bie në kundërshtim me jurisprudencën kushtetuese, e cila në mënyrë konstante, në rastet kur ka vlerësuar si të bazuar cenimin e së drejtës së aksesit substancial, si një prej elementeve të procesit të rregullt ligjor, ka çmuar të mos ndalet në analizimin e pretendimeve të tjera të kërkuësve, për sa kohë çështja do të merrej sërish në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, duke i lënë kësaj të fundit mundësinë për të shqyrtuar në tërësi çështjen në drejtim të respektimit të të drejtave

kushtetuese të individit (shih vendimet nr. 23, datë 25.4.2023; nr. 7, datë 21.2.2023; nr. 29, datë 1.11.2022; nr. 10, datë 12.4.2022; nr. 27, datë 27.3.2017; nr. 73, datë 16.12.2016, të Gjykatës Kushtetuese).

14. Në analizë të sa më sipër, çmoj se Gjykata duhej të shqyrtonte dhe pranonte pretendimin për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit të lidhur me të drejtën e aksesit substancial vetëm për shkak të mosparaqitjes në vendimin e kundërshtuar të prapësimeve të kërkuësës në lidhje me rekursin e subjekteve të interesuara. Ndërsa për sa u takonte argumenteve të tjera që kanë të bëjnë me këto pretendime, për sa kohë që çështja do të merret sërish në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, ato duhej t'i lireshin për analizë dhe vlerësim asaj gjykate. Në përfundim, vlerësoj se pretendimi i kërkuësës vetëm në këtë drejtim është i bazuar, ndaj kërkesa duhej të ishte pranuar.

Anëtar: Fiona Papajorgji

VENDIM **Nr. 44, datë 4.6.2024**

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË **SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Sandër Beci	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 4.6.2024, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 23 (E) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Eleonora Poga, Gjergji Shalësi, Petrika Shalësi, Sofiana Shakaj, Rozi Beqiri, Zaira Poga, përfaqësuar nga avokate Suela Mëneri, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Bashkia e Tiranës, përfaqësuar nga drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Licencimit, Alban Dokushi. Agjencia Shtetërore e Kadastrës,



Drejtoria Vendore, Tiranë jug, përfaqësuar nga drejtor Flladi Dano.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 8583, datë 22.7.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 2985, datë 30.9.2016, të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2023-2461, datë 8.6.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Shfuqizimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 342, datë 26.5.2005, “Për miratimin e listës së inventarit dhe transferimin e pronave të klubit të futbollit ‘Tirana’ në pronësi të Bashkisë Tiranë”, në pjesën ku disponohet për pasurinë truall me sipërfaqe 348 m², të regjistruar në regjistrin hipotekar nr. 6580, datë 23.9.1996, në pronësi të Stefan Poga, Evanthi Poga me nga 3/9-n pjesë dhe Elsa Poga, Sofiana Poga, Rozi Poga me nga 1/9-ën pjesë, që kufizohet Lindje parcela nr. 443, Perëndimi parcela nr. 439 e pjesërisht rruga “M. Gjollësia”, Veriu rrugë në projekt, Jugu parcela nr. 440.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, pika 2, 41, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “I” dhe 181 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 1, 6, pika 1 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe neni 1, i Protokollit nr. 1 të saj; nenet 31, 71, 71/a, 71/b dhe 76 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuësve, të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Bashkisë së Tiranës dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Jug (*ASHK*), që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuësit Eleonora Poga, Gjergji Shalësi, Petrika Shalësi, Sofiana Shakaj, Rozi Beqiri dhe

Zaira Poga janë trashëgimtarë të G.P., në favor të të cilit, si ish-pronar, është disponuar me vendimin nr. 98, datë 29.6.1995 (*vendimi nr. 98/1995*), të Komisionit të Kthimit e Kompensimit të Pronave pranë Bashkisë së Tiranës (*KKKP, Tiranë*). Me këtë vendim, bazuar në nenin 19, të ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, ish-pronarit G.P., trashëgimtarëve të tij ligjorë, u është njohur pronësia dhe kthyer si i lirë truall me sipërfaqe 348 m², një pjesë e të cilit ndodhej brenda aneksit të Stadiumit “Selman Stërmasi”, Tiranë. Ky vendim është regjistruar në regjistrat e kohës të zyrës së hipotekës, Tiranë (regjistrat hipotekarë), e cila ka lëshuar vërtetimin e pronësisë të datës 23.9.1996.

2. Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 342, datë 26.5.2005, “Për miratimin e listës së inventarit dhe transferimin e pronave të klubit të futbollit “Tirana” në pronësi të bashkisë Tiranë” (*VKM nr. 342/2005*), ndër të tjera, është vendosur miratimi i listës së inventarit të Stadiumit “Selman Stërmasi”, së bashku me aneksin dhe transferimi në pronësi të Bashkisë së Tiranës, sipas dokumentacionit, që i bashkëlidhet këtij vendimi, i përbërë nga formulari, planimetritë dhe planvendosjet. Në vijim, Bashkia e Tiranës i është drejtuar Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë (*ZVRPP, Tiranë*), për regjistrimin në regjistrat e pasurive të paluajtshme edhe të kësaj pasurie në pronësi të saj sipas VKM-së nr. 342/2005.

3. Në vitin 2008 kërkuësit i janë drejtuar ZVRPP-së, Tiranë për regjistrimin në regjistrat e pasurive të paluajtshme të pasurisë truall me sipërfaqe 348 m², sipas vendimit nr. 98/1995 të KKKP-së, Tiranë. Kjo kërkesë është trajtuar nga ZVRPP-ja, Tiranë, e cila ka përpiluar aktverifikimin e datës 10.11.2008, ku kërkuësve u bëhej e ditur se sipas planrilevimit të paraqitur, prona rezultonte brenda aneksit të stadiumit “Selman Stërmasi”, që ishte në emër të Bashkisë së Tiranës, ndërsa për sa i përkonte pjesës që binte jashtë aneksit, ata mund të pajiseshin me dokument pronësie, duke bërë një deklaratë noteriale ku të pranonin të pajiseshin për ato pjesë që nuk ishin në pronësi të Bashkisë së Tiranës. Në vijim, ZVRPP-ja, Tiranë, me shkresën e datës 23.1.2009, u ka kthyer përgjigje duke rikonfirmuar atë çka u ishte bërë e ditur me aktverifikimin e datës 10.11.2008. Në këtë rast, kërkuësve u është vënë në dispozicion dokumentacioni mbi të cilin pasuria ishte regjistruar në pronësi të Bashkisë së Tiranës.



4. Pas kësaj, kërkesit i janë drejtuar ZVRPP-së, Tiranë me kërkesë për fshirjen e regjistrimit të pasurive të paluajtshme të kryera në kundërshtim me ligjin dhe atyre që krijojnë mbivendosje me pasurinë me sipërfaqen prej 348 m² në pronësi të tyre. ZVRPP-ja, Tiranë, me shkresën nr. 24-R/1 prot., datë 6.9.2010, u ka kthyer përgjigje kërkesësve se kërkesa e tyre për fshirjen e regjistrimit të pasurisë në pronësi të Bashkisë së Tiranës ishte jashtë juridiksionit të saj referuar faktit se Gjykata Kushtetuese (*Gjykata*), me vendimin nr. 17, datë 23.4.2010, kishte shfuqizuar paragrafin e dytë dhe të tretë të nenit 10, të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” (*ligji nr. 7843/1994*) dhe të udhëzimit nr. 4, datë 21.11.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurën e fshirjes së regjistrimeve të kryera në kundërshtim me ligjin dhe atyre që krijojnë mbivendosje, në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.

5. Në datën 26.11.2010 kërkesit i janë drejtuar gjykatës me kërkesëpadi në objektin e së cilës kërkohej: i. konstatimi i pavlefshmërisë absolute të veprimeve juridike të kryera nga ZVRPP-ja, Tiranë për çregjistrimin dhe heqjen e titujve të pronësisë së trashëgimtarëve të ish-pronarit G.P. për truallin me sipërfaqe 348 m²; ii. konstatimin e pavlefshmërisë absolute të veprimeve juridike të regjistrimit dhe kalimit të pasurisë së paluajtshme të sipërpërmendur në pronësi të Bashkisë së Tiranës; iii. urdhërimin e ZVRPP-së, Tiranë të kthejë palët në gjendjen e mëparshme, duke fshirë regjistrimin e paligjshëm të bërë në favor të Bashkisë së Tiranës për truallin me sipërfaqe 348 m² dhe reregjistruar atë në pronësi të tyre, sikurse pasqyrohej në regjistrat hipotekarë. Sipas kërkesësve, veprimet e ZVRPP-së, Tiranë për çregjistrimin e pronës së tyre dhe regjistrimin e saj në pronësi të Bashkisë së Tiranës ishin veprime juridike absolutisht të pavlefshme, pasi vinin në kundërshtim të hapur me ligjin, ndërsa u kishin shkëlur të drejtën e pronësisë në kushtet kur zotëronin një vendim të KKKP-së, Tiranë, i cili nuk ishte kundërshtuar dhe është në fuqi.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 8583, datë 22.7.2013, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Ajo ka arsyetuar se vendimi nr. 98/1995 i KKKP-së, Tiranë, dhënë në favor të kërkesësve, është regjistruar në regjistrat e hipotekës. Nga ana tjetër, ZVRPP-ja, Tiranë, në përputhje me ligjin nr. 7843/1994, ka bërë regjistrimin në regjistrat e pasurive të paluajtshme të

një pasurie dhe mbi kërkesën e Bashkisë së Tiranës kjo e fundit është regjistruar si pronare bazuar në VKM-në nr. 342/2005, pra mbi bazën e një akti administrativ për fitimin e pronësisë. Pasuria e regjistruar në pronësi të Bashkisë së Tiranës në regjistrat e pasurive të paluajtshme përfshinte edhe një pjesë të truallit të njohur dhe kthyer kërkesësve me vendimin e KKKP-së, Tiranë por, sipas gjykatës, përpara se të kërkonin fshirjen e regjistrimit të bërë në zbatim të VKM-së nr. 342/2005, kërkesit duhej të kundërshtonin në gjykatë këtë akt administrativ, ku në mungesë të një kundërshtimi të tillë çdo pretendim për pavlefshmërinë e këtij akti nuk mund t'i nënshtrohej shqyrtimit gjyqësor. Kundër këtij vendimi kërkesit kanë paraqitur ankim në gjykatën e apelit.

7. Mbi ankimin e kërkesësve, ndërsa ka filluar funksionimi i gjykatave administrative dhe duke vlerësuar se mosmarrëveshja ishte e natyrës administrative, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 3463, datë 21.10.2014, ka shpallur moskompetencën e saj për gjykimin e çështjes dhe ia ka dërguar atë për kompetencë Gjykatës Administrative të Apelit. Ky vendim, pas rekursit të kërkesësve, është lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë.

8. Në vijim, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2985, datë 30.9.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke e gjetur të drejtë arsyetimin e saj. Edhe sipas gjykatës së apelit, përderisa akti mbi bazën e të cilit është regjistruar pronësia e Bashkisë së Tiranës (VKM-ja) për aneksin e stadiumit “Selman Stërmasi”, nuk është deklaruar ose konstatuar i pavlefshëm nga gjykata, për sa kohë kërkesit nuk e kanë kundërshtuar atë në gjykatë, me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se veprimet e ZVRPP-së, Tiranë për regjistrimin e kësaj pasurie janë të vlefshme dhe të kryera në përputhje me ligjin nr. 7843/1994. Ndaj këtij vendimi kërkesit kanë paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

9. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-2461, datë 8.6.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit me arsyetimin se ai nuk përmbante shkaqe nga ato të përcaktuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, datë 3.5.2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*).



10. Në datën 9.10.2023, kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual sipas objektit të kërkesës, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 20.10.2023. Në datën 20.12.2023, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

11. **Kërkuesit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se vendimet gjyqësore kanë cenuar:

11.1 *Të drejtën e pronës private*, pasi gjykatat kanë paragjykuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Kjo e drejtë është cenuar edhe nga VKM-ja nr. 342/2005, e cila ka disponuar për herë të dytë për një pronë që më herët u ishte njohur kërkuesve me vendimin nr. 98/1995, të KKKP-së, Tiranë. Gjykatat kishin për detyrë të hetonin nëse VKM-ja që ka disponuar për herë të dytë për pronën plotësonte kushtet e regjistrimit të saj. Gjykatat nuk kanë hetuar nëse veprimet e ZVRPP-së, Tiranë ishin në përputhje me parimin e përparësisë në regjistrim ose parimin e ndalimit të krijimit të mbivendosjeve. Edhe pse VKM-ja nr. 342/2005 nuk është kundërshtuar me padi të veçantë, gjykatat e zakonshme nuk kishin asnjë pengesë të hetonin për ligjshmërinë e saj.

11.2 *Parimin e barazisë së armëve*, pasi gjykatat u kanë dhënë përparësi argumenteve të palës së paditur, duke i pranuar ato si të bazuara në ligj e në prova. Gjithashtu, gjykatat nuk kanë hetuar nëse veprimet e ZVRPP-së, Tiranë ishin në përputhje me ligjin nr. 7843/1994 dhe Kodin e Procedurave Administrative (KPA) dhe as nuk kanë analizuar detyrimet konkrete të ZVRPP-së, Tiranë sipas të njëjtit ligj, me qëllim që të arrijnë në përfundimin se me cilat prej atyre detyrimeve ishin në përputhje veprimet e ZVRPP-së, Tiranë. Pra, gjykatat nuk kanë kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm, në përputhje me të drejtat e palëve në proces, për të vlerësuar nëse disponimi për pronën me VKM-në nr. 342/2005 ishte i ligjshëm.

11.3 *Standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe të drejtën e aksesit*, pasi kërkuesit nuk kanë marrë përgjigje nga gjykatat se mbi cilat parashikime të ligjit nr. 7843/1994 kanë bazuar vendimarrjet e tyre në lidhje me vlerësimin e veprimeve të kundërshtuara të ZVRPP-së, Tiranë për çregjistrimin e titullit të

pronësisë. Gjykatat nuk kanë dhënë arsye se në çfarë aspekti kundërshtimi i VKM-së nr. 342/2005, do të ishte një mjet më i përshtatshëm për mbrojtjen e së drejtës së pronës. Edhe Gjykata e Lartë me arsyetimin e saj ka paragjykuar shkaqet e rekursit, ndërkohë që kishte për detyrë të identifikonte se cilat ishin caqet e kompetencave të gjykatave më të ulëta në gjykimin e çështjes konkrete dhe t'i ballafaqonte ato me shkaqet e ngritura në rekurs. Gjykata e Lartë nuk ka identifikuar dhe korrigjuar mangësitë e gjykatave më të ulëta.

11.4 *Të drejtën për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm*, pasi procesi gjyqësor i kundërshtuar ka zgjatur rreth 13 vjet dhe për këtë arsye kërkuesit janë kufizuar në gëzimin e pronës së tyre.

12. **Subjekti i interesuar, Bashkia e Tiranës**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

12.1 Pretendimet e kërkuesve për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të cenimit të së drejtës së pronës, parimit të barazisë së armëve dhe standardit të arsyetimit nuk duhen pranuar nga Gjykata, për shkak se nuk janë ngritur më parë në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë. Gjithashtu, argumentet e paraqitura nga kërkuesit kanë të bëjnë me interpretimin e dispozitave të ligjit nr. 7843/1994 dhe, si të tilla, nuk bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, pasi nuk përmbajnë asnjë element që mund të çojë në antikushtetutshmërinë e vendimeve gjyqësore të kundërshtuara.

12.2 Gjykatat kanë dhënë arsyet ligjore në drejtim të pretendimeve të kërkuesve në proces, duke arritur në përfundimin se akti mbi bazën e të cilit është regjistruar prona (VKM-ja nr. 342/2005) nuk është deklaruar ose konstatuar i pavlefshëm nga gjykata dhe veprimet e ZVRPP-së, Tiranë për regjistrimin e kësaj pasurie janë të vlefshme dhe të realizuara në zbatim të nenit 38, të ligjit nr. 7843/1994 dhe nenit 193, shkronja “dh”, të Kodit Civil (KC).

12.3 Kërkuesit nuk legjitimohen për të kundërshtuar VKM-në nr. 342/2005, pasi ajo nuk bën pjesë në juridiksionin kushtetues, për shkak se nuk është akt me karakter normativ, por individual. Subjektet e tij janë individualisht të përcaktuara, ajo nuk ka si objekt vendosjen rregullave të përgjithshme të sjelljes, por rregullon një marrëdhënie juridike konkrete, kalimin e pronësisë mbi një send të paluajtshëm, qartësisht të identifikuar. Gjithashtu, VKM-ja nr. 342/2005 shteron në zbatimin e saj, sepse disponon specifikisht për një pronë të individualizuar dhe pas



transferimit të kësaj të fundit nuk zbatohet për asnjë marrëdhënie tjetër juridike dhe as për raste të ngjashme.

12.4 Kërkuesit nuk kanë sjellë asnjë argument kushtetues për shfuqizimin e VKM-së nr. 342/2005, nga i cili të arrihet në përfundimin e cenimit të të drejtave të tyre kushtetuese. Edhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë konstatuar se kërkuesit nuk kanë kërkuar kundërshtimin e këtij akti dhe, për këtë arsye, nuk është vënë në diskutim vlefshmëria e tij. Kërkuesit i kanë pasur të gjitha mundësitë për ta kundërshtuar VKM-në nr. 342/2005, por nuk e kanë bërë një gjë të tillë, duke mos shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion.

13. Subjekti i interesuar, ASHK-ja, ka prapësuar mbi të njëjtat argumente si subjekti tjetër i interesuar, Bashkia e Tiranës.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesve

14. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71, të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

15. Në këtë këndvështrim, kërkuesit, si individë, legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “P”, të pikës 1, të nenit 131 dhe shkronjës “I”, të pikës 1, të nenit 134 të Kushtetutës, pasi janë palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë kanë interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

16. Në lidhje me kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive, Gjykata ka theksuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka një funksion përfundimtar,

që do të thotë se mund të aplikohet vetëm në lidhje me vendime për të cilat kanë marrë fund procedurat gjyqësore. Kontrolli i ushtruar nga Gjykata është një kontroll subsidiar, që do të thotë se individit duhet t’i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Shterimi nënkupton se kërkuesi duhet t’i shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara të shkelura. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 12, datë 9.3.2021; nr. 17, datë 16.5.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Ky rregull nënkupton jo vetëm që individit t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 12, datë 9.3.2021; nr. 8, datë 19.3.2018; nr. 31, datë 25.5.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Për sa më lart, Gjykata vëren se kërkuesit në objektin e ankimit kushtetues individual kanë kundërshtuar, përveç vendimeve gjyqësore, edhe VKM-në nr. 342/2005, me të cilën stadiumi “Selman Stërmasi” së bashku me aneksin e tij janë transferuar në pronësi të Bashkisë së Tiranës. Ky akt administrativ individual nuk rezulton të ketë qenë objekt i gjykimeve të kundërshtuara nga kërkuesit, ndërkohë që ai është kundërshtuar për herë të parë në ankimin kushtetues individual. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se kërkuesit nuk kanë shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion për kundërshtimin e VKM-së nr. 342/2005, ndaj pretendimet e tyre në këtë drejtim nuk mund të merren në shqyrtim.

18. Në lidhje me pretendimin tjetër të kërkuesve për konstatimin e cenimit të së drejtës për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshem, në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se, si rregull, shqyrtimi i këtyre lloj çështjesh, pas hyrjes në fuqi të instrumentit për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshem, përshejtimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit, sipas neneve 399/1 - 399/12 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), duhet të bëhet nga gjykatat e zakonshme, sipas kompetencës që parashikon KPC-ja, në përputhje me parimin e subsidiaritetit (*shih vendimet nr. 3, datë 17.2.2022; nr. 2, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Gjykata konstaton se edhe këtë pretendim



kërkuesit e kanë parashtruar për herë të parë në ankimin kushtetues individual. Ata nuk rezulton të kenë bërë asnjë përpjekje dhe nuk kanë përdorur asnjë nga instrumentet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi (*nenet 399/1 e vijues të KPC-së*) për të kërkuar konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të gjykimit në gjykatat e zakonshme. Për rrjedhojë, edhe për këtë pretendim, Gjykata vlerëson se kërkuesit nuk kanë shteruar mjetet juridike në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës.

19. Për sa u përket pretendimeve të tjera të ngritura në ankimin kushtetues individual, që kanë të bëjnë me cenimin e së drejtës së pronës private dhe asaj për proces të rregullt në drejtim të parimit të barazisë së armëve, standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe së drejtës së aksesit, Gjykata vëren se kërkuesit i janë drejtuar asaj me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi kanë shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Gjithashtu, Gjykata konstaton se kërkuesit kanë ngritur pretendime edhe për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk kanë mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tyre kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual. Për rrjedhojë, në lidhje me këto pretendime, konsiderohet se plotësohet kriteri i shterimit të mjeteve juridike efektive, ndaj pretendimi i subjekteve të interesuara, Bashkisë së Tiranës dhe ASHK-së, për mosplotësimin e këtij kriteri, është i pabazuar.

20. Gjykata vëren se kërkuesit legjitimohen edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, mban datën 8.6.2023, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 9.10.2023 (ditë e hënë), pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

21. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata konstaton se në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të barazisë së armëve kërkuesit kanë argumentuar se gjykatat u kanë dhënë përparësi argumenteve të palës së paditur, duke i pranuar ato si të bazuara në ligj e në prova dhe nuk kanë hetuar nëse veprimet e ZVRPP-së, Tiranë, të kundërshtuara prej tyre, ishin në përputhje me ligjin

nr. 7843/1994 dhe me KPA-në. Sipas kërkuesve, gjykatat nuk kanë analizuar detyrimet konkrete të ZVRPP-së, Tiranë sipas ligjit nr. 7843/1994, me qëllim që të arrinin në përfundimin se me cilat prej tyre ishin në përputhje veprimet e ZVRPP-së, Tiranë. Po në mbështetje të këtij pretendimi kërkuesit kanë argumentuar se gjykatat nuk kanë kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm, në përputhje me të drejtat e palëve në proces, nëse disponimi për pronën e tyre me VKM-në nr. 342/2005 ishte i ligjshëm.

22. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit, kurse problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues, nëse nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave. Mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim përpara tyre nuk përbën lëndë kushtetuese. Çështjet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, të cilat hyjnë në juridiksionin e gjykatave të zakonshme, mund të merren në konsideratë në gjykimin kushtetues vetëm nëse cenohen të drejta ose liri kushtetuese themelore. Në këto raste, Gjykata bën një vlerësim të natyrës kushtetuese, që dallon nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 24, datë 9.4.2024; nr. 38, datë 2.12.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Për sa më sipër, referuar argumenteve të paraqitura nga kërkuesit në mbështetje të pretendimit për cenimin e parimit të barazisë së armëve, Gjykata konstaton se ato, në thelb, kanë të bëjnë me çështje të vlerësimit dhe analizës së provave dhe interpretimit e zbatimit të ligjit dhe, si të tilla, nuk bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues. Nga ana tjetër, kërkuesit nuk rezulton të kenë provuar se në çfarë mënyre janë vendosur në pozitë jo të favorshme me palën tjetër, duke e mbështetur pretendimin vetëm në mënyrën e zgjidhjes së çështjes nga gjykatat e zakonshme. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim prej saj.

24. Në lidhje me pretendimet e tjera të kërkuesve, për të përcaktuar nëse atyre u është cenuar e drejta e pronës, Gjykata vlerëson të analizojë në themel nëse procesi i zhvilluar nga gjykatat administrative, të cilat kanë dhënë vendimet që kundërshtohen prej



kërkuesve, kanë përmbushur standardet e procesit të rregullt në këndvështrim të së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

25. Kërkuesit kanë pretenduar se nuk kanë marrë përgjigje nga gjykatat se mbi cilat parashikime të ligjit nr. 7843/1994 kanë bazuar vendimmarrjet e tyre në lidhje me vlerësimin e veprimeve të kundërshtuara të ZVRPP-së, Tiranë për çregjistrimin e titullit të pronësisë. Sipas kërkuesve, gjykatat nuk kanë dhanë arsye se në çfarë aspekti kundërshtimi i VKM-së nr. 342/2005 do të ishte një mjet më i përshtatshëm për mbrojtjen e së drejtës së pronës. Gjithashtu, kërkuesit kanë pretenduar se edhe Gjykata e Lartë me arsytimin e saj ka paragjykuar shkaqet e rekursit, ndërkohë që kishte për detyrë të identifikonte se cilat ishin caqet e kompetencave të gjykatave më të ulëta në gjykimin e çështjes konkrete dhe t'i ballafaqonte ato me shkaqet e ngritura në rekurs. Sipas kërkuesve, Gjykata e Lartë nuk ka identifikuar dhe korrigjuar mangësitë e gjykatave më të ulëta.

26. Subjektet e interesuara kanë prapësuar duke argumentuar se gjykatat kanë dhënë arsyet ligjore në drejtim të pretendimeve të kërkuesve në proces, duke arritur në përfundimin se akti mbi bazën e të cilit është regjistruar prona nuk është deklaruar ose konstatuar i pavlefshëm nga gjykata dhe veprimet e ZVRPP-së, Tiranë për regjistrimin e saj janë të vlefshme dhe të realizuara në zbatim të nenit 38, të ligjit nr. 7843/1994 dhe nenit 193, shkronja “dh”, të KC-së.

27. Në jurisprudencën e saj Gjykata e ka vlerësuar të drejtën e aksesit si një të drejtë të individit jo vetëm për të filluar një proces, por edhe për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (*shih vendimet nr. 11, datë 21.4.2022; nr. 52, datë 14.11.2014, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, e drejta për të pasur akses në gjykatë i garanton individit të drejtën për t'i u drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj, të arsyetuar, për pretendimet e ngritura (*shih vendimet nr.*

11, datë 21.4.2022; nr.17, datë 24.3.2014, të Gjykatës Kushtetuese).

28. Po kështu, Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga neni 42 i Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, i cili përkon edhe me detyrimin e gjykatave për të arsyetuar vendimet, sipas nenit 142, pika 1, të Kushtetutës. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 42, datë 19.9.2023; nr. 10, datë 4.3.2021; nr. 18, datë 15.3.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Ndërsa në lidhje me vendimet e mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë, Gjykata ka theksuar se ato mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 10, datë 7.3.2023; nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 21, datë 16.4.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Nën dritën e garancive të parashikuara nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, Gjykata çmon të analizojë nëse këto garanci janë vlerësuar e zbatuar drejt në rastin konkret nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, vendimet e të cilave janë kundërshtuar nga kërkuesit, pra nëse ato kanë analizuar dhe vlerësuar pretendimet në lidhje me objektin e padisë dhe nëse u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të tyre.

30. Referuar akteve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi kushtetues, rezulton se kërkuesit kanë vënë në lëvizje një proces gjyqësor, duke kërkuar zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje të natyrës administrative, në themel të së cilës kanë qenë pretendimet e tyre në lidhje me ligjshmërinë e veprimeve të ZVRPP-së, Tiranë, e cila, sipas kërkuesve, ka çregjistruar titullin e tyre të pronësisë për pasurinë truall me sipërfaqe 348 m² dhe e ka regjistruar këtë pasuri në pronësi të Bashkisë së Tiranës. Në lidhje me këtë mosmarrëveshje, gjykatat e faktit kanë pranuar se titulli i pronësisë së kërkuesve, vendimi nr. 98/1995 i KKKP-së, Tiranë, është regjistruar në regjistrat hipotekarë, ndërsa veprimet e ZVRPP-së, Tiranë për regjistrimin e pasurisë në pronësi të Bashkisë së Tiranës janë bërë në regjistrat e pasurive të



paluajtshme, mbështetur në ligjin nr. 7843/1994. Ato kanë vlerësuar se veprimet e ZVRPP-së, Tiranë janë bërë në përputhje me ligjin, ndërsa me kërkesë të Bashkisë së Tiranës, kjo e fundit është regjistruar si pronare e pasurisë mbi bazën e një akti për fitimin e pronësisë, siç është VKM-ja nr. 342/2005. Po sipas gjykatave, cenimi i pretenduar i së drejtës së pronësisë për kërkuesin nuk vinte nga veprimi i regjistrimit të pasurisë në pronësi të Bashkisë së Tiranës, por nga VKM-ja nr. 342/2005, akt administrativ të cilin kërkuesit nuk e kanë kundërshtuar në gjykatë përmes mjeteve përkatëse ligjore, çka, sipas gjykatave, pamundëson shqyrtimin e vlefshmërisë së këtij akti brenda objektit të mosmarrëveshjes së parashtruar nga ata. Mbi këtë arsyetim, gjykatat e faktit kanë rrëzuar padinë e kërkuesve, ndërsa Gjykata e Lartë ka vlerësuar se rekursi i paraqitur nga ata nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga ligji, duke vendosur mospranimin e tij.

31. Për sa më lart, Gjykata konstaton se në rastin konkret gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë analizuar dhe vlerësuar pretendimet e ngritura nga kërkuesit për objektin e padisë, konkretisht për veprimet e kryera nga ZVRPP-ja, Tiranë për regjistrimin e pronës në emër të Bashkisë së Tiranës, duke u dhënë përgjigje të arsyetuar atyre dhe duke garantuar kështu të drejtën e aksesit substancial të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës. Gjithashtu, Gjykata vëren se, sikurse kanë arsyetuar gjykatat e zakonshme, kërkuesit nuk e kanë kundërshtuar më parë në rrugë gjyqësore ligjshmërinë e VKM-së nr. 342/2005.

32. Po kështu, Gjykata vëren se vendimet e gjykatave të faktit tregojnë mjaftueshëm rrethanat e çështjes, faktet e pranuar dhe përfundimet e nxjerra prej tyre, si dhe dispozitat ligjore në të cilat ato janë bazuar për zgjidhjen e çështjes në atë mënyrë, duke përmbushur detyrimin e tyre sipas nenit 142, pika 1, të Kushtetutës për arsyetimin e vendimeve gjyqësore. Në vlerësimin e Gjykatës, në rastin konkret, edhe vendimi i Kolegjit Administrativ, i marrë në dhomën e këshillimit, nuk cenon të drejtën e aksesit substancial dhe standardin e arsyetimit të vendimit. Ai tregon vendimarrjen e gjykatave më të ulëta, shkaqet e ngritura në rekurs, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese ku mbështetet qëndrimi i shprehur në dispozitiv. Përmes parashtrimit të shkaqeve të rekursit në vendimin gjyqësor të kundërshtuar, Kolegji Administrativ

tregon se pasi i ka vlerësuar ato, ka arritur në përfundimin se rekursi i paraqitur nga kërkuesit është haptazi i pabazuar, pasi shkaqet e ngritura në të nuk gjenin mbështetje në nenin 58, të ligjit nr. 49/2012. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesve për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk është i bazuar.

33. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesve për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi është i pabazuar, ndaj kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71, 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 4.6.2024.

Shpallur, më 9.7.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Ilir Toska, Sonila Bejtja, Elsa Toska

Anëtarë kundër: Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Marjana Semini, Genti Ibrahim

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes së vënë në lëvizje nga Eleonora Poga, Gjergji Shalësi, Petrika Shalësi, Sofiana Shakaj, Rozi Beqiri, Zaira Poga, me objekt shfuqizimin e vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykatës Administrative të Apelit dhe Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën, jemi kundër vendimit të shumicës, pasi vlerësojmë se kërkesa duhej të ishte pranuar. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe



nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, parashatrojmë në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin kundër.

2. Në vitin 1995 kërkuësve u është njohur e drejta e pronësisë dhe u është kthyer një truall prej 348 m² në Tiranë, me vendim përfundimtar të KKKP-së, bazuar në ligjin për kthimin dhe kompensimin e pronës. Vendimi i KKKP-së është regjistruar në regjistrat publikë të kohës dhe kërkuësit janë pajisur me vërtetimin e pronësisë të datës 23.9.1996.

3. Pas 10 vjetësh, Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 342, datë 26.5.2005 (*VKM nr. 342/2005*), ka vendosur t'i kalojë në pronësi Bashkisë Tiranë pronat e klubit të futbollit "Tirana", midis të cilave bënte pjesë edhe stadiumi "Selman Stërmasi" dhe aneksi i tij. Në këtë të fundit përfshihej edhe sipërfaqja prej 260.3 m² nga trualli i kërkuësve.

4. Në vitin 2008, gjatë procesit të regjistrimit fillestar të të gjitha pronave, ZVRPP-ja, Tiranë ka refuzuar të regjistrojë truallin në emër të kërkuësve, duke iu përgjigjur atyre se një pjesë e tij (260.3 m²) ndodhej brenda anekseve të stadiumit "Selman Stërmasi", i cili, bazuar në VKM-në nr. 342/2005, ishte regjistruar në emër të Bashkisë Tiranë dhe se për t'u pajisur me vërtetim pronësie për pjesën tjetër të truallit (87.7 m²), kërkuësit duhet të paraqitnin një deklaratë për heqjen dorë nga pjesa brenda aneksit të stadiumit, së bashku me planin e rlevimit. Në vitin 2010 kërkuësit i janë drejtuar përsëri ZVRPP-së, Tiranë për fshirjen e regjistrimit të pronës së tyre në emër të Bashkisë Tiranë, por edhe kjo kërkesë është refuzuar.

5. Në vijim, kërkuësit i janë drejtuar rrugës gjyqësore, duke kërkuar pavlefshmërinë absolute të veprimeve juridike të kryera nga ZVRPP-ja, Tiranë për çregjistrimin dhe heqjen e titujve të tyre të pronësisë, konstatimin e pavlefshmërisë absolute të veprimeve juridike të regjistrimit dhe kalimit në pronësi të Bashkisë Tiranë, si dhe urdhërimin e ZVRPP-së, Tiranë të kthejë palët në gjendjen e mëparshme.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në vitin 2013 ka vendosur rrëzimin e padisë, duke arsyetuar se VKM-ja nr. 342/2005 nuk ishte kundërshtuar nga kërkuësit, ndaj veprimet e ZVRPP-së të bazuara në atë VKM ishin të vlefshme dhe të kryera në zbatim të legjislacionit në fuqi. Sipas asaj gjykate, kërkuësit

fillimisht duhet të kundërshtonin VKM-në nr. 342/2005, pastaj të kërkonin fshirjen e regjistrimeve të bëra në zbatim të saj. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë është lënë në fuqi në vitin 2016 nga gjykata e apelit me të njëjtin arsyetim, ndërsa Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në vitin 2023 ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuësve.

7. Ndaj vendimeve gjyqësore të mësipërme kërkuësit kanë paraqitur ankim kushtetues individual, duke pretenduar se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë zhvilluar një proces jo të rregullt, duke cenuar të drejtën e aksesit dhe standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, të garantuara nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, si dhe të drejtën e pronës private, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës. Kërkuësit kanë pretenduar se gjykatat kishin për detyrë të hetonin nëse VKM-ja që ka disponuar për herë të dytë për pronën plotësonte kushtet e regjistrimit të saj dhe se ato (gjykatat) duhet të hetonin kryesisht për ligjshmërinë e VKM-së, për shkak se ajo ka disponuar për një pasuri e cila ishte shkëputur nga fondi shtetëror i pronës me vendimin e KKKP-së. Sipas kërkuësve, gjykatat nuk u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të tyre.

8. Pretendimet e kërkuësve janë analizuar nga shumica në këndvështrim të së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor dhe në përfundim janë vlerësuar të pabazuara. Sipas shumicës, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë analizuar dhe vlerësuar pretendimet e ngritura nga kërkuësit në lidhje me objektin e padisë, konkretisht me veprimet e kryera nga ZVRPP-ja, Tiranë për regjistrimin e pronës në emër të Bashkisë Tiranë, duke u dhënë përgjigje të arsyetuar atyre, si dhe duke garantuar të drejtën e aksesit substancial të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës. Edhe në vlerësimin e shumicës, ashtu sikurse kanë arsyetuar gjykatat e zakonshme, kërkuësit nuk e kanë kundërshtuar më parë në rrugë gjyqësore ligjshmërinë e VKM-së nr. 342/2005. Në përfundim, shumica ka vlerësuar se vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të kundërshtuara nga kërkuësit përmbushin edhe standardin e arsytimit (*shih paragrafët 31-32 të vendimit*).

9. Në ndryshim nga shumica, ne, gjyqtarët në pakicë, çmojmë se pretendimet e kërkuësve për cenimin e së drejtës së pronës, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, si rezultat i cenimit të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të



vendimit gjyqësor, të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, janë të bazuara. Në nxjerrjen e këtij konkluzioni mbajmë në konsideratë se neni 41 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se e drejta e pronës private është e garantuar (*pika 1*) dhe se shpronësimet ose ato kufizime të së drejtës së pronës që barazohen me shpronësimin, lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë (*pika 4*). Ndërsa neni 42 i Kushtetutës garanton shprehimisht procesin e rregullt ligjor për të drejtën e pronës, duke u shprehur, ndër të tjera, se prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë.

10. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se garantimi i së drejtës së pronës përbën një ndër aspektet më thelbësore të shoqërisë demokratike. E drejta e pronës përfshin çdo posedim të sendeve ose të të drejtave të tjera materiale pasurore dhe në një shtet demokratik individit duhet t'i garantohet gëzimi i qetë dhe pa pengesa të paarsyeshme ose joproporcionale i kësaj të drejte. Kjo e drejtë shtrihet ndaj sendeve, pronësia e të cilave është fituar në përputhje me ligjin (*shih vendimet nr. 53 datë 31.10.2023; nr. 36, datë 21.4.2017; nr. 25, datë 28.4.2014, të Gjykatës Kushtetuese*). Kufizimi i ushtrimit të lirë të së drejtës së pronës, kur ngjason me një shpronësim *de facto* pa shpërblim në kuptim të nenit 41 të Kushtetutës, cenon thelbin e kësaj të drejte kushtetuese, duke e bërë iluzive atë (*shih vendimin nr. 53, datë 31.10.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Ndërsa lidhur me të drejtën e aksesit, Gjykata ka vënë në dukje se ajo nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 24, datë 9.4.2024; nr. 32, datë 3.11.2022; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas Gjykatës, e drejta për proces të rregullt përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë dhe funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë që ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 9, datë 23.2.2023; nr. 2, datë 26.1.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjithashtu, Gjykata ka theksuar se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Kur në rekurs janë ngritur pretendime me natyrë kushtetuese që lidhen me liritë dhe të drejtat themelore dhe kërkuesi nuk ka marrë përgjigje për to, për shkak të vendimit të mospranimit të rekursit, kjo përbën cenim të së drejtës themelore për proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 17, datë 13.3.2024; nr. 45, datë 3.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Duke zbatuar standardet e mësipërme në çështjen konkrete, konstatojmë se kërkuesit janë njohur titullarë të së drejtës së pronës për truallin me sipërfaqe 348 m² që në vitin 1995, madje edhe e kanë regjistruar atë sipas kërkesave të ligjit në kohës. Po ashtu, duke respektuar kërkesat e ligjit, ata kanë kërkuar regjistrimin përfundimtar të pronës së tyre në regjistrat publikë. E drejta e pronës së tyre nuk është vënë asnjëherë në dyshim, për sa kohë vendimi i KKKP-së nuk është kundërshtuar në gjykatë nga askush, as nga subjektet shtetërore.

14. Pavarësisht kësaj, një pjesë e truallit të kërkuesve prej 348 m² (saktësisht sipërfaqja prej 260.3 m²) është bërë objekt i VKM-së nr. 342/2005, të cilën (pjesën e truallit), Këshilli i Ministrave, pa e pasur pjesë të fondit të pronave të tij, ia ka kaluar në pronësi një subjekti tjetër shtetëror – Bashkisë Tiranë. Për rrjedhojë, kërkuesve u është mohuar e drejta për certifikatë pronësie për të gjithë truallin, përfshirë edhe pjesën prej 87.7 m² të truallit, që nuk ishte prekur nga VKM-ja, duke i detyruar të nënshkruanin deklaratë se hiqnin dorë nga pjesa prej 260.3 m² që ishte regjistruar në favor të bashkisë. Në këtë mënyrë kërkuesit janë shpronësuar *de facto* dhe pa asnjë shpërblim, në kundërshtim me nenin 41 të Kushtetutës. Me fjalë të tjera, kërkuesve, edhe pse kanë një titull të ligjshëm pronësie për pronën e tyre (vendimi i ish-KKKP-së), u është cenuar në thelb aftësia për të ushtruar tagrat e pronësisë në atë shkallë saqë janë privuar nga e drejta e pronësisë. Ashtu siç ka theksuar Gjykata, e drejta e pronës nuk mund të reduktohet vetëm në zotërimin e titullit formal të pronësisë dhe se ajo realizohet përmes ushtrimit të tre tagrave të pronësisë që janë: i. e drejta e posedimit të pronës; ii. e drejta për ta gëzuar pronën, ku përfshihet edhe gëzimi i fryteve të pronës ose zhvillimi i saj; iii. e drejta për të disponuar



pronën (shih vendimin nr. 53, datë 31.10.2023, të Gjykatës Kushtetuese).

15. Ndonëse kërkuessit iu drejtuan gjykatave të zakonshme për të mbrojtur të drejtën e tyre të pronës, gjykatat nuk u dhanë përgjigje përfundimtare atyre. Konkretisht, gjykatat e faktit e kanë shqyrtuar çështjen vetëm në drejtim të mosushtimit të së drejtës së kërkuessve për kundërshtimin e VKM-së nr. 342/2005, por nuk kanë arsyetuar në lidhje me atë pjesë të pronës, sipërfaqen 87.7 m², e cila bie jashtë kufirit të pronës së regjistruar në emër të bashkisë, duke mos u shprehur për veprimet e ZVRPP-së, Tiranë. Kjo e fundit ka mbajtur qëndrimin zyrtar duke deklaruar se që kërkuessit të pajiseshin me vërtetim pronësie për pjesën e pronës që dilte jashtë pronës së bashkisë, ata duhet të hiqnin dorë nga e drejta e pronësisë së pjesës tjetër të truallit, që kishte kaluar në pronësi të bashkisë. Me fjalë të tjera, ZVRPP-ja i ka vendosur kërkuessit në një marrëdhënie të natyrës *quid pro quo*, që vlerësohet prej nesh si barrë e tepruar, sepse pronarëve u kërkohet të heqin dorë nga e drejta e pronësisë për një pjesë të pronës për të përfutur certifikatën e pronësisë për pjesën tjetër të saj. Në këtë kuptim, lidhur me sipërfaqen 87.7 m² të truallit, kërkimi i parë i padisë së kërkuessve nuk ka marrë asnjë përgjigje nga gjykatat.

16. Në vlerësimin tonë, edhe kërkimi i dytë i padisë së paraqitur nga kërkuessit, përmes të cilit ata kanë kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute të veprimeve juridike të regjistrimit dhe kalimit në pronësi të Bashkisë Tiranë të pjesës tjetër të pronës së tyre, ka mbetur gjithashtu pa përgjigje. Arsyetimi i gjykatave të faktit, sipas të cilit VKM-ja, mbi bazën e së cilës janë kryer veprimet për regjistrimin e pronës së kërkuessve në emër të bashkisë, nuk ishte kundërshtuar gjyqësisht prej tyre, nuk e çliron gjykatën nga detyrimi për shqyrtuar *proprio motu* ligjshmërinë e saj (të VKM-së), për sa kohë kjo e fundit është një akt individual që i ka shteruar efektet e saj pikërisht me veprimet e kryera nga ZVRPP-ja, Tiranë për regjistrimin e pronës objekt konflikti në emër të bashkisë. Në këtë kuptim, gjykatat nuk kanë arsyetuar përse ZVRPP-ja ka zgjedhur të çregjistrojë pronën e kërkuessve, të regjistrojë titullin e pronësisë të bashkisë (VKM-ja) dhe të mos regjistrojë titullin e kërkuessve (vendimi i KKKP-së). Edhe pse ligji për regjistrimin e pronave ka pësuar ndryshime në vite, rregulli sipas të cilit zyra e regjistrimit verifikon ligjshmërinë e titullit të pronësisë përpara regjistrimit

të pronës ka qenë gjithnjë në fuqi. Për këtë arsye, shqyrtimi i ligjshmërisë së VKM-së nr. 342/2005 ishte i domosdoshëm për të vlerësuar më pas ligjshmërinë e veprimeve të kryera nga ZVRPP-ja, Tiranë për regjistrimin e pronës në emër të Bashkisë Tiranë, aq më tepër që në atë proces përballej individi me organet shtetërore.

17. Gjithashtu, nuk rezulton që edhe Gjykata e Lartë të ketë analizuar ose vlerësuar pretendimet e kërkuessve që kanë të bëjnë, në thelb, me cenimin e së drejtës së pronës, pretendim i cili ka natyrë kushtetuese, ndaj nuk mund të vlerësohej në fazën e shqyrtimit paraprak, por kërkonte trajtim në themel në seancë gjyqësore, me qëllim garantimin e procesit të rregullt ligjor.

18. Duke vepruar në këtë mënyrë në rastin e kërkuessve, gjykatat e zakonshme, por edhe shumica me vendimin e saj, kanë shmangur parimin e efektivitetit të të drejtave të njeriut, sipas të cilit Kushtetuta është përgatitur të garantojë të drejtat që janë praktike dhe efikase, dhe jo teorike ose iluzive. Për rrjedhojë, ne, gjyqtarët në pakicë, çmojmë se në rastin konkret gjykatat, duke mos mbajtur qëndrim të shprehur në lidhje me sa më sipër, nuk kanë garantuar të drejtën e aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, duke sjellë si pasojë cenimin e së drejtës së pronës së kërkuessve.

19. Në përfundim, ne, gjyqtarët në pakicë, vlerësojmë se pretendimet e kërkuessve ishin të bazuara, ndaj ankimi kushtetues individual i tyre duhej të pranohej dhe të vendosej shfuqizimi i vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

Anëtarë: Sandër Beci, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini, Genti Ibrahim

VENDIM
Nr. 332, datë 9.7.2024

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR BASHKIMIN E PROCEDIMEVE
DISIPLINORE, NË RASTET KUR NJË
GJYQTAR DHE NJË PROKUROR,
JANË TË PËRFSHIRË NË TË NJËJTËN
SHKELJE DISIPLINORE”

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 140, nenin 147, pika 1 dhe nenin 147/a, pika 1, të



Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në nenin 140, pika 2, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenet 97, 98 të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të Drejtësisë”, të ndryshuar, mbi propozimin e Komisionit Disiplinor,

VENDOSI

1. Miratimin e rregullore “Për bashkimin e procedimeve disiplinore, në rastet kur një gjyqtar dhe një prokuror, janë të përfshirë në të njëjtën shkelje disiplinore”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
ZËVENDËSKRYETAR

Ilir Rusi

RREGULLORE

PËR BASHKIMIN E PROCEDIMEVE
DISCIPLINORE, NË RASTET KUR NJË
GJYQTAR DHE NJË PROKUROR, JANË TË
PËRFSHIRË NË TË NJËJTËN SHKELJE
DISCIPLINORE

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i rregullore

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është hartimi i rregullave për procedim të përbashkët, kur një gjyqtar dhe një prokuror janë të përfshirë në të njëjtën shkelje.

2. Në zbatim të kësaj Rregulloreje do të konsiderohet se një gjyqtar dhe një prokuror janë të përfshirë në të njëjtën shkelje disiplinore kur, të dy, bazuar në të njëjtat fakte, kryejnë të njëjtën shkelje ose një shkelje që, për nga natyra e saj, mund të konsiderohet ekuivalente duke pasur parasysh pozicionin dhe kompetencat e ndryshme profesionale të atyre që janë të përfshirë.

Neni 2

Parimet e përgjithshme

1. Pasi të jetë miratuar bashkimi i procedimeve, asnjë bashkim tjetër i mëtejshëm procedimesh, bazuar në fakte të tjera, në përputhje me dispozitat e nenit 140(1) të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për shkeljet e pretenduara të kryera veçmas, nuk do të jetë më i mundur.

2. Për çdo çështje që nuk është rregulluar në mënyrë specifike nga kjo Rregullore, do të zbatohen rregullat procedurale të përgjithshme, të parashikuara në ligjin nr. 96/2016.

Neni 3

Fillimi i procedurës disiplinore

1. Pasi të ketë përfunduar hetimi, Inspektori i Lartë i Drejtësisë fillon procedimin disiplinor, duke paraqitur raportin e hetimit së bashku me dosjen hetimore.

2. Nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë konsideron se hetimet duhet të mbyllën vetëm për njërin nga dy personat nën hetim, ai e argumenton vendimarrjen e tij në raportin e hetimit.

Neni 4

Përpunimi i dosjeve në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë

1. Secili Këshill është plotësisht i pavarur në trajtimin dhe vendimarrjen e çështjes disiplinore që lidhet me magistratët, të cilët janë në fushën e tij të kompetencës.

2. Këshillat përkatëse duhet të marrin vendimin për bashkimin e procedimeve brenda një periudhe dhjetëditore nga marrja e raportit të hetimit.

3. Nëse njëri nga dy Këshillat nuk e merr këtë vendim, bashkimi i procedimeve nuk do të ndodhë dhe, që nga ai moment e në vazhdim, procedurat do të vijnë veçmas.

4. Këshillat, pa vonesë, njoftojnë njëri-tjetrin për vendimet përkatëse. Po ashtu, vendimi do t'i njoftohet palëve në proces.

5. Pas regjistrimit dhe vendimit për bashkim, çështja do të hidhet menjëherë në short për caktimin e relatorit.



Neni 5

Rastet e ndarjes pa vendim të veçantë

Procedimet do të vijnë në ndarje, edhe nëse paraprakisht është marrë vendim për bashkimin e tyre, në rastet e mëposhtme:

a) nëse njëri nga dy Këshillat kërkon nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë të kryejë hetime të mëtejshme, në përputhje me dispozitat e nenit 138(5) të ligjit nr. 96/2016.

b) nëse njëri nga dy Këshillat pranon të mbyllë procedimet pa një seancë dëgjimore, pasi vlerëson se ka ndodhur ndonjë nga rastet e parashikuara në nenin 139 të ligjit sipërpërmendur.

c) nëse ndryshon ose zgjerohet fushëveprimi i procedurës disiplinore në përputhje me nenin 144 të ligjit në fjalë.

d) Nëse njëri nga Këshillat pezullon procedimet bazuar në dispozitat e nenit 145 të ligjit të lartpërmendur.

Neni 6

Procedura

Për të garantuar standard të njëjtë përgjatë procedurës disiplinore, çdo rast do të trajtohet sipas rregullave të përgjithshme, duke marrë parasysh sa më poshtë:

a) Pasi të jenë caktuar relatorët përkatës nga çdo Këshill, ata do të mbajnë një takim fillestar, në vendin e rënë dakord, në mënyrë që të informojnë njëri-tjetrin për qasjet përkatëse, veçanërisht mbi arsyet e bashkimit të procedimeve.

Ata, gjithashtu, mund të informojnë njëri-tjetrin për mundësitë që Këshillat respektivë të vendosin mbylljen e procedimit disiplinor pa seancë dëgjimore ose, në të kundërt, të caktojnë datën në të cilën do të zhvillohen seancat dëgjimore.

Marrëdhëniet dhe komunikimet mes relatorëve zhvillohen përmes kanaleve zyrtare.

b) Nëse njëri nga Këshillat urdhëron mbylljen e procedimit disiplinor, ai do të informojë menjëherë Këshillin tjetër, nëpërmjet relatorit përkatës.

c) Relatorët do të ndërmarrin takime sipas nevojës, duke vepruar në besnikëri të plotë, duke mundësuar qëndrime të përbashkëta, veçanërisht për përcaktimin e fakteve të vërtetuara.

d) Gjithashtu, relatorët duhet të informojnë njëri-tjetrin për statusin e çdo veprimi procedural që kryhet, duke kërkuar, për aq sa është e mundur dhe

në respektim të plotë të fushës së tyre të veprimit, koherencën më të madhe në vendimin përfundimtar.

e) Relatorët do të mundësojnë, sa herë që është e mundur, që Këshillat përkatës të japin përgjigje të njëjtë ndaj kërkesave të palëve për prova, shtyrjen e seancës dëgjimore, kërkesën për pezullimin e procedurës, për shkak të ekzistencës së një hetimi penal apo procesi gjyqësor që ka rëndësi për procedimin disiplinor, si dhe çdo kërkesë apo çështje tjetër që mund të ngrihet.

f) Relatorët duhet të përpiqen të sigurojnë që seancat dëgjimore disiplinore të mbahen në të njëjtën ditë. Nëse kjo nuk është e mundur, përpiqen të mbahen sa më afër njëra-tjetrës të jetë e mundur. Nëse ato janë planifikuar në të njëjtën ditë, duhet të evitohet që mbajtja e njëres seancë të mund të paragjykojë mbajtjen e tjetrës, nëse të njëjtët persona duhet të marrin pjesë në të dyja seancat.

g) Në hartimin e vendimit përfundimtar, çdo relator do të kërkojë konsistencën maksimale në përcaktimin e fakteve të vërtetuara, pa paragjykuar vlerësimin ligjor të këtyre fakteve nga secili Këshill.

Gjithashtu, ata do të përpiqen të sigurojnë që, nëse është e mundur dhe pa cenuar të drejtat e palëve, njoftimi i vendimit disiplinor të bëhet në të njëjtën datë.

KREU II

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 7

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr. 20, datë 9.7.2024

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR
NDRYSHIMIN E NIVELIT TARIFOR TË
SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS-
KANALIZIME GJIROKASTËR SHA**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji



nr. 8102); vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 539, datë 30.12.2021, “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime” (vendimi i KKRR nr. 539),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 9.7.2024, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Gjirokastrë sh.a. për miratimin e ndryshimit të nivelit tarifor për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura,

KONSTATOI SE:

1. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR), me vendimin nr. 7, datë 22.2.2023, “Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Gjirokastrë sh.a.”, ka licencuar shoqërinë Rajonale UK Gjirokastrë për ushtrimin e veprimtarisë së grumbullimit dhe të shpërndarjes së ujit për konsum publik dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura për një afat 4-vjeçar.

2. Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Gjirokastrë sh.a., me shkresën nr. 1864 prot., datë 27.6.2024, me lëndë “Kërkesë për ndryshimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura”, ka paraqitur kërkesën pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU), për rishikimin e nivelit tarifor për shërbimet ujësjellës-kanalizime.

3. Në zbatim të pikës 1 të nenit 10 të “Metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime”, shoqëria rajonale UK Gjirokastrë sh.a. në aplikimin për ndryshim të nivelit tarifor duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesa zyrtare drejtuar ERRU për ndryshimin e tarifave për shërbimet ujësjellës-kanalizime dhe ITUN;

b) pasqyrat financiare të vitit paraardhës certifikuar nga një ekspert kontabël i autorizuar;

c) plani 5-vjeçar i biznesit, ku të paraqitet edhe programi investimeve dhe aseteve të reja, i cili do të hartohet në përputhje me formatin e aprovuar në

këtë metodologji nga ERRU-ja, që është i detyrueshëm vetëm për grupin e shoqërive që tentojnë të mbulojnë 100% të kostove totale;

d) modeli i aplikimit për nivelin e ri tarifor: të gjitha tabelat e modelit paraqiten të printuara dhe të firmosura nga shoqëria dhe sipas formatit *Excel* të miratuar nga ERRU-ja;

e) organigramë dhe përshkrimet e punës së stafit sipas pozicionit të tyre;

f) aktmarrëveshjet e kredisë midis shoqërisë dhe institucioneve kredi dhënëse, në rast se shoqëria është financuar me hua dhe skema e planit mujor të shlyerjeve gjatë viteve të kaluara dhe viteve të ardhshme;

g) mendimin e Pushtetit Vendor për tarifat e propozuara të shprehura në vendimin përkatës dhe konfirmuar nga prefekti i qarkut për legjitimitetin e tij;

h) vendimi i Këshillit të Administrimit për miratimin e tarifave të propozuara;

i) procesverbali i Seancave Dëgjimore me Publikun sipas formatit të përcaktuar nga ERRU-ja;

j) subvencionet e përfituara nga operatori dhe ato të nevojshme gjatë periudhës rregullore të tarifave të propozuara;

k) lejet ose autorizimet për përdorimin e ujit për shoqëritë UK lëshuar nga Këshilli i Basenit Ujor të shoqëruara me marrëveshjen ndërmjet shoqërisë UK dhe KBU për pagesën e tarifave për përdorimin e ujit;

l) raport i detajuar për gjendjen teknike të sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura, në të cilën të përshkruhet inventari i aseteve në përdorim të shoqërisë me të dhëna teknike (përmasat, lloji i materialit, vitit të instalimit/ndërtimit), përfshirë dhe prioritetet për zëvendësimin e tyre. Ky material do të hartohet sipas formatit të përcaktuar nga ERRU;

m) relacion analitik ekonomik për vitin paraardhës, si dhe për periudhën rregullore që kërkohet ndryshimi i tarifave, në të cilën shprehet qartë justifikimi dhe argumentet përkatëse dhe objektivat e shoqërisë për përmirësimin e treguesve të punës;

n) në rast se shoqëria aplikon për tarifë shitje uji me shumicë, në kërkesën e saj për tarifa duhet të paraqesë: relacion teknik dhe ekonomik me llogaritjet e tarifës së shitjes së ujit me shumicë, miratimin e tarifës së kërkuar nga organet drejtuese, si dhe akt marrëveshjet midis palëve shitës-blerës;



o) të ketë shlyer detyrimet për pagesën rregullatore, sipas kontratës së nënshkruar midis ERRU dhe shoqërisë dhe në rast të detyrimeve të prapambetura të ketë shlyer, sipas marrëveshjes së nënshkruar mes tyre për shlyerjen me këste të tyre;

p) deklarata për vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave sipas nenit 26 dhe nenit 46 të kësaj metodologjie.

4. Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria rajonale UK Gjirokastrë sh.a është plotësuar sipas parashikimeve të pikës 1 të nenit 10 të “Metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime”.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator pasi arriti në përfundimin se aplikimi i shoqërisë Rajonale UK Gjirokastrë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në vendimin e KKRR-së nr. 539, datë 30.12.2021, dhe kuadrin rregullator në fuqi:

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Gjirokastrë sh.a. për miratimin e ndryshimit të nivelit tarifor për shërbimet ujësjellës-kanalizime.

2. Ngarkohet Drejtoria Teknike-Ekonomike për njoftimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Gjirokastrë sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETAR

Ediola Braha

VENDIM

Nr. 21, datë 9.7.2024

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA PËR SHOQËRINË RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME POGRADEK SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe

largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 539, datë 30.12.2021, “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime” (vendim KKRR nr. 539),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 9.7.2024, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Teknike-Ekonomike dhe Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura,

KONSTATON SE:

1. Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Pogradec sh.a., me shkresën nr. 377 prot. datë 15.4.2024, me lëndë “Kërkesë për ndryshimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin (kanalizime) e ujërave të ndotura”, ka paraqitur kërkesën pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU), për rishikimin e nivelit tarifor për shërbimet ujësjellës-kanalizime, sipas tabelës nr. 1 të mëposhtme:



Tabela 1. Tarifatat aktuale dhe të propozuara nga Shoqëria Rajonale UK Pogradec për vitet 2025–2027

Kategoria e konsumatorëve			Zona e shërbimit	
			Tarifat aktuale	Tarifat e propozuara vitet 2025–2027
A. Shërbimi i FU-së			Lek/m³	Lek/m³
Njësia Pogradec	Pogradec, Buçimas	1. Konsumatorë familjarë	60	65
		2. Konsumatorë publikë	111	120
		3. Konsumatorë privatë	111	120
	Njësitë administrative	1. Konsumatorë familjarë	30	35
		2. Konsumatorë publikë	100	100
		3. Konsumatorë privatë	100	100
Njësia Përrenjas	Zona urbane, qyteti	1. Konsumatorë familjarë	42	45
		2. Konsumatorë publikë	100	100
		3. Konsumatorë privatë	100	100
	Zona rurale	1. Konsumatorë familjarë	26	35
		2. Konsumatorë publikë	60	100
		3. Konsumatorë privatë	60	100
B. Shërbimi i KUN-it			Lek/m³	Lek/m³
Njësia Pogradec	Pogradec, Buçimas	1. Konsumatorë familjarë	30	35
		2. Konsumatorë publikë	40	50
		3. Konsumatorë privatë	40	50
	Njësitë administrative	1. Konsumatorë familjarë	15	25
		2. Konsumatorë publikë	30	40
		3. Konsumatorë privatë	30	40
Njësia Përrenjas	Zona urbane, qyteti	1. Konsumatorë familjarë	15	25
		2. Konsumatorë publikë	25	40
		3. Konsumatorë privatë	26	40
	Zona rurale	1. Konsumatorë familjarë	0	25
		2. Konsumatorë publikë	0	40
		3. Konsumatorë privatë	0	40
D. Tarifë fikse shërbimi			Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje
Njësia Pogradec	Pogradec, Buçimas	1. Konsumatorë familjarë	200	200
		2. Konsumatorë publikë	300	300
		3. Konsumatorë privatë	300	300
	Njësitë administrative	1. Konsumatorë familjarë	100	200
		2. Konsumatorë publikë	100	300
		3. Konsumatorë privatë	100	300
Njësia Përrenjas	Zona urbane, qyteti	1. Konsumatorë familjarë	200	200
		2. Konsumatorë publikë	200	300
		3. Konsumatorë privatë	200	300
	Zona rurale	1. Konsumatorë familjarë	100	200
		2. Konsumatorë publikë	100	300
		3. Konsumatorë privatë	100	300

2. Me vendimin nr. 16, datë 16.5.2024, “Për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshimin e nivelit tarifar të shoqërisë rajonale ujësjellës-kanalizime Pogradec sh.a.”, Komisioni Kombëtar Rregullator vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të SHRUK Pogradec.

3. Kërkesa e shoqërisë Rajonale UK Pogradec, për vendosjen e nivelit të ri tarifar për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura është në përputhje me përcaktimet dhe procedurën

e parashikuar në vendimin e KKRR-së nr. 539, datë 30.12.2021.

Shoqëria Rajonale UK Pogradec aplikon tarifat e miratuara nga ERRU për ish-shoqëritë UK ekzistuese, sipas vendimit të KKRR-së nr. 99, datë 20.8.2020, për Bashkinë Pogradec dhe vendimit të KKRR nr. 75, datë 19.10.2018, për BASHKINË Përrenjas.

4. Shoqëria në relacionin e saj e justifikon nevojën e ndryshimit të tarifave sipas argumenteve të mëposhtme:



a) nevoja për përmirësimin e performancës financiare dhe mbulimi mbi 100% i kostove operacionale;

b) aplikimi për nivel të ri tarifor për shkak të rritjes së çmimeve të materialeve dhe pagës minimale ndër vite;

c) përmirësim i cilësisë së shërbimeve të ofruara të FU-së dhe KUN-it si rezultat i investimeve të parashikuara;

d) tarifat e reja të propozuara synojnë edhe mbulimin e shpenzimeve të riparimeve për eliminimin e defekteve apo lidhjeve të paligjshme, instalimin e matësve, rregullimin dhe menaxhimin e rrjetit të furnizimit.

5. Gjatë procesit të analizës teknike-ekonomike, sipas metodologjisë së vendosjes së tarifave të përcaktuar në vendimin e KKRR nr. 539, datë 30.12.2021, ERRU-ja ka kërkuar informacion të detajuar për të dhënat e raportuara në modelin e aplikimit.

6. Në vlerësimin e tarifave të propozuara dhe në analizën ekonomike financiare, janë marrë në konsideratë përmbushja nga UK Rajonale Pogradec sh.a. e kriterëve të mëposhtme:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, i ndryshuar, si dhe të akteve nënligjore dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë sa i takon mbrojtjes së konsumatorëve nga çmimet monopol dhe mbrojtjen e interesave të tyre, në lidhje me cilësinë, eficientë, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” të ndryshuar, sa i takon mos lejit të abuzimit me pozitën dominuese në treg, veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve, pjesën e tregut përkatës të ndërmarrjes dhe të konkurrentëve të tjerë, pengesat në hyrje në tregun përkatës dhe konkurrencën potenciale;

c) kërkesave të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e Konsumatorëve”, të ndryshuar;

d) kërkesave të VKM-së nr. 302, datë 11.5.2022, “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”.

e) orientimin e tarifave drejt mbulimit të kostove operacionale për shërbimet e furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura;

f) tarifat e propozuara nuk sjellin për pasojë efekte negative në mjedis nga veprimtaria e

operatorit në zonën e shërbimit që ato do të aplikohen.

7. Në bazë të analizës, verifikimeve dhe komunikimit me stafin drejtues të shoqërisë, ERRU-ja ka vendosur detyra për t'u realizuar nga UK Rajonale Pogradec sh.a.:

a) t'i kushtohet vëmendja e duhur për përmbylljen sa më parë instalimit të matësve në prodhim dhe atyre familjarë të parashikuar, për të gjithë klientët në zonën e shërbimit, në mënyrë që të arrijë objektivin e vendosur nga ERRU-ja për treguesin e nivelit të matjes dhe uljen e humbjeve;

b) të kryejë vlerësimin e “Ujit të prodhuar”, bazuar në regjistrimet ditore të prodhimit, në çdo pikë ku ai përftohet me dhe pa ujëmatës;

c) të mbajë aktive vazhdimisht task-forcën për evidentimin dhe eliminimin e lidhjeve të paligjshme në rrjetet e furnizimit dhe abuzimet kryesisht për klientët privatë (hotele, bare dhe restorante), si dhe për klientët familjarë në zonat rurale;

d) të trajtojë stafin teknik profesionist mbi njohjen, hartimin e bilancit të ujit me të dhëna sa më afër realitetit dhe përllëgaritjen e komponentëve të tij sa më saktë, për të pasur situatë reale mbi UPA-në dhe të merren masat dhe të bëhen korrigjimet përkatëse gjatë hartimit të bilancit të ujit për vitin 2024 dhe në vazhdim;

e) për aplikimin tarifor të radhës (jo më vonë se qershor 2027), duke qenë se shoqëria në fund të periudhës rregullatore 2025–2027 do të arrijë të mbulojë mbi 100% kostot O&M, në këtë aplikim të pritshëm shoqëria do të aplikojë sipas metodës “çmim tavan” të metodologjisë së tarifave, i cili kërkon që të jetë detyruesisht i shoqëruar me planin e biznesit 5-vjeçar i aprovuar paraprakisht nga ERRU. Për këtë qëllim shoqëria duhet të ketë parasysh që brenda vitit 2027 të ketë hartuar Planin e biznesit 5-vjeçar, duke përdorur si vit bazë të dhënat e certifikuara të vitit 2026, i cili duhet të shoqërohet me planet përkatëse të veprimit të mbështetura me projekte dhe me burimet e financimit;

f) të hartojë urgjentisht Planin e Menaxhimit të Aseteve për të orientuar investimet sipas prioriteteve të përcaktuara për të planifikuar prioritetet e investimeve në të ardhmen e afërt, në mënyrë që të evitohet vjetrimi i tyre përtej jetëgjatësisë së dobishme, e cila lidhet ngushtësisht me strategjinë e zvogëlimit të humbjeve nga rrjedhjet dhe eliminimin



e rrezikut të cenimit të shëndetit publik nga ndotjet në çarjet;

g) të mirëmbajë sisteme të informacionit teknik dhe financiar, në përputhje me metodologjinë e vendosjes së tarifave që të mundësohet verifikimi i të dhënave të paktën për vitin 2026, si një vit bazë që do të përdoret për aplikimin e radhës;

h) të mbajë në sistemet e kontabilitetit kostot e amortizimit të aseteve, sipas kërkesave të ERRU-së referuar ndarjes që ka bërë në këtë model aplikimi në mënyrë që të verifikohet realizimi i investimeve të parashikuara për t'u realizuar gjatë periudhës rregullatore, pra në vitet 2025–2027.

i) me mbështetjen e task-forcës të ndërmarrë masa për përmirësimin e treguesit të normës korrente të arkëtimit dhe asaj të përgjithshme, duke zbatuar masat e nevojshme për këtë qëllim, si: monitorimi i klientëve, shtimi i qendrave ku paguhen faturat, pagesa bankare, pagesa *online* dhe deri ndërprerje të shërbimeve të klientëve që nuk paguajnë.

j) Treguesi i eficiencës së stafit që lidhet me një nga elementet e rëndësishme të kostove të O&M duhet të justifikohet me argumente mbështetëse. Për këtë, duke hartuar urgjentisht një organogramë të detajuar të stafit dhe përshkrimet përkatëse të punës dhe detaje të tjera që justifikojnë numrin e punonjësve në shoqëri.

k) Duke qenë se shoqëria në vitin e parë 2025 të periudhës rregullatore arrin të mbulojë rreth 108% të kostove të O&M, vlera 8% ose rreth 19.7 milionë lekë e të ardhurave mbi mbulimin 100% të kostove O&M duhet me prioritet të përdoret detyrimisht së pari për të shlyer vlerën prej 14.3 milionë lekë të detyrimeve të pagesave të huave të kredive me donatorë të huaj, më tej pjesa që mbetet (rreth 5.4 milionë lekë) të përdoret për investimet e parashikuara që shoqëria planifikon ti mbulojë me të ardhurat e veta. Deficiti prej 8.1 milionë lekësh për të mbuluar totalisht investimet e parashikuara me investimet e veta duhet të mbulohet me burime të tjera financiare nga të tretë ose subvencione nga qeveria qendrore. Në aplikimin e radhës do të

kërkohen dokumentet përkatëse mbështetëse që vërtetojnë përdorimin e tyre të cituar më sipër.

l) Ti kushtohet vëmendje e veçantë konsumit të energjisë në drejtim të monitorimit dhe kontrollit të këtyre kostove, duke i dhënë prioritet hartimit urgjent të një studimi mbi eficiencën e energjisë, me qëllim zhvillimin dhe zbatimin e një strategjie afatgjatë për energjinë.

m) Për qytetin e Pogradecit, me një aktivitet intensiv turistik gjatë sezonit të verës, ku një pjesë e madhe e klientëve përbëhet nga pushues me shtëpi të dyta, në aplikimin e radhës shoqëria rekomandohet fuqimisht të aplikojë me tarifa me blloqe, si mundësi e justifikuar për rritjen e qëndrueshmërisë financiare të saj dhe planifikimin ku 30% e kostove të planifikohen të përballohen nga tarifa fikse.

Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi vlerësoi tarifat e propozuara nga operatori mbi bazën e Metodologjisë të miratuar me vendimin nr. 539, datë 30.12.2021, “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime”, arrin në konkluzionin, se sipas analizës së kryer, tarifat janë të bazuara dhe në zbatim të kriterëve ligjore referuese lidhur me kostot e pranueshme dhe të justifikuara si dhe përbalueshmërinë, nuk janë të padrejta dhe të vendosura në kushtet e abuzimit me pozitën dominuese në treg të operatorit ekonomik në kuptim të ligjit nr. 9121, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, dhe ligjin nr. 9902, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, në zbatim të nenit 13, 14 dhe 22 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Pogradec sh.a., si më poshtë:



Tabela 2. Tarifat e miratuara nga ERRU për shoqërinë Rajonale UK Pogradec

Kategoria e klientëve			Tarifat e vendosura nga ERRU për vitet 2025–2027
ZONA A	Pogradec & Buçimas	A. Shërbimi i FU-së	Lek/m ³
		1. Klientë familjarë	65
		2. Klientë publikë	120
		3. Klientë privatë	120
		B. Shërbimi i KUN-it	Lek/m ³
		1. Klientë familjarë	35
		2. Klientë publikë	50
		3. Klientë privatë	50
		C. Tarifë fikse shërbimi	Lek/muaj/lidhje
		1. Klientë familjarë	200
		2. Klientë publikë	300
		3. Klientë privatë	300
ZONA B	Përrenjas	A. Shërbimi i FU-së	Lek/m ³
		1. Klientë familjarë	45
		2. Klientë publikë	100
		3. Klientë privatë	100
		B. Shërbimi i KUN-it	Lek/m ³
		1. Klientë familjarë	25
		2. Klientë publikë	40
		3. Klientë privatë	40
		C. Tarifë fikse shërbimi	Lek/muaj/lidhje
		1. Klientë familjarë	200
		2. Klientë publikë	300
		3. Klientë privatë	300
ZONA C	Rurale Pogradec	A. Shërbimi i FU-së	Lek/m ³
		1. Klientë familjarë	35
		2. Klientë publikë	100
		3. Klientë privatë	100
		B. Shërbimi i KUN-it	Lek/m ³
		1. Klientë familjarë	25
		2. Klientë publikë	40
		3. Klientë privatë	40
		C. Tarifë fikse shërbimi	Lek/muaj/lidhje
		1. Klientë familjarë	200
		2. Klientë publikë	300
		3. Klientë privatë	300
	Rurale Përrenjas	A. Shërbimi i FU-së	Lek/m ³
		1. Klientë familjarë	35
		2. Klientë publikë	70
		3. Klientë privatë	70
		B. Shërbimi i KUN-it*	Lek/m ³
		1. Klientë familjarë	25
		2. Klientë publikë	40
		3. Klientë privatë	40
		C. Tarifë Fikse shërbimi	Lek/muaj/ lidhje
		1. Klientë familjarë	200
		2. Klientë publikë	300
		3. Klientë privatë	300

2. Objektivat e treguesve të performancës të vendosura nga ERRU-ja

Referuar treguesve aktualë të performancës së shoqërisë rajonale UK Pogradec, planeve të veprimit për përmirësimin e tyre, si dhe efektin e pritshëm ekonomik të tarifave të miratuara nga ERRU-ja, objektivat që duhet të realizojë shoqëria gjatë implementimit të tarifave të reja deri në fund të vitit 2026, i cili do të jetë edhe viti bazë në aplikimin e ardhshëm për nivel të ri tarifor të shoqërisë (jo më vonë se qershor 2027) për periudhën e re rregullatore, jepen në tabelën nr. 3 të mëposhtme.



Tabela 3. Objektivat e Treguesve të Performancës (TKPs)

TKP	Nr	Emri i TKP-ve	Njësia TKP	Objektivat e vendosura nga ERRU në fund të vitit 2026
Mbulimi me shërbim	1.1	Mbulimi me shërbimin e FU-së	%	90.41
	1.2	Mbulimi me shërbimin me KUN-in	%	53.76
	1.3	Mbulimi me shërbimin e trajtimit të UN-së	%	49.2
TKP Teknike	2.1	Uji pa të ardhura	%	32
	3	Niveli i matjes	%	100
	4	Vazhdimësia e furnizimit me ujë	orë/ditë	24
	5.1	Efikasiteti i energjisë për ujin	kwh/m ³	0.47
	6	Efienca e stafit	nr/nr/1000 banorë	1.8
Shërbimi ndaj klientit	7.1	Ankesat e klientëve	%	3.4
	7.2	Ankesat e klientëve që kanë marrë përgjigje	%	100
	7.3	Ankesat e klientëve që kanë marrë zgjidhje	%	100
TKP financiare	8.1	Norma korrente e arkëtimit	%	85
	8.2	Norma e përgjithshme e arkëtimit	%	100
	9.2	Mbulimi i kostove O&M	%	109
	10.1	Mbulimi i kostos totale	%	31

3. Pjesa rregullatore vjetore për shoqërinë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Pogradec sh.a. do të jetë 0.77% e të ardhurave të parashikuara nga analiza tekniko-ekonomike.

4. UK Rajonale Pogradec detyrohet të nënshkruajë kontratën “Për aplikimin e tarifave të miratuara nga ERRU dhe shlyerjen e pagesës rregullatore”, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit.

5. Ky vendim hyn në fuqi me datë 10.8.2024 dhe është i vlefshëm deri në 31.12.2027.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR
ZËVENDËSKRYETAR
Ediola Braha

VENDIM
Nr. 21, datë 4.7.2024

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, të kreut I, nenit 22 pika 4, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, i ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për

deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, të kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, i ndryshuar, me urdhërin nr. 56, datë 23.3.2023, “Për një ndryshim në urdhërin nr. 21, datë 6.2.2023, ‘Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 21, datë 4.7.2024 si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Arka 2/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1099 “Merimanga”, me 7 volume në total me 1388 (njëmijë e treqind e tetëdhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1983–1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

2. Arka 2/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1137 “Arrëz-86”, me 57 (pesëdhjetë e shtatë) fletë. Dosja daton në vitet 1986–1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

3. Arka 2/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1136 “Sinjali”, me 28 (njëzet e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1986–1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.



4. Arka 2/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1189 “Bretkosat”, me 80 (tetëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1987–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

5. Arka 2/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1091 “Filtër”, me 34 (tridhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1985–1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

6. Arka 2/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1132 “Kunadhja”, me 73 (shtatëdhjetë e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1986–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

7. Arka 2/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 904 “Juba”, me 50 (pesëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1981–1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

8. Arka 2/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1154 “Mashtuesi”, me 52 (pesëdhjetë e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1986–1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

9. Arka 2/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1184 “Interesi”, me 12 (dymbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

10. Arka 2/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1178 “Ujku”, me 43 (dyzet e tre) fletë. Dosja daton në vitet 198–1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

11. Arka 2/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1153 “Deti”, me 20 (njëzet) fletë. Dosja daton në vitet 1986–1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

12. Arka 2/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1129 “Gjakpirësi”, me 22 (njëzet e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1986–1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

13. Arka 2/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1003 “Esenca”, me 202 (dyqind e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1981–1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

14. Arka 2/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1179 “Injoranti”, me 46 (dyzet e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1987–1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

15. Arka 2/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1131 “Urithi”, me 50 (pesëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1985–1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

16. Arka 2/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1130 “Mashtuesi”, me 20 (njëzet) fletë. Dosja daton në vitet 1986–1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

17. Arka 2/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1163 “Grupi”, me 29 (njëzet e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1987–1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

18. Arka 2/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1182 “Krokodili”, me 92 (nëntëdhjetë e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1987–1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

19. Arka 2/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1119 “Ariu”, me 124 (njëqind e njëzet e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1986–1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

20. Arka 2/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1186 “Katili”, me 34 (tridhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1987–1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

21. Arka 2/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1149 “Dhelpra”, me 207 (dyqind e shtatë) fletë. Dosja daton në vitet 1986–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

22. Arka 2/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1155 “Kajmaku”, me 78 (shtatëdhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1986–1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

23. Arka 3/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1197 “Bataku”, me 188 (njëqind e tetëdhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1987–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

24. Arka 3/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1223 “Arka”, me 151 (njëqind e pesëdhjetë e një) fletë. Dosja daton në vitet 1988–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

25. Arka 3/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1187 “Bufi”, me 79 (shtatëdhjetë e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1987–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

26. Arka 3/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1221 “Urithi”, me 72 (shtatëdhjetë e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1988–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

27. Arka 3/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1202 “Dhelpra”, me 146 (njëqind e dyzet e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1988–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.



28. Arka 3/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1228 “Mbeturina”, me 37 (tridhjetë e shtatë) fletë. Dosja daton në vitet 1988–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

29. Arka 3/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1245 “Druvari”, me 38 (tridhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitin 1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

30. Arka 3/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1210 “Amballazh”, me 49 (dyzet e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1988–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

31. Arka 3/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1213 “Hajnat”, me 29 (njëzet e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1988–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

32. Arka 3/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1241 “Taksia”, me 26 (njëzet e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1989–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

33. Arka 3/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1208 “Çakalli”, me 41 (dyzet e një) fletë. Dosja daton në vitet 1988–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

34. Arka 3/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1243 “Flaka”, me 74 (shtatëdhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1989–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

35. Arka 3/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1231 “Bufi”, me 65 (gjashtëdhjetë e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1988–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

36. Arka 3/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1240 “Kuponi”, me 52 (pesëdhjetë e dy) fletë. Dosja daton në vitin 1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

37. Arka 3/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1113 “Kalaja”, me 93 (nëntëdhjetë e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1986–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

38. Arka 3/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1039 “Fazani”, me 92 (nëntëdhjetë e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1984–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

39. Arka 3/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1134 “Furnitori”, me 49 (dyzet e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1986–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

40. Arka 3/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1171 “Palma”, me 32 (tridhjetë e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1987–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

41. Arka 3/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1193 “Njolla”, me 36 (tridhjetë e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1987–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

42. Arka 3/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 999 “Karina 81”, me 35 (tridhjetë e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1983–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

43. Arka 3/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1198 “Merimanga 2”, me 59 (pesëdhjetë e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1987–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

44. Arka 3/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1034 “Shushunja”, me 124 (njëqind e njëzet e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1984–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

45. Arka 3/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1170 “Gaforja”, me 30 (tridhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1986–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

46. Arka 3/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 946 “Metali”, me 21 (njëzet e një) fletë. Dosja daton në vitet 1982–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

47. Arka 3/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1169 “Zhabat”, me 178 (njëqind e shtatëdhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1987–1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

48. Arka 3/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1214 “Floriri”, me 33 (tridhjetë e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1984–1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

49. Arka 3/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1209 “Thengjilli”, me 60 (gjashtëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1988–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

50. Arka 3/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1200 “Çizmja”, me 34 (tridhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1987–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

51. Arka 3/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1230 “Leva”, me 18 (tetëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.



52. Arka 3/1, Fondi Dega IV, dosje e problemimit të centralizuar nr. 1237 “Kërmilli”, me 21 (njëzet e një) fletë. Dosja daton në vitin 1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

53. Arka 3/1, Fondi Dega IV, dosje e problemimit të centralizuar nr. 1159 “Kontrabandisti”, me 79 (shtatëdhjetë e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1986–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

54. Arka 3/1, Fondi Dega IV, dosje e problemimit të centralizuar nr. 1226 “Grerëzat”, me 44 (dyzet e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1988–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

55. Arka 1/1, Fondi Dega IV, dosje e problemimit të centralizuar nr. 1059 “Rrenja”, me 10 (dhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1985–1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

56. Arka 1/1, Fondi Dega IV, dosje e problemimit të centralizuar nr. 1046 “Akrep”, me 45 (dyzet e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1984–1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

57. Arka 1/1, Fondi Dega IV, dosje e problemimit të centralizuar nr. 1062 “Këpuca”, me 32 (tridhjetë e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1985–1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

58. Arka 1/1, Fondi Dega IV, dosje e problemimit të centralizuar nr. 1053 “Çelësi”, me 42 (dyzet e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1984–1985. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

59. Arka 1/1, Fondi Dega IV, dosje e problemimit të centralizuar nr. 1029 “Karagjozi”, me 89 (tetëdhjetë e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1984–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

60. Arka 1/1, Fondi Dega IV, dosje e problemimit të centralizuar nr. 1018 “Çakalli”, me 71 (shtatëdhjetë e një) fletë. Dosja daton në vitet 1984–1985. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

61. Arka 1/1, Fondi Dega IV, dosje e problemimit të centralizuar nr. 140 “Thesi”, me 201 (dyqind e një) fletë. Dosja daton në vitet 1974–1981. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

62. Arka 1/1, Fondi Dega IV, dosje e problemimit të centralizuar nr. 805 “Kaldaja”, me 96 (nëntëdhjetë e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1980–1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

63. Arka 1/1, Fondi Dega IV, dosje e problemimit të centralizuar nr. 799 “Trashea”, me 63 (gjashtëdhjetë e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1987–

1985. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

64. Arka 1/1, Fondi Dega IV, dosje e problemimit të centralizuar nr. 1058 “Buff”, me 166 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1984–1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

65. Arka 1/1, Fondi Dega IV, dosje e problemimit të centralizuar nr. 976 “Timoni”, me 71 (shtatëdhjetë e një) fletë. Dosja daton në vitet 1981–1984. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

66. Arka 1/1, Fondi Dega IV, dosje e problemimit të centralizuar nr. 1112 “Peshkatori”, me 26 (njëzet e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1985–1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

67. Arka 1/1, Fondi Dega IV, dosje e problemimit të centralizuar nr. 1069 “Tulla”, me 23 (njëzet e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1985–1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

68. Arka 1/1, Fondi Dega IV, dosje e problemimit të centralizuar nr. 1070 “Kazani”, me 25 (njëzet e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1985–1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

69. Arka 1/1, Fondi Dega IV, dosje e problemimit të centralizuar nr. 1084 “Grep”, me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1985–1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

70. Arka 1/1, Fondi Dega IV, dosje e problemimit të centralizuar nr. 1038 “Sportisti”, me 38 (tridhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1984–1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

71. Arka 1/1, Fondi Dega IV, dosje e problemimit të centralizuar nr. 1063 “Mandati”, me 95 (nëntëdhjetë e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1985–1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

72. Arka 1/1, Fondi Dega IV, dosje e problemimit të centralizuar nr. 1068 “Çelësi”, me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1985–1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

73. Arka 1/1, Fondi Dega IV, dosje e problemimit të centralizuar nr. 138 “Kurthi”, me 136 (njëqind e tridhjetë e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1973–1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

74. Arka 1/1, Fondi Dega IV, dosje e problemimit të centralizuar nr. 968 “Karaduza”, me 20 (njëzet)



fletë. Dosja daton në vitet 1983–1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

75. Arka 1/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 995 “Magnetofoni”, me 35 (tridhjetë e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1983–1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

76. Arka 1/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 78 “Predha”, me 68 (gjashtëdhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1970–1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

77. Arka 1/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1124 “Llupsi”, me 38 (tridhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitin 1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

78. Arka 1/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1133 “Urithët”, me 22 (njëzet e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1985–1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

79. Arka 1/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1083 “Gaforja”, me 38 (tridhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1985–1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

80. Arka 1/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 830 “Litari”, me 28 (njëzet e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1981–1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

81. Arka 1/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 960 “Skoda”, me 22 (njëzet e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1983–1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

82. Arka 1/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 840 “Bufeja”, me 31 (tridhjetë e një) fletë. Dosja daton në vitet 1981–1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

83. Arka 1/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 948 “Kërmilli”, me 41 (dyzet e një) fletë. Dosja daton në vitet 1982–1985. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

84. Arka 1/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 847 “Grushti”, me 26 (njëzet e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1981–1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

85. Arka 1/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 996 “Rrjeta”, me 138 (njëqind e tridhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1984–1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

86. Arka 1/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 2 “M”, me 131 (njëqind e tridhjetë

e një) fletë. Dosja daton në vitet 1971–1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

87. Arka 1/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1101 “Çakalli”, me 23 (njëzet e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1985–1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

88. Arka 1/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1047 “Gështenja”, me 200 (dyqind) fletë. Dosja daton në vitet 1983–1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

89. Arka 1/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1104 “Korbi”, me 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1985–1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

90. Arka 4/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 784 “Gropa”, me 118 (njëqind e tetëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1980–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

91. Arka 4/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1195 “Çjerrja e maskës”, me 42 (dyzet e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1987–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

92. Arka 4/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1161 “Thekna”, me 18 (tetëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1987–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

93. Arka 4/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1261 “Merimanga”, me 35 (tridhjetë e pesë) fletë. Dosja daton në vitin 1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

94. Arka 4/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1103 “Gjarpëri”, me 179 (njëqind e shtatëdhjetë e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1985–1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

95. Arka 4/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1246 “Mafiozi”, me 50 (pesëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1989–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

96. Arka 4/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1238 “Bronxi”, me 20 (njëzet) fletë. Dosja daton në vitet 1989–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

97. Arka 4/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1190 “Sopata”, me 78 (shtatëdhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1987–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

98. Arka 4/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1192 “Enigma”, me 99



(nëntëdhjetë e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1987–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

99. Arka 4/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1207 “Straficka 84”, me 42 (dyzet e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1988–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

100. Arka 4/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1021 “Ujku”, me 39 (tridhjetë e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1988–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

101. Arka 4/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1248 “Sinjalizuesi”, me 80 (tetëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1989–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

102. Arka 4/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1201 “Blindi”, me 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1988–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

103. Arka 4/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1105 “Qelepiri”, me 48 (dyzet e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1985–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

104. Arka 4/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1254 “Gaforja”, me 47 (dyzet e shtatë) fletë. Dosja daton në vitet 1989–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

105. Arka 4/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1194 “Zhapijtë”, me 22 (njëzet e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1987–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

106. Arka 4/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1138 “Qafa e malit”, me 106 (njëqind e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1986–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

107. Arka 4/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1235 “Akriliku”, me 26 (njëzet e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1989–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

108. Arka 4/1, Fondi Dega IV, dosje e problemit të centralizuar nr. 1244 “Shushunja 89”, me 57 (pesëdhjetë e shtatë) fletë. Dosja daton në vitet 1989–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

